



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
PËR RAPORTIN VJETOR FINANCIAR TË QEVERISË
PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

2021

gusht, 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
PËR RAPORTIN VJETOR FINANCIAR
TË QEVERISË PËR BUXHETIN E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2021**

Prishtinë, gusht 2022

Tabela e përmbatjes

Lista e shkurtesave	5
Fjala e Auditorës së Përgjithshme	7
Përmbledhja ekzekutive	9
I Auditimi i Raportit Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës.....	13
1. Auditimi i Raportit Vjetor Financiar 2021.....	15
1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	17
1.2 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi.....	18
1.3 Opinioni i auditimit.....	20
1.4 Konkluzion për pajtueshmëri.....	22
2. Deklarata mbi kufirin e lejuar të deficitit buxhetor	23
3. Analiza e buxhetit të shtetit	27
3.1. Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve	29
3.1.1 Analiza e të hyrave buxhetore sipas kategorive ekonomike	31
3.1.2 Analiza e shpenzimeve sipas buxhetit	37
3.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve.....	49
4. Analiza e shënimeve shpjeguese.....	51
4.1 Konsolidimi i të dhënave për shpalosjet në RVF-BRK	51
4.2 Borxhet publike (të brendshme dhe të jashtme) dhe garancitë shtetërore, si dhe stoqet e borxhit shtetëror	52
5. Pasuritë	62
5.1 Pasuritë jofinanciare kapitale dhe jo kapitale.....	63
5.2 Stoqet për nivelin Qendror dhe Lokal.....	66
6. Llogaritë e arkëtueshme.....	66
7. Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente	69
8. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPF	73
8.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përbarimore	74

9.	Të dhënat e punësimit	77
9.1	Të punësuarit jashtë listës së pagave	78
9.2	Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta	78
II	Përmbledhje e rezultateve nga auditimet individuale.....	79
10.	Opinionet e auditimeve dhe konkluzioneve të dalura nga raportet në raportet individuale 2021	81
10.1.	Përmbledhje e opinioneve të auditimeve për PFV-të e OB-ve	81
10.2.	Përmbledhje e konkluzioneve për pajtueshmëri	82
10.3	Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2021.....	84
11.	Sistemi i auditimit të brendshëm	84
12.	Prokurimi	86
13.	Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19	89
III	Auditimet e performancës dhe ndërmarrjeve publike	93
14.	Auditimet e performancës, prokurimit dhe TI-së	95
15.	Ndërmarrjet Publike	107
15.1	Obligimet e ndërmarrjeve publike për raportimin vjetor financiar	108
15.2	Opinionet e auditimit për Pasqyrat financiare për dy vitet e fundit.....	109
15.3	Rekomandimet e vitit paraprak dhe niveli i zbatimit	112
IV	Zbatimi i Rekomandimeve	121
16.	Zbatimi i Rekomandimeve	123
16.1	Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA-në për 2020	124
16.2	Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2020	125
Shtojca I:	Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2020.....	128
Shtojca II:	Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA (shkëputur nga SNISA 200)	156
Shtojca III:	Letër konfirmimi.....	160
Shtojca IV:	Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë.....	161

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm	LIVTh	Llogaria e Vetme e Thesarit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil	MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
AME	Agjencia për Menagjimin e Emergjencave	MAPL	Ministria e Administratës Publike
ANZH	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim	MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit	MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
BB	Banka Botërore	MSH	Ministria e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Evropian	ME	Ministria e Ekonomisë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
BPV	Bruto Produkti Vendor	NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	NP	Ndërmarrjet Publike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	OB	Organizata Buxhetore
BZHKE	Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës	OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
DK	Doganat e Kosovës	PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	RFV/BRK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës

IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
INTOSAI/ ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit	RTK	Radio Televizioni i Kosovës
KA	Komiteti i Auditimit	SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve	SGJC	Sistemi i Gjendjes Civile
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës	TVSH	Tatimi në Vleren e Shtuar
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	TI	Teknologjia e Informacionit
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
LPP	Ligji për Prokurim Publik		

Fjala e Auditorës së Përgjithshme



Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Menaxhimi i mirë i parasë publike dhe në dobi të qytetarëve është mision dhe përgjegjësi e përbashkët e të gjitha palëve të përfshira në ciklin e llogaridhënies publike. Llogaridhënia, transparenca dhe integriteti janë vlera që duhet të promovohen në vazhdimësi në modelin e qeverisjes së mirë dhe të drejtë të parasë publike. Gjithashtu, janë parakushte për të hapur dyert për integritime euro-atlantike dhe qëndrueshmëri ekonomiko-financiare të një shteti. Prandaj, raportimi financiar i konsoliduar mirë dhe në përputhje me kornizën ligjore, standardet dhe

praktikat ndërkombëtare do të siguroj menaxhim më të mirë, llogaridhënie dhe transparencë më të lart para publikut.

Në këtë aspekt, sipas mandatit kushtetues dhe ligjor, Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar raportin vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, dhe më këtë rast më lejoni që me kënaqësi t'iu dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit i cili përmban rezultatet e analizave dhe vlerësimeve tona.

Në sezonin auditues 2021/22, plani vjetor i auditimit është përmbushur në plotni, si në numër ashtu edhe në cilësi. Janë kryer gjithsej 133 auditime, që përfshijnë: auditimin e raportit financiar vjetor të buxhetit të Republikës së Kosovës me mbi 2.5 miliardë euro, auditimin e 90 organizatave buxhetore, 12 ndërmarrjeve publike, 13 projekteve të financuara nga Banka Botërore dhe donatorët e tjerë, 3 raporte të auditimit të pajtueshmërisë prej të cilave 2 janë raporte me informata të klasifikuara (niveli i klasifikimit kufizuar) si dhe 14 auditime të performancës të cilat janë të rëndësishme së veçantë. Të shpalosura më në detaje, rezultatet e këtyre auditimeve janë përmbledhur në brendi të këtij Raporti.

Zyra Kombëtare e Auditimit, ka arritur të zgjerojë fushëveprimin në disa institucione dhe fusha me interes të lartë publik të cilat nuk ishin audituar nga auditimi i shtetit vite me radhë. Për herë të parë në vitin 2021, Zyra ka audituar informata të klasifikuara me ligj të nivelit të kufizuar. Në kuadër të auditimeve, jemi fokusuar në cilësinë e raportimit financiar, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërinë e vendimeve të subjekteve të audituara me kornizën ligjore, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me vlerën për para. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, problemet me menaxhimin e pasurive, detyrimeve të pa paguara, zhvillimi jo i mirë i procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave, dështimi për të mbledhur llogaritë e arkëtueshme kanë qenë disa nga mangësitë kryesore më të shpeshta të identifikuara, të cilat janë shoqëruar edhe me mangësi të tjera, por më frekuencë më të ulët.

Auditimet tona për vitin 2021 kanë rezultuar me numër më të lartë të opinionëve të modifikuara të auditimit për pasqyrat financiare, kjo tregon që cilësia e raportimit financiar në institucionet publike duhet të përmirësohet. Në veçanti veprime më rigorozë dhe të shpejta përmirësuese duhet të ndërmerren tek qeverisja lokale dhe ndërmarrjet publike, përkundër që tek këto të fundit në vitin 2021 janë marrë disa veprime përmirësuese. Gjithashtu, edhe kontrollet e brendshme është e nevojshme të përmirësohen që të jenë më efektive dhe efikase në zhvillimin e proceseve të menaxhimit financiar.

Krahas kësaj më lartë, pavarësisht progresit të arritur gjatë vitit 2021 në zbatimin e rekomandimeve të auditimit, zbatimi i tyre ende nuk është në nivelin e pritur. Përpjekjet e koordinuara të ZKA-së dhe të komisioneve parlamentare të Kuvendit për rritjen e përgjegjësisë së drejtuesve të institucioneve të audituara kanë filluar të japin efekte pozitive. Aktualisht është rritur përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga 45% në vitin paraprak, në 50% për vitin aktual. Sidoqoftë, ky nivel është jo i kënaqshëm prandaj përmirësimi i mëtejshëm në këtë fushë, kërkon përkushtim më të madh të vendimmarrësve.

Në fund të këtij adresimi, falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe komisionet parlamentare në veçanti për mbështetje dhe bashkëpunimin korrekt gjatë këtij sezoni auditues. Dëshiroj po ashtu, të shpreh vlerësimin tim për sjelljen bashkëpunuese të të gjitha institucioneve të audituara, gjatë gjithë procesit të auditimit pa harruar gjithashtu personelin e ZKA-së, për angazhimin e tyre pa kursim për të përmbyllur me sukses dhe brenda afateve ligjore këtë sezon të auditimit.

Auditorja e Përgjithshme,

Vlora Spanca

Prishtinë, gusht 2022

Përmbledhja ekzekutive

Në përputhje me mandatin kushtetues, nenin 137 dhe 138 si dhe mandatin ligjor nenin 6, Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë sezonit auditues 2021/22 ka kryer 133 auditime për të cilat janë lëshuar raportet përkatëse të auditimit. Për të përmbushur këtë detyrim, Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer dhe publikuar: Raportin për Pasqyrat Financiare të Qeverisë, 90 Auditime Financiare dhe të Pajtushmërisë për organizata buxhetore, 12 auditime të ndërmarrjeve publike, 13 auditime të projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve tjerë, 3 raporte të auditimit të pajtushmërisë prej të cilave 2 janë raporte me informata të klasifikuara (niveli i klasifikimit kufizuar) si dhe 14 auditime të performancës. Rezultatet e këtyre auditimeve janë përmbledhur në këtë Raport.

Sipas opinionit të Auditorit të Përgjithshëm, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Raporti Vjetor Financiare i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021 paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Sipas konkluzionit të pajtushmërisë, përveç çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për konkluzion të pajtushmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të 90 organizatave kanë qenë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektet e audituara në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Më gjerësisht, shih nënkapitujt 1.3 dhe 1.4 - Opinioni dhe Konkluzioni i auditimit

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Pranimet/të hyrat sipas buxhetit fillestar ishin planifikuar në shumën prej 2,555,600,000€, ndërsa sipas buxhetit të rishikuar/final ishin planifikuar 2,697,630,000€, me një rritje prej 142,030,000€. Pranimet për vitin 2021 ishin në vlerë prej 2,490,973,000€ apo 92% e buxhetit final. Krahasuar me realizimin e vitit 2020, pranimet janë rritur për 284,326,000€, apo 13%, ndërsa në krahasim me vitin 2019 janë rritur për 268,051,000€ apo 12%. Përderisa pagesat, ishin në vlerë prej 2,378,740,000€ apo 87% e buxhetit final. Nëse krahasojmë me vitin 2020, pagesat janë rritur për 43,783,000€ apo rreth 2% si dhe për 226,177,000€ apo 10.5% nga viti 2019.

Ndryshimi në mes të pranimeve dhe pagesave është 112,233,000€. Kjo shumë paraqet fondet e pa shpenzuara dhe reflekton në rritjen e parasë së gatshme në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Sipas trendit historik të tri viteve të fundit vërehet së pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme, përderisa pranimet në vitin 2020 kishin një rënie të tyre në raport me

vitin 2019 si rezultat i situatës pandemike Covid-19, kurse në vitin 2021 kishte rritje të të hyrave krahasuar me vitin paraprak.

Deficiti buxhetor - neni 22.A.1 i LMFP-së, përcakton se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të parashikuar. Megjithatë, me kërkesë të Qeverisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka përcaktuar rritjen e përkohshme të kufirit të deficitit deri në 6.5%, ndërsa kufiri i bilancit të shfrytëzueshëm bankar është zvogëluar deri në 3% të BPV-së.

Për vitin 2021 deficiti i përgjithshëm i përlogaritur sipas buxhetit fillestar ishte -337,300,000€, apo -4.7% e BPV të parashikuar, ndërsa deficit i përlogaritur sipas buxhetit me rishikim ishte -338,433,000€ apo -4.6%. Po ashtu, nga auditimi vërehet që shuma e deficitit në fund të vitit sipas realizimit ishte -50,363,000€ apo -0.64% e BPV-së.

Siç shihet nga këto informata kufiri i deficitit buxhetor gjatë vitit 2021 ishte në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore dhe nga realizimi i buxhetit vërehet se niveli i inkasimit të të hyrave ishte përmirësuar dukshëm dhe ishte ulur kërkesa për financim nga deficiti.

Borxhi publik¹ - Për shkak se mundësitë financiare të Kosovës për të mbushur arkën e shtetit nuk janë të mjaftueshme, buxheti i Kosovës përveç të hyrave të rregullta, financohet edhe nga huamarrjet e brendshme dhe të jashtme. Në fund të vitit 2021 vlera e borxheve publike ka arritur vlerën prej 1,682,890,000€ apo rreth 22% të BPV-së. Prej tyre 576,750,000€ janë borxhe të jashtme dhe 1,106,140,000€ borxhe të brendshme. Në raport me vitin e kaluar borxhi i përgjithshëm ka shënuar rritje prej 195,200,000€ apo rreth 13%.

Gjatë analizave të kryera, ZKA ka identifikuar mosefikasitet në shfrytëzimin e fondeve të marra si hua të jashtme. Ky mosefikasitet ishte kryesisht rezultat i problemeve me shpronësimet të projektet e infrastrukturës, ndarjeve buxhetore të pa-harmonizuara me dinamikën e projektit, vështirësitë në konsolidimin e njësive zbatuese të projekteve në procesin e rekrutimit dhe mbajtjes së stafit, futjes në buxhet të disa projekteve për të cilat marrëveshjet për kreditë nuk ishin ratifikuar në Kuvend si dhe efektet që ka shkaktuar pandemia Covid-19.

1. Informatat për borxhin publik në këtë raport janë prezantuar bazuar në Buletinin Vjetor 2021 mbi borxhin publik të publikuar nga MFPT/Thesari.

Auditimet individuale të organizatave buxhetore

Nga 90 auditimet e PVF-ve individuale të OB-ve, 46 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 44 me opinion të modifikuar (42 opinione të kualifikuara dhe 2 opinione të kundërta). Krahasuar me vitin 2020 opinionet e modifikuara janë rritur për 17 PVF_të OB-ve (2020 ishin 27 opinione të modifikuara).

Arsyet kryesore për modifikimin e opinioneve të auditimit ishin paraqitjet jo të plota dhe të sakta të informatave në PVF, klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve (nga planifikimi i gabuar, nga pagesat me vendime gjyqësore/përmbarimore dhe nga vetë OB-të), raportimi jo i saktë i pasurive kapitale dhe jo kapitale, pagesat për punëtorët që nuk kanë vijuar punën (te Ministrinë - për ish pjesëtarët e mbrojtjes civile), shpalosja jo e saktë e Llogarive të Arkëtueshme dhe Detyrimeve Kontingjente në PVF-të individuale etj.

Ndërmarrjet Publike - Nga 12 auditimet e PVF-ve të Ndërmarrjeve Publike të gjitha kanë rezultuar me opinion të modifikuar (10 opinione të kundërta dhe 2 të kualifikuara).

Rezultatet e auditimit të ndërmarrjeve publike shpalosin mangësi në lidhje me afarizmin e tyre pasi që shumica operonin me humbje. Mangësitë më të theksuara me të cilat janë ballafaquar këto NP janë: mosrespektimi i afateve ligjore për raportim

financiar, cilësi e dobët e pasqyrave financiare, rritja e detyrimeve të papaguara, mosregjistrimi dhe mos rivlerësimi i pasurive, likuiditet i ulët i pagesave si dhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve.

Në anën tjetër, trendi negativ financiar i shënuar viteve të fundit të këto ndërmarrje, shpërfaq nevojën e një analize gjithëpërfshirëse nga ana e menaxhmentit, por edhe të aksionarëve. Qeveria dhe komunat në të cilat operojnë këto ndërmarrje publike duhet të punojnë ngusht me drejtuesit përkatës në analizën e gjendjes dhe propozimin e masave për sanimin e gjendjes ekzistuese, para se vazhdimësia operative dhe ekzistenca e tyre të vëhet në pikëpyetje.

Auditimet e performances, Teknologjisë së Informacionit dhe Prokurimit - kanë mbuluar fusha me rëndësi ekonomike, arsimore, ambientale, shëndetësore, të sigurisë dhe prokurimit publik, që promovojnë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën në administratë publike. Përmes këtyre auditimeve është vënë në pah se nuk është mbrojtur mjedisi dhe ujërat nga operatorët ekonomik gjatë prodhimit të energjisë elektrike, mangësi në fushën e arsimit sa i përket metodologjisë së vlerësimit të nxënësve, sfidat e institucioneve shëndetësore në menaxhimin e pandemisë, mangësi në fushën e energjisë me theks të veçantë për proceset e prokurimit, transmetuesi publik nuk ka menaxhuar si duhet me fondet publike etj.

Në fushën e TI-së institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për qeverisjen e duhur dhe sistemi për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit në ARC nuk garanton mjaftueshëm vazhdimësinë e sistemit dhe integritetin e të dhënave në çdo kohë si dhe kontrollet e aplikacionit që zbatohen. Po ashtu sistemi që përdoret për menaxhimin e pagave nuk i përmban standardet e kërkuara që të menaxhojnë në mënyrë efikase shpërndarjen e tyre. Ndërsa në auditimin përcjellës të rekomandimeve Thesari i Kosovës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kanë bërë progres të rëndësishëm, por jo të mjaftueshëm në realizimin e planit të veprimit për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

Zbatimi i rekomandimeve - Nga raportet individuale të auditimit është vlerësuar se 50% e rekomandimeve të dhëna në vitin 2020 janë zbatuar plotësisht, ndërsa krahasuar me vitin 2019, zbatimi i rekomandimeve ka shënuar rritje për 5%. Rritja e zbatimit të rekomandimeve është reflektuar tek niveli qendror dhe institucionet e pavarura. Përderisa niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor të Auditorit për RVF-BRK për vitin 2020 përkundër që ka shënuar një rritje krahasuar me vitin 2019 ende vazhdon të mbetet i ulët. Nga 54 rekomandimet e dhëna në RVA-në 2020, prej tyre 12 janë zbatuar plotësisht, 10 ishin në proces të zbatimit dhe 32 të tjera nuk ishin adresuar ende.



**Auditimi i Raportit Vjetor
Financiar i Buxhetit të Republikës
së Kosovës**

1. Auditimi i Raportit Vjetor Financiar 2021

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për realizimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë ministritë, komunat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Auditori i Përgjithshëm, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, një herë në vit kryen auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit të Kosovës.

Auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë 2021 bazohet në dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (neni 18);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar (neni 47 dhe 48);
- Plani Vjetor i Auditimit për sezonin auditues 2021/2022;
- Doracaku për Auditime Financiare dhe të Pajtueshmërisë;
- Udhëzues për kontrollin e cilësisë;
- Rregullorja e MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Korniza INTOSAI për Deklaratat Profesionale, përkatësisht, Standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe kryer bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit e buxhetit të Kosovës sipas LMFPF është baza e parasë së gatshme. Menaxhimi i parasë së gatshme është i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankar që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari. Përkundër kësaj, organizatat buxhetore

bazuar në rregulloren MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë në bazë të të cilëve përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe raportojnë në MFPT/Thesar.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit. Ndërsa, raportet e auditimeve individuale i'u dërgohen Kuvendit të Kosovës, kuvendeve komunale, bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të subjekteve të audituara.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar se asnjë nga 90² organizata buxhetore nuk kishin mospërputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, sa i përket formatit, strukturës dhe afateve të raportimit.

Të gjitha OB-të kanë dorëzuar pasqyrat financiare brenda afatit ligjor, deri më 31 janar 2021. Por, deri në hartimin e Pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë (31 mars 2021), 48 OB kanë bërë korrigjime në pasqyrat e tyre, ndërsa 42 OB nuk kanë pasur nevojë për korrigjime. Mirëpo, gjatë auditimit kemi vërejtur se te një numër i konsiderueshëm i organizatave buxhetore janë identifikuar gabime të pakorrigjuara.

Nga rishikimi rezulton se gabimet e pakorrigjuara më të shpeshta në raportet individuale kanë të bëjnë me:

- Diferencat në mes shënimeve të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) dhe informatave të prezantuara në dy tabelat kryesore të Pasqyrave Vjetore Financiare
- Klasifikimin dhe regjistrimin në kategori ekonomike joadekuate; dhe
- Mosprezantimin e plotë të pasurive, llogarive të arkëtueshme, detyrimeve të papaguara dhe kontingjente në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Çështjet e ngritura më lartë, do të shqyrtohen në hollësi në kapitujt vijues të raportit.

2. Në këtë numër nuk janë përfshirë, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Agjencia e Kosovës për Intelejencë.

1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatisë dhe të prezantojë në mënyrë të drejtë Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontroleve të brendshme.

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, i ka dorëzuar Qeverisë për aprovim, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2021 me 21 mars 2022 brenda afatit dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP me ndryshime dhe plotësime) si dhe në pajtim me SNKSP-të. RVF-2021 janë korigjuar me datë 27 korrik 2022.

Zyra Kombëtare e Auditimit (është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e RVF-ve të Qeverisë. Auditimi është fokusuar në tri pasqyrat kryesore dhe në shënimet shpjeguese/shpalosjet:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive financiare dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Objektivë e auditimit ishte që të ofrojmë siguri të arsyeshme:

- Nëse RVF paraqesin në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse RVF paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontroleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së RVF; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Rishikimi i RVF-ve të BRK-së për vitin 2021 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA-së. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit përmes të cilit janë hartuar RVF-të dhe me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për opinion, ndërkohë që ofron

një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi. Shkalla në të cilën tolerohen gabimet në prezantimin e të dhënave në RVF-BRK e që nuk konsiderohen me ndikim domethënës për besueshmërin e pasqyrave është 1% i pranimeve buxhetore.

Qasja e përzgjedhur përfshinë edhe vlerësimin e rezultateve të dala nga auditimet për disa anekse të RVF-ve të cilat konsolidohen nga pasqyrat financiare individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike dhe anekset tjera.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keqdeklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontroleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Pjesët e mëposhtme të raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që e kanë karakterizuar vitin 2021, por gjithsesi ofrojnë një nivel të arsyeshëm të sigurisë.

1.2 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi

MFPT/Thesari, në emër të Qeverisë përgatitë Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës në pajtim me LMFPP nr.03/L-048, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr.04/L-116, Ligjin nr.04/L-194, Ligjin nr.05/L-063 dhe Ligjin nr.05/L-007, si dhe në bazë të SNKSP-ve.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit të Qeverisë është LMFPP-ja dhe SNKSP-të, sipas parimit të parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë.

Sipas parimit kontabël të parasë së gatshme, pranimet/të hyrat njihen atëherë kur paratë janë transferuar në llogari të vetme të thesarit (LLVTH), janë pranuar në banka komerciale apo janë në pritje për t'u transferuar në LLVTH dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e organizatave buxhetore në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat/shpenzimet njihen atëherë kur ato dalin nga LLVTH, kurse shpenzimet e parave të imëta dhe avanseve për udhëtime zyrtare, njihen në momentin e mbylljes së llogarisë së parave të imëta dhe arsyetimit të shpenzimeve për udhëtimin zyrtar.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e LLVTH, i cili është sistem i llogarive bankare që shfrytëzohet për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari në MFPT.

Thesari është i autorizuar që të ekzekutoj edhe pagesat e faturave dhe kërkesave për pagesë sipas nenit 39.2 të LMFP-së dhe vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore sipas nenit 40 të LMFP-së.

LMFP-ja ka disa kërkesa shtesë për prezantimin e pasurive jo financiare dhe detyrimeve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në pajtim me Pjesën 2 të SNKSP-ve, në bazë të parasë së gatshme.

Pasuritë e prezantuara në shtojcën 7 janë bazuar në shënimet e SIMFK-së dhe përfshijnë pasuritë në vlerë mbi 1,000€ në pajtim me Rregulloren Financiare nr.02/2013. Lista e pasurive jo financiare është paraqitur në vlerën kontabël neto, pas zbatimit të normave të zhvlerësimit.

Raporti përmban shpalosje të informatave edhe për llogari tjera, të cilat janë paraqitur në shtojcat: (8) pasuritë me vlerë nën 1,000€; (9) stoqet; (10) të arkëtueshmet; (12) detyrimet; (13) detyrimet kontingente (16) të dhënat e punësimit, (17) numri i të punësuarve jashtë listës së pagave; (18) numri i të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta. Të gjitha këto shtojca janë konsoliduar nga pasqyrat individuale të organizatave buxhetore.³

Transaksionet ndërmjet organizatave buxhetore, të quajtura “Transaksionet ndërdepartamentale” nuk janë konsoliduar në këto pasqyra financiare, me qëllim të ruajtjes së konsistencës së informatave të raportuara me pasqyrat financiare individuale të organizatave buxhetore. Shpenzimet janë kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të Ligjit të Buxhetit, i bazuar në Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së (SFQ) që janë verzion i SFQ-ve të vitit 2014, të bazuara në parane e gatshme.

Pagesat e bëra nga palët e treta nuk konsiderohen pranime ose pagesa në para të gatshme, por janë përfitime të Qeverisë. Këto pagesa janë prezantuar si shënim i veçantë në shtojcën 4.1 në përputhje me SNKSP-të 2017, efektive nga 1 janari 2019.

Paraja e gatshme përbëhet nga fondet të cilat mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës, bankat komerciale, si dhe paratë e gatshme në arkat e OB-ve dhe ekuivalentët e parasë së gatshme.

3. Me përjashtim të një numri i vogël i OB-ve, në të cilat janë evidentuar gabime teknike dhe të cilat nuk ka qenë në përputhje me deklaratimet historike me vitet paraprake.

Pagesat e kthjera në BRK nga vitet paraprake në vitin aktual, evidentohen si të hyra të këtij viti. Valuta raportuese zyrtare në Kosovë është Euro (€), ndërsa te shpalosja e borxhit shtetëror, mund të jetë përdorur edhe valuta Të Drejtat Speciale të Tirazhit (DST) në shtojcën 21 dhe USD (dollarë amerikan) te pagesat e kuotave për anëtarësim në IFN, tek shtojca 22.

RVF-të autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

1.3 Opinioni i auditimit

ZKA-ja ka audituar RVF-të e BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, i cili përfshinë Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve, shënimet shpjeguese dhe anekset.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Baza për opinionin e kualifikuar

- **Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve** - Përkundër përmirësimeve nga vitet paraprake edhe gjatë vitit 2021, janë identifikuar 13,150,923€ pagesa të klasifikuara në kategori jo adekuate të shpenzimeve, prej tyre 9,327,936€ ishin si rezultat i buxhetimit jo adekuat, përderisa 3,822,987€ ishin si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe të ndikuara nga vetë OB-të. Kategoria më e ndikuar nga klasifikimi jo adekuat i shpenzimit ishin investimet kapitale me 10,244,641€ dhe kategoritë tjera me 2,906,282€.
- **Pagesat e punonjësve bazuar në marrëveshjen e Brukselit** - Gjatë vitit 2021, Qeveria kishte realizuar pagesa në vlerë prej 962,646€ për 199 punonjës (të komunitetit serb të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmëri në punë dhe nuk zhvillojnë aktivitete në kuadër të Ministrive përkatëse.
- **Pasuritë** - Në fund të vitit 2021 totali i pasurive neto ishte 9,184,886,013€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar mbivlerësim i pasurive prej

83,606,404€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK-së. Problemet më të mëdha të cilat e kanë përcjellur këtë kategori ishin: regjistrimi i shpenzimeve operative si pasuri kapitale, regjistrimi i pasurive finale si investime në vijim, mosregjistrimi i plotë i pasurive, aplikimi jo i duhur i normave të zhvlerësimit, çështjet pronësore të pazgjidhura kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit mbi pronësinë dhe mos funksionimi i plotë i sistemit e-pasuria.

- **Llogaritë e arkëtueshme** - Shuma e borxheve të qytetarëve dhe bizneseve ndaj Qeverisë është 777,698,602€. Pjesa më e madhe e këtyre borxheve të pambledhura prej 560,272,355€ ishin në nivelin qendror dhe 217,426,247€ në nivelin lokal. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme prej 4,493,245€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK-së.
- **Detyrimet e papaguara dhe kontingjente** - Detyrimet financiare të papaguara të organizatave buxhetore ndaj furnizuesve dhe operatorëve tjerë ekonomik në fund të vitit 2021 ishin 191,179,554€. Pjesa më e madhe e tyre prej 159,315,069€ ishte në nivelin qendror dhe 31,864,485€ në nivelin lokal. Sipas auditimit është identifikuar nënvlerësim i detyrimeve të papaguara prej 270,315€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK.

Përveç këtyre detyrimeve financiare, ekzistojnë edhe detyrime kontingjente/ potenciale, të cilat janë rezultat i pretendimeve përmes padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritet të marrin epilogun gjyqësor në një të ardhme. Shuma e mundshme e vlerësuar është rreth 224,615,219€ (157,629,778€ në nivel qendror dhe 66,985,441€ në nivel lokal). Sipas auditimeve individuale është identifikuar mbivlerësim i detyrimeve kontingjente për 12,614,867€.

Përshkrim më i detajuar i çështjeve të përmendura te Baza për Opinion gjenden në kapitujt përkatës të këtij raporti.

1.4 Konkluzion për pajtueshmëri

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektet e audituara në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, përveç çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të 90 organizatave kanë qenë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektet e audituara në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Nga auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë për 90 OB-të është identifikuar se në 55 prej tyre janë dhënë konkluzione të modifikuara për pajtueshmërinë (49 të kualifikuar dhe 6 të kundërt), prej tyre 37 janë të nivelit lokal dhe 18 nivelit qendror përfshirë institucionet e pavarura që tregon se këto OB kanë probleme me pajtueshmërinë me autoritet, apo transaksionet financiare nuk i kanë në pajtim me kërkesat ligjore.

Duke marrë parasysh nivelin e mospajtueshmërisë në kuadër të entiteteve mund të vijmë në përfundim se jo të gjitha transaksionet dhe aktivitetet janë kryer në pajtim me autoritetet.

Arsyet kryesore për konkluzion të modifikuar ishin kryesisht për çështjet si: zhvillimi i procedurave jo adekuate të prokurimit dhe në mungesë të projekteve ekzekutive, angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa udhëhequr procedurat e prokurimit, mos verifikimi i 20% të pronave të tatueshme dhe aplikimi i zbritjeve në më shumë se një pronë, dhënia e subvencioneve jo në përputhje me kriteret e përcaktuara si dhe vonesa në arsyeshmërinë e subvencionit, përdorimi i kontratave jo adekuate që ka shkaktuar tejkallim të vlerës së tyre në raport me vlerën e parashikuar, dhe vonesa në pagesën e faturave.

Rekomandim për Kuvendin e Kosovës

- Të forcojë kontrollet mbikëqyrëse kundrejt Qeverisë, para se të miratojë Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, në mënyrë që të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFP-së dhe SNKSP-ve.

Rekomandim për Qeverinë

- Përmes MFPT-së të siguroj se janë përmbushur kërkesat për raportim të saktë dhe të vërtetë edhe në pasqyrat e shpalosjeve; dhe
- Përmes MFPT-së të vazhdojë forcimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që të pamundësoj keqklasifikimet buxhetore.

2. Deklarata mbi kufirin e lejuar të deficitit buxhetor

Sipas nenit 46 të Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, Ministri duhet t'i dorëzoj Qeverisë raportin përfundimtar mbi buxhetin, i cili përfshin një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve lidhur me respektimin e kufirit të deficitit⁴, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë.

Në bazë të nenit 22.A.1. të LMFP nr. 04/L-194, përcaktohet se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së të parashikuar.

Ndërsa, neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

4. 22.B.3. Pavarësisht nga paragrafi 2. i nenit 12(22A), të këtij ligji, pjesëmarrja e komunave në kufirin e deficitit mbetet e pandryshuar në rast se kufiri i deficitit rritet përkohësisht në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse Kuvendi vendos të rrisë pjesëmarrjen individuale të një apo më tepër komunave deri në masën e plotë të paragrafit 2. të nenit 12(22A), të këtij ligji.

- kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit, dhe
- procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Si rezultat i ndikimit të pandemisë Covid-19 në disa nga parametrat makrofiskal, Qeveria ka marrë vendimin nr.03/02 të datës 05.06.2020 për ndryshimin e përkohshëm për disa nga rregullat fiskale, të përcaktuara me Ligjin Nr.03/048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit i plotësuar dhe ndryshuar. Pika 1 dhe 2 e vendimit kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë rritjen e përkohshme të kufirit të deficitit deri në 6,5%, dhe uljen e kufirit të bilancit të shfrytëzueshëm bankar deri në 3% e BPV-së.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas propozimit, Ministria e Financave ka identifikuar burimet shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive ndërkombëtare si dhe granteve.

Neni 22.A.4. përcakton se kufiri i deficitit mund të përshtatet edhe më herët nëse një përshtatje e tillë synon stabilizimin e nivelit të parashikuar total të borxhit në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit.

Financimi i deficiteve buxhetore, sipas rregullave fiskale, bëhet nga fondet e huamarrjeve dhe të hyrat e njëhershme të AKP-së. Qeveria ka respektuar kërkesat e mësipërme dhe për qëllime të njëjta kishte planifikuar huamarrje prej 610,200,000€. Kjo shumë ishte planifikuar për të mbuluar shpenzimet të cilat ishin më të larta se të hyrat e planifikuara.

Ne analizuam përlllogaritjen e deficitit, në Aneksin nr.1 të RVF të shpalesjes së të dhënave në tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2021, dhe nuk kemi identifikuar mospërputhje.

Tabela 1 - Diferencat në përlogaritjen e deficitit buxhetor (në '000 €)

Zërat Buxhetor	Buxheti fillestar (Ligji 07/L-041)	Buxheti i rishikuar (08/L-016)	Realizimi në RVF të BRK	Realizimi sipas auditimit
1. Të hyrat buxhetore	1,887,900	2,043,200	2,184,054	2,184,054
2. Shpenzimet buxhetore	2,454,200	2,516,633	2,288,267	2,288,267
3. Deficiti/suficiti i përgjithshëm	-566,300	-473,433	-104,213	-104,213
4. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale	229,000	135,000	53,850	53,850
5. Deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale (5=4+3)	-337,300	-338,433	-50,363	-50,363
6. Deficiti/suficiti i përgjithshëm në %	-4.70%	-4.60%	-0.69%	-0.64%
7. Bruto produkti vendor i parashikuar	7,159,900	7,341,500	7,341,500	7,818,000

Sic vërehet nga të dhënat më sipër, deficiti i përlogaritur i përgjithshëm sipas buxhetit fillestar ishte -337,300,000€, apo -4.70% e BPV të parashikuar, ndërsa deficiti i përlogaritur sipas buxhetit me rishikim ishte -338,433,000€ apo -4.60%. Deficiti i përgjithshëm i përlogaritur sipas realizimit në RVF_BRK ishte -50,363 apo -0,69% e BPV kurse sipas auditimit realizimi sipas RVF-BRK ishte -0.64%. Ky ndryshim i vogël në përqindje vije nga fakti që Thesari ka aplikuar BPV sipas buxhetit të rishikuar përdërisa ekipi i auditimit është bazuar në BPV në fund të vitit 2021 sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Kufiri i deficitit buxhetor në fund të vitit 2021 ishte në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore dhe nga realizimi i buxhetit vërehet se niveli i inkasimit të të hyrave ishte përmirësuar dukshëm dhe ishte ulur kërkesa për financim nga deficiti.

Tabela 2 - Përlogaritja e deficitit buxhetor për vitin 2021 (në '000 €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Realizimi RVF të BRK-së
1. Të hyrat buxhetore	1,887,900	2,043,200	2,184,054
Të hyrat tatimore	1,723,100	1,839,300	2,006,850
Kthimet tatimore	-45,500	-48,000	-58,912
Të hyrat jo-tatimore	199,800	241,400	236,116
nga të cilat: Taksa koncesionare	19,000	19,000	16,972
nga të cilat: Renta minerare	15,700	20,000	19,235
Mbështetja buxhetore nga grantet	10,500	10,500	0
2. Shpenzimet buxhetore	2,454,200	2,516,633	2,262,980
Paga dhe shtesa	639,800	646,200	667,312
Mallra dhe shërbime	363,900	384,333	327,696
nga të cilat: komunalitë	30,110	29,990	25,287
Subvencionet dhe transferet	753,100	864,300	842,570
Shpenzimet kapitale	626,100	554,500	419,807
nga të cilat: financim nga buxheti i rregullt	403,100	443,600	399,789
nga të cilat: shpenzime kapitale nga klauzola	195,000	111,000	20,018
nga të cilat: fondet e likuidimit nga AKP-ja	28,000	-	-
Rezerva	32,800	32,600	-
Pagesa e Interesit	38,500	34,700	30,881
3. Deficiti/suficiti i përgjithshëm	-566,300	-473,433	-78,926
4. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale ²⁰	229,000	135,000	53,850
Shpenzimet nga të hyrat vetanake te bartura	-	-	33,832
Shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP	6,000	6,000	-
Fondet e likuidimit nga AKP-ja	28,000	18,000	-
Shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve dhe AKP	195,000	111,000	20,018
5. Deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale (5=4+3)	-337,300	-338,433	-50,363
6. Deficiti/suficiti i përgjithshëm në %	-4.70%	-4.60%	-0.69%
7. Bruto produkti vendor i parashikuar	7,159,900	7,341,500	7,341,500

Nga tabela vërehet se kufiri i deficitit buxhetor ishte respektuar si me ligjin e buxhetit ashtu edhe me ligjin e buxhetit të rishikuar për vitin 2021. Po ashtu, në raport me vitin paraprak, realizimi i kufirit të deficitit buxhetor është ulur nga 5.3% (2020) në 0,64% (2021). Në këtë ka ndikuar niveli i lartë në inkasimin e të hyrave.

3. Analiza e buxhetit të shtetit

Të dhënat e prezantuara në RFV-të e BRK-së janë reflektim i projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit për vitin 2021, si dhe rrjedhojë e pranimeve dhe pagesave reale kundrejt ndarjeve përkatëse buxhetore. Gjatë vitit 2021, është bërë rishikimi i buxhetit të Republikës së Kosovës, kjo për arsye se Qeveria e kishte parë të nevojshme rishikimin e planifikimit të të hyrave dhe shpenzimeve.

Kuvendi i Kosovës ka aprovuar ligjin e buxhetit të rishikuar mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021, i cili u karakterizua me rritjen e projeksioneve për të hyrat tatimore dhe jo tatimore, zvogëlimin e financimit nga huamarrja dhe rritjet në kategoritë e shpenzimeve. Të hyrat tatimore bruto me rishikim ishin rritur për 116,130,000€ apo 6,7%, përderisa financimi nga huamarrja ishte zvogëluar për 3,200,000€ apo 0.52% të planit fillestar sipas Ligjit të Buxhetit.

Nisur nga viti i kaluar, ku projeksionet për të hyrat, për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonomi, me ndryshim të buxhetit ishin zvogëluar, këtë vit ministria ka qenë e rezervuar në planifikimin fillestar të të hyrave për shkak të një pasigurie të stabilizimit të situatës me pandeminë Covid 19 dhe efekteve të saj në ekonominë e vendit. Megjithatë, nga mesi i vitit 2021, për shkak të lehtësimit të masave kufizuese nga Qeveria, ardhjes së qytetarëve nga diaspora si dhe krijimit të politikave stimuluese financiare dhe fiskale, pasoi një rimëkëmbje e aktivitetit ekonomik në vend, ku rrjedhimisht projeksionet për të hyrat u rritën me rastin e rishikimit të ligjit të buxhetit në Kuvend.

Lëvizjet buxhetore përmes Vendimeve të Qeverisë përgjatë vitit, kishin ndikuar në disa Organizata Buxhetore, ku në kategori të caktuara ekonomike dhe projekte kishte rritur buxhetin, kurse në disa të tjera e kishin zvogëluar atë. Rritja e buxhetit përmes vendimeve të Qeverisë, kishte ndodhur në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, subvencioneve dhe transfereve.

Niveli i inkasimit të të hyrave/pranimeve në raport me buxhetin përfundimtar ishte 2,490,973,000€ apo 92%. Krahasuar me vitin 2020, pranimet janë rritur për 284,326,000 apo rreth 13%.

Realizimi i buxhetit këtë vit ishte 87% që në krahasim me vitin e kaluar vërehet një rritje prej 5% (2020 realizimi 82%). Në këtë nivel të realizimit ka ndikuar mos realizimi i plotë i projekteve kapitale, si dhe aktivitetet të cilat janë planifikuar për reagime

emergjente ndaj pandemisë, por që për shkak të zbutjes së situatës pandemike nuk është paraqitur nevoja të shfrytëzohen mjetet andaj janë deklaruar si kursime buxhetore. Në nivel të fondeve burimore shkalla më e ulët e shënuar në realizimin e pagesave ishte nga fondi zhvillimor i mirëbesimit për komunat veriore me 388,783€ apo 7.5%, klauzola investive me 20,017,715€ apo 18% e buxhetit, financimi nga huamarrja me 31,147,858€ apo 41% e buxhetit, të hyrat vetanake të bartura 33,832,427 apo 59%, hyrat vetanake 54,691,031 apo 63%. Informata më të plota mbi planifikimet fillestare dhe buxhetin përfundimtar, janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 3 - Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin (në '000 €)

Nr.	Zërat Buxhetor	Realizimi	Sipas Ligjit të Buxhetit Final	Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 07/L-041 viti 2021
1	Të hyrat tatimore	2,006,850	1,839,330	1,723,200
2	Të hyrat jo tatimore	236,116	241,400	199,800
3	Kthimet	-58,912	-48,000	-45,500
4	Pranimet nga donacionet	16,801	22,500	22,500
5	Financimi nga huamarrja	269,586	607,000	610,200
6	Të hyrat tjera	20,533	35,400	45,400
Gjithsej pranimet		2,490,973	2,697,630	2,555,600
1	Paga dhe shtesa	668,124	668,692	639,800
2	Mallra dhe shërbime	306,238	370,760	333,790
3	Shpenzime komunale	25,287	27,638	30,110
4	Subvencione dhe Transfere	842,897	876,161	753,100
5	Shpenzimet kapitale	423,941	622,086	626,100
6	Rezerva	0	3,498	32,800
7	Pagesa e borxhit	111,192	153,200	198,600
8	Kthimi nga fondi i depozitave	1,044	0,00	0,00
Gjithsej Pagesat		2,378,723	2,722,035	2,614,300
Rritja/zvogëlimi i bilancit bankar		112,250	-24,435	-58,700

Qeveria kishte dërguar në Kuvend për miratim Ligjin e Buxhetit fillestar, ku kishte parashikuar pranime/të hyra në total prej 2,555,600,000€ dhe pagesa/shpenzime në total prej 2,614,300,000€, me një zvogëlim në bilancin bankar -58,700,000€. Stoku i bilancit bankar i pashpërndarë është 226,800,000€, kurse bilanci bankar i shfrytëzueshëm si përqindje e BPV-së së parashikuar është 7,159,900,000€ apo 3.2%.

Sipas buxhetit final, pranimet/të hyrat totale kanë vlerën e njejtë me atë të planifikuar me buxhetin e rishikuar pra prej 2,697,630,000€, kurse pagesat/shpenzimet në total ishin 2,722,035,000€. me një zvogëlim në bilancin bankar -24,435,000€. Stoku i bilancit bankar i pashpërndarë është 284,800,000€ dhe bilanci bankar i shfrytëzueshëm si përqindje e BPV-së së planifikuar është 7,341,500,000€ apo 3.9%. Bazuar në këto analiza vërehet se është respektuar kriteri i përcaktuar (bilanci bankar jo nën 3%) sa i përketë % të bilancit bankar të shfrytëzueshëm.

Nga krahasimi i të dhënave të RVF-BRK-së (pasqyra e dytë - te kolona e realizimit të buxhetit – rrjedha dalëse e parasë së gatshme) me të ato të SIMFK-së është identifikuar një mospërputhje në vlerë prej 17,000€.

3.1. Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve

Pagesat sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-041 janë planifikuar më të mëdha se pranimet e rregullta për 58,700,000€. Kjo shumë është planifikuar të financohet nga zvogëlimi i bilancit bankar i grumbulluar nga vitet paraprake.

Të dhënat e prezantuara në RVF-të e BRK-së janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale, si dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Buxheti për vitin 2021 nga Qeveria ishte dërguar në Kuvend për rishikim, ku janë bërë rregullime të ndryshme në ndarjet fillestare buxhetore. Këto rregullime janë bazuar në autorizimet ligjore që mundësohen përmes Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Pranimet/të hyrat sipas buxhetit fillestar ishin planifikuar në shumën prej 2,555,600,000€, ndërsa sipas buxhetit të rishikuar/final ishin planifikuar 2,697,630,000€, me një rritje prej 142,030,000€. Rritja është planifikuar nga të hyrat tatimore prej 116,130,000€ dhe të hyrat jo tatimore prej 41,600,000€, njëkohësisht janë planifikuar zvogëlim të financimit nga huamarrja prej 3,200,000€, kthimet prej 2,500,000€, dhe të pranimeve tjera prej 10,000,000€.

Shpenzimet sipas buxhetit fillestar ishin në shumë prej 2,614,300,000€, kurse sipas buxhetit final në SIMFK, totali i planifikuar i pagesave ishte 2,722,035,000€, me një rritje prej 107,735,000€. Kjo rritje ishte rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë.

Pranimet për vitin 2021

Pranimet apo të hyrat e realizuara në vitin 2021, ishin në vlerë prej 2,490,973,000€. Krahasuar me realizimin e vitit 2020, pranimet janë rritur për 284,326,000€, apo 13%, ndërsa në krahasim me vitin 2019 janë rritur për 268,051,000€ apo 12%.

Tabela 4 - Pranimet dhe pagesat sipas RFV-së të BRK-së ('000 në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2021	Realizimi 2020	Realizimi 2019
Pranimet	2,555,600	2,697,630	2,490,973	2,206,647	2,222,922
Pagesat	2,614,300	2,722,035	2,378,740	2,334,943	2,152,546
Deficiti/Suficiti	(58,700)	(24,405)	112,233	(128,296)	70,376

Ndryshimet ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final, vërehen me një rritje si në aspektin e planifikimit të pranimeve, po ashtu edhe të pagesave. Sipas ligjit të buxhetit fillestar, pranimet ishin planifikuar në vlerë prej 2,555,600€ apo për 58,700,000€ më të ulëta se pagesat (zvogëlimi i bilancit bankar). Poashtu, sipas buxhetit final në SIMFK, pranimet ishin planifikuar të jenë më të larta se pagesat për 24,405,000€. Dallimet në mes projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit janë të theksuara, për shkak të ndikimit të rritjes së ekonomisë në vend, me ç'rast Qeveria më pas kishte ndërmarrë masa për planifikim të të hyrave/shpenzimeve duke bërë që parashikimet fiskale për vitin të ndryshojnë në krahasim me projeksionet fillestare të buxhetit për vitin 2021.

Pranimet për vitin 2021 ishin në vlerë prej 2,490,973,000€ apo 92% e buxhetit final, përderisa pagesat, ishin në vlerë prej 2,378,740,000€ apo 87% e buxhetit final.

Ndryshimi në mes totalit të pranimeve dhe totalit të pagesave është 112,233,000€. Kjo shumë paraqet fondet e pa shpenzuara dhe reflekton në rritjen e parasë së gatshme në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, e cila më 31 dhjetor 2021 ka një saldo përfundimtare prej 442,189,000€.

Nëse analizojmë trendin historik të tri viteve të fundit vërehet se pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme, përderisa pranimet në vitin 2020 kishte një rënie të tyre në raport me vitin 2019 si rezultat i situatës pandemike Covid-19, kurse në vitin 2021 kishte rritje të të hyrave krahasuar me vitin paraprak.

3.1.1 Analiza e të hyrave buxhetore sipas kategorive ekonomike

Nga analiza e pranimeve/hyrave sipas burimeve, shihet se burimet kryesore për financimin e buxhetit janë nga të hyrat tatimore me 78%, financimi nga huamarrja me 11%, të hyrat jo tatimore me 9.5%; të hyrat tjera me 0.83%, si dhe grantet e ndihmat me 0.67%. Pasqyra më poshtë ofron informata të plota për buxhetin fillestar, final dhe trendin e realizimit të të hyrave/pranimeve gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 5 - Pranimet sipas burimit sipas RFV-ve të BRK-së ('000 në €)

Pranimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizmi 2021	Realizmi 2020	Realizmi 2019
Tatimet direkte	304,000	326,400	342,165	267,247	292,259
Tatimet indirekte	1,419,200	1,512,930	1,664,685	1,272,735	1,415,291
Kthimet	-45,500	-48,000	-58,912	-32,999	-45,507
Të hyrat jo tatimore	199,800	241,400	236,116	181,201	214,614
Financimi nga huamarrja	610,200	607,000	269,586	389,031	158,264
Grantet dhe ndihmat	22,500	22,500	16,801	43,078	19,487
Pranimet tjera	45,400	35,400	20,533	86,355	168,514
Totali	2,555,600	2,697,630	2,490,973	2,206,647	2,222,922

Nga tabela vërehet se këtë vit krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje më të theksuar të tatimeve indirekte në vlerë prej 391,950,000€ dhe zvogëlim të theksuar të financimit nga huamarrja në vlerë prej 119,445,000€.

Performanca buxhetore e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës

Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë dy agjencitë kryesore qeveritare për mbledhjen e tatimeve direkte dhe indirekte, si: TVSh-ja, taksa doganore, akcizat, tatimi në të ardhura të korporatave, tatimi në të ardhura personale dhe tjera.

Të hyrat doganore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës me Ligjin 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 ishin 1,173,000,000€. Ndërkaq, me Ligjin e rishikuar të buxhetit nr. 08/L-016, vlera e parashikuar e të hyrave doganore ishte rritur në 1,248,400,000€. Nga kjo vlerë, DK kishte arritur të realizonte 1,376,704,600€, ndërsa në vlera neto, realizimi ishte 1,373,862,694€, apo 110% e planifikimit (të hyrat bruto 1,376,704,600€ -2,841,906€ kthimet).

Në vitin 2021, DK kishte realizuar të hyra bruto prej 1,376,704,600€, që në krahasim me vitin 2020, të hyrat ishin 1,052,525,263€ apo rreth 31% më shumë.

Të hyrat tatimore të planifikuara me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 për ATK ishin 520,200,000€. Ndërkaq, me ligjin e rishikuar të buxhetit, vlera e parashikuar e të hyrave tatimore ishte rritur në 556,000,000€.

ATK kishte arritur të realizonte 597,702,804€, ndërsa vlera neto e realizimit ishte 541,632,809€, (të hyrat bruto 597,702,804€ - 56,069,995€ kthimet). Në vitin 2021, realizimi i të hyrave bruto ishte më i lartë për 130,662,971€ apo rreth 28% më shumë se në vitin 2020.

Mbledhja e të hyrave doganore nga ana e DK nuk ishte përcjellë me ndonjë mangësi, përderisa te ATK-ja është përcjellë me disa mangësi si: procesi i pa përfunduar i fiskalizimit dhe menaxhim jo efikas i llogarive të arketueshme / borxheve të vjetra.

Përkundër përpjekjeve të bëra nga ATK fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve mbetet ende sfidë. Numri i bizneseve që nuk janë fiskalizuar ende e që sipas legjislacionit në fuqi kërkohet të pajisen me arka fiskale në fund të vitit 2021 ishte 13,656 tatimpagues. Pjesën më të madhe të tyre prej 9,794 biznese apo rreth 72% e përbëjnë mikro bizneset me qarkullim vjetor deri në 5,000€.

Analiza e të hyrave buxhetore (struktura)

Tatimet direkte

Tatimet direkte përbëhen prej katër kategorive: tatimi në të ardhura të korporatave (TAK), tatimi në të ardhura personale (TAP), tatimi në pronë (TP), si dhe tatime tjera (gjjobat e ATK-së). Realizimi i tatimeve direkte ishte në vlerë prej 342,165,000€ apo 105% e shumës së planifikuar me buxhetin vjetor.

Burim kryesor i këtyre tatimeve direkte është: tatimi në të ardhura personale me 189,521,000€ (55%) e realizimit të përgjithshëm; tatimi në të ardhura të korporatave me 113,946,000€ (33%); tatimi në pronë me 36,258,000€ (11%), dhe tatimet tjera me 2,440,000€ apo rreth 1%. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa tatimi në pronë nga Komunitat. Krahasuar me vitin 2020, tatimet direkte

kanë shënuar rritje të konsiderueshme për 74,918,000€ apo 28%, ndërsa 49,906,000€ apo 17% krahasuar me vitin 2019.

Neni 2 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton qartë se secila OB duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme. Ndërlidhur me këtë edhe Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimet në nenet 1 dhe 2 përcakton qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore. Ndërsa Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës rregullon mënyrën dhe përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës publike.

Gjatë vitit 2021, sikurse edhe në vitet e mëparshme, komunat: Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Zubin Potoku vazhdojnë të mos mbledhin të hyra nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, pronat e dhëna në shfrytëzim si dhe nuk kanë hartuar rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike. Prandaj edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake është shumë i ulët. Kjo ka ndodhur pasi që komunat ende nuk i zbatojnë ligjet dhe nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga këto veprimtari që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit të komunës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandim për Qeverinë

Të sigurojë përmes MAPL-së vendosjen e mekanizmave për zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok. Inkasimi i këtyre të hyrave do të mundësonte realizimin e më shumë projekteve, rrjedhimisht edhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të komunave përkatëse.

Tatimet indirekte

Burimet kryesore të tatimeve indirekte janë: tatimi në vlerën e shtuar (TVSH), detyrimi doganor, akcizat dhe tatimet tjera indirekte. Realizimi total për këtë kategori të të hyrave ishte 1,664,685,000€ apo 110% nga shuma e planifikuar me buxhetin vjetor. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 1,038,218,000€ ose 62.3% e realizimit total, akcizat 501,295,000€ ose 30%, taksat doganore 124,606,000€ ose rreth 7.5%, dhe tatimet tjera indirekte prej 565,000€ apo 0.02%. Krahasuar me vitin 2020, tatimet indirekte kanë shënuar rritje të dukshme për 391,950,000€ apo 31%, si dhe 249,394,000€ apo 17% krahasuar me vitin 2019.

Kthimet tatimore

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të shumave të paguara nga tatimpaguesit mbi shumën e detyrimit tatimor. Me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-

në dhe Doganën, përllogariten diferencat, dhe si të tilla u kthehen subjekteve të ndryshme pas shqyrtimit të kërkesave për rimbursim.

Sipas buxhetit, shuma e kthimeve ishte planifikuar në vlerën prej 48,000,000€, ndërkaq shumat e kthiera deri në përfundim të vitit ishin për 58,912,000€ ose 122% e planit dhe 3% e totalit të përgjithshëm të tatimeve të inkasuara. Prej tyre, vlera e kthimeve nga ATK ishte 56,070,000€, kurse 2,842,000€ janë kthimet nga Dogana.

Shuma e kthyer e tatimeve direkte dhe indirekte tek Dogana e Kosovës ka të bëjë me kthimin e akcizës 1,157,985€, kthimi i taksës doganore 333,775€, kthimi i TVSH-doganore 798,841€ si dhe kthimi nga tatimet taksa tjera doganore 551,305€, ndërsa tek ATK kthimi i TVSH-së 53,005,138€, kthimi e tatimit për pagat e mbajtur në burim 243,725€, kthimi nga tatimi për biznese 109,971€, kthimi nga tatimi për korporata 2,707,062€, si dhe llojet e tjera të tatimeve prej 4,099€.

Në krahasim me vitin 2020, kthimet e tatimeve këtë vit ishin për 25,913,000€ më të larta apo për 78%.

Të hyrat jo tatimore

Në kategorinë e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, llojet e ndryshme të gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifrat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj.

Të hyra jo tatimore mbledhen nga niveli qendror, agjencitë e pavarura buxhetore, niveli lokal dhe ndërmarrjet publike.

Të hyrat jo tatimore për vitin 2021 sipas Ligjit Buxhetit fillestar ishin planifikuar në vlerë prej 199,800,000€, përderisa me rishikim të buxhetit ishin planifikuar 241,400,000€. Prej tyre në nivelin qendror ishin planifikuar 119,700,000€, në nivelin lokal 49,000,000€, të hyrat nga dividendat 30,000,000€, renta minerare 20,000,000€, taksa koncesionare 19,000,000 si dhe të hyrat nga interesi 3,700,000€.

Shuma totale e realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2021 ishte 236,116,000€ apo 98% e planit. Prej tyre, 129,563,000€ ishte shuma e mbledhur nga niveli Qendror, shuma prej 57,271,000€ nga niveli Lokal, nga rentat minerare kishte realizim prej 19,235,000€, nga taksa koncesionare 16,972,000€, të hyrat nga dividendat në vlerë 10,000,000€ si dhe të hyrat nga interesi i kredive për ndërmarrje publike 3,074,000€.

Nëse krahasojmë realizimin e këtyre të hyrave në relacion me buxhetin, atëherë në nivel qendror janë realizuar 108% e planit, kurse në nivel lokal me 116% e planit. Ndërkaq analizuar trendin e tri viteve të fundit, shihet se të hyrat jo tatimore kanë shënuar rritje për 54,915,000€ apo 30% krahasuar me vitin 2020, dhe për 21,502,000€ apo 10% në raport me vitin 2019.

Mangësitë e identifikuara nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e të hyrave jo tatimore janë:

- Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë;
- Mos inspektimi i 20% të pronave komunale;
- Vonesa në lëshimin e kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore;
- Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara;
- Parregullsi në faturimin e tatimit në pronë;
- Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për pajisje me leje të ndërtimit dhe leje mjedisore;
- Përfitimi i dyfishtë i zbritjes për vendbanimin parësor të tatimit në pronë;
- Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale;
- Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga taksat për mbeturina;
- Ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave;
- Mos verifikimi i gjendjes aktuale të objekteve;
- Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve;
- Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave;
- Mos raportimi i të hyrave të arkëtuara nga Teatri “Istref Begolli”;
- Moszbatimi i ligjeve për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike);
- Mos shpërndarja e faturave / aktvendimeve për taksën në biznes; dhe
- Mos-raportimi i të hyrave të arkëtuara.

Huamarrja e jashtme dhe e brendshme

Si burim për financimin e pagesave buxhetore, me Ligjin e Buxhetit Nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financojë nga huamarrjet.

Pranimet nga huamarrja me Ligjin Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 ishin planifikuar 610,200,000€, me rishikim të buxhetit shuma e financimit nga huamarrja ishte zvogëluar në 607,000,000€ apo 0.52% e planit fillestar. Ndërsa realizimi ishte në vlerë prej 269,586,000€ apo rreth 44% e buxhetit final. Kjo për arsye të ndryshimit të disa parametrave makro fiskal, sikurse rritjes së projeksioneve për të hyrat tatimore dhe jo tatimore, si rezultat i ndryshimit pozitiv të gjendjes ekonomike në gjysmën e dytë të vitit 2021.

Huamarrja e jashtme ishte planifikuar në vlerë prej 407,000,000€, ndërsa janë realizuar 125,339,000€ apo 31% e planit. Kjo kishte ndodhur pasi që njësitë implementuese nuk kishin marrë parasysh të gjithë faktorët dhe nuk kishin bërë përgatitjet e duhura me rastin e planifikimit të projekteve (sikurse zgjidhja e problemeve me shpronësim), pas kërkesave për inicimin e procesit të huamarrjes. Aranzhimet për huamarrje kanë ndodhur para se të krijohen kushtet për shfrytëzimin e këtyre fondeve.

Huamarrja e brendshme ishte planifikuar në vlerë prej 200,000,000€, ku janë realizuar 144,247,000€ apo 72% e planit.

Grantet e përcaktuara të donatorëve

Grantet e përcaktuara të donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes Qeverisë dhe donatorëve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme.

Shuma e granteve sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-041 për ndarjet buxhetore për vitin 2021, duke përfshirë grantet për mbështetje buxhetore, ishte planifikuar në shumë prej 22,500,000€. Vlera e njejtë është planifikuar edhe me buxhet final ndërsa pranimet ishin në vlerë 16,801,000€ apo 75%. Shuma e këtyre granteve në vitin 2020 ishte realizuar me 43,078,000€, përderisa në vitin 2019 ishte 19,487,000€.

Në fund të vitit 2021 fondet e pa shpenzuara nga donatorët arrijnë shumën prej 15,818,000€. Mos efikasiteti i shfrytëzimit të fondeve nga donatorët sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, rritë rrezikun që grantet në të ardhmen të zvogëlohen.

Pranimet tjera

Pranimet tjera përbëhen nga financimi i njëhershëm i AKP-së, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike, taksat koncesionare, të hyrat e dedikuara dhe fondi i depozitave. Për vitin 2021 sipas Ligjit të Buxhetit Nr.07/L-041, pranimet tjera ishin planifikuar në vlerë prej 45,400,000€, kurse me rishikim të buxhetit ishin zvogëluar në 35,400,000€, kjo vlerë përbëhet nga të hyrat e njëhershme nga AKP në vlerë 18,000,000€, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 11,400,000€ dhe të hyrat e dedikuara të AKP-së në vlerë prej 6,000,000€.

Ndërsa realizimi ishte 20,533,000€ e ku prej tyre kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike ishte 11,387,000€ apo 55,5%, të hyrat e dedikuara në vlerë 4,645,000€ apo 22,6%, pranimi i depozitave në vlerë 4,462,000€ apo 21.7% dhe të hyrat e njëhershme të AKP-së vlerë prej 39,000€ apo 0,2%.

3.1.2 Analiza e shpenzimeve sipas buxhetit

Buxheti final për shpenzimet e përgjithshme ishte në vlerë prej 2,722,034,733€, ndërsa realizimi ishte 2,378,726,215€ apo 87% e buxhetit.

Të dhënat e prezantuara në RFV/BRK-së janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 i është nënshtruar rishikimit dhe vendimeve të Qeverisë për ndryshime buxhetore, dhe si rezultat i kësaj, kishte lëvizje buxhetore brenda kategorive ekonomike në kuadër të OB-ve.

Sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-041 për vitin 2021 ishin planifikuar pagesa në vlerë prej 2,614,300,000€, ndërsa me buxhetin final ishte 2,722,050,000€, me një rritje për 107,750,000€ apo 4%.

Tabela 6 - Lëvizjet ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final ('000 në €)

Përshkrimi	Ndarja fillestare buxhetore (Ligji i Buxhetit)	Ndryshimet sipas LMFP-së/1	Ndryshimet për të hyrat vetanake	Ndryshimet për grantet e përcaktuara të donatorëve	Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
Paga dhe shtesa	639,800	27,002	772	1,118	668,692	5%
Mallra dhe shërbime	333,790	18,793	3,909	14,269	370,760	11%
Shpenzime komunale	30,110	-2,793	315	5	27,638	-8%
Subvencione dhe transfere	753,100	111,960	10,161	940	876,161	16%
Shpenzime kapitale	626,100	-52,796	41,965	6,817	622,086	-1%
Rezerva	32,800	-29,287	-	-	3,513	-89%
Tjera	198,600	-45,400	-	-	153,200	-23%
Gjithsej	2,614,300	27,479	57,122	23,149	2,722,050	4.10%

Lëvizjet buxhetore për kategori ekonomike ndërmjet ligjit të buxhetit dhe buxhetit final

- Buxheti fillestar për paga dhe shtesa ishte 639,800,000€, ndërsa buxheti final ishte 668,692,464€, me një rritje prej 28,892,464€ apo rreth 5%. Kjo kishte ndodhur për pagesën e shtesave për kategori të caktuara të punonjësve publik të angazhuar në menaxhimin e pandemisë bazuar në vendimet e Qeverisë;
- Buxheti fillestar për mallra dhe shërbime nga 333,790,000€ ndërsa buxheti final ishte 370,760,000€ me një rritje prej 36,970,000€ apo 11%. Kjo për shkak

të nevojës për të mbuluar kërkesat nga OB-të, sa i përket disa shpenzimeve lidhur me pandeminë Covid-19;

- Buxheti fillestar për subvencione dhe transfere ishte 753,100,000€, ndërsa buxheti final ishte 876,161,000€ me një rritje prej 123,061,000€ apo 16%. Kjo kishte ndodhur për pagesat nga pakoja emergjente dhe pakoja për rimëkëmbje ekonomike si pasojë e pandemisë;
- Buxheti fillestar për investime kapitale ishte 626,100,000€, ndërsa buxheti final ishte 622,086,000€, me një zvogëlim prej 4,014,000€ apo 0.64%.
- Financimi i kryegjësë, nën huazimi dhe interesi nga 198,600,000€ sa ishte me buxhet fillestar, është zvogëluar në 153,200,000€ me buxhet final, apo për 45,400,000€ apo rreth 29%.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore (struktura e shpenzimeve)

Siç është prezantuar në tabelën më poshtë, gjithsej pagesat e realizuara për vitin 2021 janë 2,378,740,000€. Nëse krahasojmë me vitin 2020, pagesat janë rritur për 43,783,000€ apo rreth 2% si dhe për 226,177,000€ apo 10.5% nga viti 2019.

Tabela 7 - Pasqyra e pagesave të përgjithshme krahasuar me dy vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final SIMFK	Realizimi 2021	Realizimi 2020	Realizimi 2019
Pagat dhe Shtesat	639,800	668,692	668,124	661,343	616,921
Mallrat dhe Shërbimet	333,790	370,760	306,255	280,007	273,313
Shërbimet Komunale	30,110	27,638	25,287	22,168	24,866
Subvencionet dhe Transferet	753,100	876,161	842,897	868,480	627,959
Investime kapitale	626,100	622,086	423,941	384,471	533,773
Shpenzimet e interesit	38,500	34,700	30,881	27,505	23,450
Kthimi i kryegjësë-nënhuazimit	160,100	118,500	80,312	88,208	51,182
Kthimi i depozitave	-	-	1,043	2,761	1,082
Rezervat	32,800	3,498	-	0,00	
TOTALI	2,614,300	2,722,035	2,378,740	2,334,943	2,152,546

Në vijim janë të paraqitur realizimi i shpenzimeve sipas kategorive si dhe çështjet/mangësitë kryesore të identifikuar gjatë auditimeve individuale të OB për kategoritë përkatëse.

Pagat dhe shtesat - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore prezantohet si një ndër kategoritë me përqindje të lartë të shpenzimeve⁵ me rreth 29.5%. Buxheti për vitin 2021 ishte 668,692,000€, ndërsa shpenzimet në fund të vitit ishin në vlerë prej 668,124,000€ apo 99% e buxhetit. Shpenzimet për pagat dhe shtesat janë rritur për 6,781,000€ apo 1% në krahasim me vitin 2020. Kjo për shkak të zbatimit të vendimit të Qeverisë për rritjen e shtesave për disa sektorë qeveritar si në shëndetësi, polici dhe OB tjera për menaxhimin e pandemisë Covid-19, pagesave të punës jashtë orarit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19.

Edhe këtë vit, 199 punonjës të sistemuar në shtatë ministri të punësuar sipas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2016 janë paguar gjatë vitit 2021 me një shumë totale prej 962,646€ në mungesë të vijueshmërisë së plotë në punë.

Këto pagesa janë bazuar në Marrëveshjen e Brukselit përkatësisht në Ligjin nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, duke i mbështetur zotimet e përcaktuara me këto konkluzione.

Mirëpo, Ministritë përkatëse i kanë vendos në listen e pagave këtë kategori të punonjësve para krijimit të kushteve/hapësirave fizike për punë, sistemim, angazhim dhe monitorim të tyre, që i bënë këto pagesa të parregullta.

5. Në përlogaritjen e përqindjes si pjesëmarrjes në totalin e shpenzimeve për kategori ekonomike janë përjashtuar pagesat për kryegjënë, nënhuazimet, interesin dhe kthimin e depozitave.

Tabela 8 - Pagesat e kryera sipas Marrëveshjes së Brukselit

Nr.	Organizata Buxhetore	Numri i stafit të paguar	Pagesat gjatë vitit 2021
1	Ministria e Ekonomisë	18	93,435
2	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	20	100,264
3	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës	64	298,142
4	Ministria e Punëve të Brendshme	20	97,099
5	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	32	142,698
6	Ministria për Komunitete dhe Kthim	20	104,000
7	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	25	127,008
	Totali	199	962,646

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuar dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e pagave dhe shtesave janë:

- Angazhimi i stafit pa procedura të rekrutimit;
- Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë;
- Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara;
- Angazhimi i punonjësve shëndetësorë në spitalet rajonale pa procedura;
- Caktimi i të punësuarit në vendin e punës në kundërshtim me përgatitjen profesionale specialiste;
- Dobësitë në procedurat e rekrutimit të personelit në shërbimin civil;
- Mungesa e autorizimeve për realizimin e punëve dhe orëve shtesë;
- Mos zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNj-së dhe mos publikimi i informatave rreth procedurave të rekrutimit;
- Rritja e numrit të punonjësve dhe mos përfshirja e tyre në listën e pagave;
- Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore;
- Mosrespektimi i vendimit për shtesat e stafit;
- Mungesa e planit të rekrutimit dhe pozitave menaxheriale të paplotësuara; dhe
- Pagesa e zyrtarëve të AME-së në mungesë të informatave për dosjen e tyre.

Mallrat dhe Shërbimet - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore marrin pjesë me 13.5%. Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 370,760,000€, përderisa janë shpenzuar 306,239,000€ apo 83% e buxhetit. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 26,232,000€ apo 9%.

Në këtë rritje të shpenzimeve nga kjo kategori ka ndikuar blerja e librave dhe veprave artistike, furnizimeve mjekësore, furnizimet me kompjuter, me naftë etj.

Zërat kryesorë në këtë kategori, të cilat përfshijnë pjesën më të madhe të shpenzimeve janë: shërbimet kontraktuese tjera me 60,055,644€, furnizime mjekësore me 59,973,211€, blerja e librave dhe veprave artistike 13,453,938€ qiraja për ndërtesa me 10,480,146€, pagesa me vendime të gjykatave me 9,221,695€ dhe shpenzimet tjera.

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara nga raporteve individuale të auditimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë:

- Mangësi lidhur me angazhimet me marrëveshje për shërbime të veçanta;
- Pagesa e qirasë për objektin/hapësirën e pashfrytëzuar;
- Vonesa në mbylljen e avanseve;
- Mangësi në procedimin e pagesave, përfshirë vonesat në pagesën e faturave;
- Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve;
- Pagesa pas përfundimit të afatit të kontratës, dhe për shërbimet e pa kontraktuara;
- Vendosja e kriterëve favorizuese në specifikacionin teknik;
- Përdorimi i kontratave jo adekuate, vlera të paqarta dhe tejkallim i pagesave për kontratat publike dhe ato kornizë;
- Parregullësi në procedurat e prokurimit, anashkalim i tyre dhe përzgjedhje e ofertës të papërgjegjshme;
- Mangësi në vlerësimin e ofertave dhe nënshkrim i kontratave pa zotim të mjeteve;
- Mangësi dhe tejkallim i furnizimeve të sasive të përcaktuara në kontratën kornizë;
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak në AQP;
- Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore;
- Mos penalizimi i operatorëve ekonomik dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit;

- Pagesa për dreka zyrtare pa dëshmi të duhura;
- Mos respektimi i kërkesave të ligjit të TVSH-së;
- Menaxhimi jo efikas i banesave të marra me qira në Misionet Diplomatike dhe Konsullore;
- Tejkallim i limiteve bankare nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore; dhe
- Parregullësi në shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit.

Subvencionet dhe Transferet - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 37%, që njëherit prezanton kategorinë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Buxheti për vitin 2021 ishte 876,160,793€, kurse shpenzimet ishin 842,897,191€ apo 96% e buxhetit. Zvogëlim i shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 25,583,000€ apo 3%. Kjo ka reflektuar në këto kode ekonomike: pagesat për përfituesit individual, subvencionimi për entitete jo publike, subvencionimi për entitete publike, pensionet bazë, pagesa për personat me nevoja të veçanta, pagesat për kultura bujqësore, subvencionet për lehona të punësuara dhe të pa punësuara.

Zërat kryesor që kanë karakterizuar këtë kategori janë: pensionet bazë me 198,196,982€; pensionet bazë kontributdhënës me 134,340,679€, subvencionet për entitete publike me 101,979,653€, pagesa për përfituesit individual me 33,689,276€, subvencionet për entitete jo publike me 53,520,754€, pensionet për veteranët e luftës me 78,973,954€, pensionet për invalidët e luftës me 41,590,921€, pensionet- kategoria e I-rë me 53,395,050€, pagesat për kulturat bujqësore me 31,352,289€, etj.

Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19, në total ishin 234,026,687€. Prej tyre, pakoja emergjente ishte 4,883,645€, ndërsa pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike ishte 229,143,042€. Shpenzimet e pandemisë do të trajtohen në një pjesë të veçantë të këtij raporti.

Parregullsitë e identifikuar nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve janë:

- Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare;
- Subvencionimi, thirrja publike dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren;
- Subvencionimi i fermerëve në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në thirrjet publike;
- Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike;
- Vonesa në arsyetimin e subvencioneve dhe mos raportim nga përfituesit;
- Mangësi në procesin e vlerësimit të subvencioneve;

- Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve;
- Dobësitë në menaxhimin e kontrolleve Ex-Post;
- Parregullsi në përlogaritjen e vlerës për kompenzimin e dëmeve për fermerët;
- Skadimi i periudhës së garancionit bankar tek grantet;
- Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes; dhe
- Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale.

Investimet kapitale - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 19%. Buxheti final për këtë kategori ishte 622,086,000€, ndërsa shpenzimet janë 423,941,000€ apo 68% e buxhetit final. Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një realizim më i lartë i shpenzimeve, i cili në vitin 2020 ishte 384,471,000€.

Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, si dhe shërbimeve tjera publike.

Menaxhimi i projekteve kapitale bëhet përmes Programit për Investime Publike (PIP). Planifikimi i projekteve në PIP duhet të bëhet në mënyrë të detajuar dhe të aprovohet nga krerët e organizatave, bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre. Në anën tjetër, MFPT aprovon këto kërkesa të OB-ve duke u bazuar në dokumentet e paraqitura në PIP në lidhje me arsyeshmërinë dhe duke siguruar se janë në përgjegjësi dhe kompetencë të tyre.

Ndonëse ka një rritje të performancës krahasuar me vitin e kaluar për shkak të gjendjes më stabile me pandeminë, krahasuar me vitin 2019, prapë mbetet një realizim jo i kënaqshëm. Për një numër të kontratave të planifikuara nuk janë zhvilluar procedura të prokurimit për shkak të mos inicimit të kërkesës nga njësitë kërkuuese të organizatave apo tejzgjatja e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave nga operatorët në OSHP, një pjesë e kontratave për punë janë ndërprerë për shkak të mos realizimit të punimeve nga operatorët ekonomik. Më tutje mos zgjidhja e problemeve shpronësore mbetet një sfidë nga viti në vit si shkak i të cilës tejzgjatjen punimet e kontraktuara.

Realizimi më i ulët i projekteve kapitale vërehet te këto organizata buxhetore: Komuna e Prishtinës me 34%, Komuna e Mitrovicës së Veriut me 25%, Komuna e Fushë Kosovës me 44%, Komuna e Shtërpcës me 44%, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me 22%, Zyra e Kryeministrit me 27%, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me 27%, Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë me 27%, dhe Ministria e Ekonomisë me 52%.

Parregullsitë e identifikuar nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e investimeve kapitale janë:

- Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera;
- Specifikimi teknik jo i qartë/matshëm;
- Vonesat në realizimin e punimeve;
- Lidhja e kontratës përmes procedurës jo adekuate të prokurimit;
- Ndarja e tenderëve për punë të njëjta;
- Pranimi i furnizimeve në mungesë të dokumentacionit specifik sipas kontratës;
- Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve;
- Nënshkrimi i kontratës përtej vlerës së parashikuar të buxhetit;
- Investime publike në parcela të pa shpronësuara;
- Mangësi në procedimin e pagesave dhe vonesa në pagesën e faturave;
- Mbi pagesë si rezultat i pranimit të pajisjeve ndryshe nga ato të kontraktuara;
- Ndryshime në sasinë e paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimet paraprake;
- Mungesë dhe mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive për ndërtim të rrugëve;
- Mangësitë në realizimin e projekteve kapitale;
- Pranimi i faturës para zotimit të mjeteve financiare;
- Mangësi në kontratën kornizë, mospërdorimi i sasive të planifikuara;
- Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të papërgjegjshëm;
- Mangësi në marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të komunës dhe organizatave jo qeveritare;
- Kryerja e pagesave për punë të porealizuara;
- Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore; dhe
- Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë mbi afatin e përcaktuar.

Financimi i projekteve kapitale nga huamarrja

Buxheti për vitin 2021 për financimin e projekteve kapitale nga huamarrja ishte 126,097,868€, kurse shpenzimi ishte 24,975,368€ apo 20%. Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuar për financimin e projekteve në infrastrukturë, rehabilitimin e rrugëve, mbështetjen e projekteve nga programi për rimëkëmbje ekonomike, uji dhe hedhurina, infrastrukturë publike dhe shëndetësi.

Nga 37 projekte të planifikuara me buxhetin final nga huamarrja, në 7 projekte në vlerë 23,534,092€ nuk ishte bërë asnjë shpenzim, përderisa projektet më të

mëdha kanë nivel të ulët të realizimit. Projektet të cilat nuk kanë pasur realizim të mirë janë si në vijim:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – buxheti final për projektet e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrugëve, projektet e kadastrës, dhe rehabilitimit të hekurudhave ishte 65,630,000€, përderisa realizimi ishte 6,392,234€, apo 10%;
- Ministria e Ekonomisë - buxheti final për projektet për efikasitet të energjisë dhe monitorim të ndërmarrjeve publike ishte 12,784,598€, përderisa realizimi ishte 4,914,403€ apo 38%;
- Ministria e Shëndetësisë – buxheti final për projektet menaxhimin dhe reagimin emergjent ndaj Covid-19” ishte 24,499,150€, përderisa realizimi ishte 7,112,780€ apo 29%; dhe
- Komuna e Shtimes – buxheti final për projektin për planifikim dhe zhvillim ekonomik ishte 793,562€ përderisa realizimi ishte 56,810€ apo 7.2%.

Sfidat me të cilat janë ballafaquar OB-të gjatë realizimit të projekteve janë problemet për shpronësim të paraqitura gjatë procesit të punimeve, vështirësi në procesin e rekrutimit dhe mbajtjes së stafit të njëjësive zbatuese të projekteve, vendosjen në buxhet të disa projekteve për të cilat kreditë nuk ishin ratifikuar në Kuvend, dhe procedurat e tej zgjatura të prokurimit.

Po ashtu, nga auditimi i projekteve të Bankës Botërore, kemi vërejtur se të njëjtat, në SIMFK regjistrohen si fonde të huasë në kuadër të programeve të ministrisë përkatëse. Në rastet kur një ministri ka më shumë se një projekt në kuadër të një huaje, në sistem nuk ka një kriter për të dalluar se nga cili projekt janë realizuar pagesat në SIMFK. Kjo e vështirëson përcjelljen e gjendjes së shpenzimeve dhe mjeteve të cilat janë ende në dispozicion për shfrytëzim nga ministria për projektet përkatëse dhe mund të shkaktojë tejkalimin e shpenzimeve sipas projekteve.

Ky tejkalim ka rezultuar tek Ministria e Shëndetësisë për Projektin e Shëndetësisë Kosovare (është tejkaluar vetëm një pozicion i kredisë, jo totali i kredisë) për 342,710€. Kjo situatë ka shkaktuar edhe raportim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV-të e MSH-së dhe rrjedhimisht edhe PFV-të e BRK-së, për shkak se fondet e tejkaluara nuk do të jenë të rimbursueshme nga huamarrja dhe do të mbulohen nga granti i qeverisë, derisa në të dy PFV-të janë regjistruar si shpenzime nga fondi i huamarrjes.

Pagesat tjera

Për këtë kategori të shpenzimeve, janë buxhetuar gjithsej 154,900,000€, kurse janë realizuar shpenzime në vlerë prej 112,238,000€. Prej tyre: pagesat për kthimin e borxhit dhe nënhuazimeve 80,312,000€, shpenzimet e interesit 30,882,000€, dhe kthimi i depozitave 1,044,000€.

Keqklasifikimi i shpenzimeve

Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit, në 41 organizata buxhetore janë identifikuar keqklasifikime të shpenzimeve në një shumë totale prej 13,150,923€. Prej tyre 4,473,659€ apo 34% te 16 OB të nivelit qendror dhe 8,677,264€ apo 66% te 25 OB të nivelit lokal.

Tabela në vijim tregon keqklasifikimin e bërë nëpër kategori ekonomike. Kategoria më e ndikuar nga keqklasifikimi është kategoria e Investimeve Kapitale me 10,244,641€ apo 78% në raport me keqklasifikimin në tërësi, pastaj kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve me 2,072,144€ apo 16% dhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve me 801,315€ apo 6%.

Tabela 9 - Keqklasifikimi për kategori ekonomike

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E buxhetuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Pagat dhe mëditje	Subvencionet dhe transferet	0	32,823	0	32,823
Gjithsej Pagat dhe mëditjet		0	32,823	0	32,823
Mallrat dhe shërbimet	Pagat dhe mëditjet	4,291	47,608	347,923	399,822
	Subvencionet dhe transferet	249,934	122,083	5,047	377,064
	Investimet kapitale	384,812	32,292	857,490	1,274,594
	Shpenzime komunale	0	0	20,664	20,664
Gjithsej Mallrat dhe shërbimet		639,037	201,983	1,231,124	2,072,144
Subvencionet dhe transferet	Pagat dhe mëditjet	0	0	112,942	112,942
	Mallrat dhe shërbimet	27,756	424,446	3,130	455,332
	Investimet kapitale	0	46,082	186,959	233,041
Gjithsej Subvencionet dhe transferet		27,756	470,528	303,031	801,315
Investimet kapitale	Pagat dhe mëditjet	0	0	111,488	111,488
	Mallrat dhe shërbimet	1,193,187	7,091,762	301,365	8,586,314
	Subvencionet dhe transferet	16,000	1,530,839	0	1,546,839
Gjithsej Investimet kapitale		1,209,187	8,622,601	412,853	10,244,641
Gjithsej keqklasifikimi për vitin 2021		1,875,980	9,327,935	1,947,008	13,150,923

Nga kategoria e investimeve kapitale të cilat kryesisht ishin të buxhetuara ishin kryer gabimisht pagesa prej 10,244,641€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorive mallra dhe shërbime, subvencione sidhe paga dhe shtesa.

Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin kryer gabimisht pagesa prej 2,072,144€, për shpenzime të cilat i takojnë investimeve kapitale, pagave dhe mëditje dhe subvencione dhe transfere.

Nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin kryer gabimisht pagesa prej 801,315€, për shpenzime të cilat i takojnë mallrave dhe shërbimeve, investimeve kapitale dhe paga dhe mëditje.

Si dhe nga kategoria e pagave dhe mëditjeve ishin kryer gabimisht pagesa prej 32,823€ për shpenzime të cilat i takojnë subvencioneve dhe transfereve.

Nga tabela e mësipërme shihet se keqklasifikimi i shpenzimeve është i ndikuar kryesisht nga buxheti jo adekuat në kategoritë ekonomike, nga shpenzimet në kategori të gabuara nga vetë Organizata Buxhetore, dhe si pasojë e pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet gjyqësore/përmbartimore.

Totali i keqklasifikimit përbëhet nga buxheti jo adekuat në kategoritë ekonomike në vlerë prej 9,327,935€ apo 71%, pagesave nga Thesari bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore prej 1,947,008€, apo 15% (të cilat ishin kryesisht për paga jubilarë) dhe shpenzimet e keqklasifikuara nga vetë Organizatat Buxhetore në vlerë prej 1,875,980€ apo 14%.

Në raport me vitin paraprak vlera e shpenzimeve të keqklasifikuara është zvogëluar për 4,657,257 apo rreth 35%. Zvogëlimi më i theksuar është te pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore.

Tabela 10 - Mbi/nënvlerësimi i kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Subvencione dhe Transfere	Investime Kapitale
Mbivlerësimi	32,823	1,080,048	801,315	10,244,641
Nënvlerësimi	(624,252)	(2,181,767)	(1,956,726)	(1,507,635)

Nëse krahasojmë informatat e mësipërme atëherë vërejmë se kategoria më e mbivlerësuar është ajo e investimeve kapitale, përderisa kategoria më e nënvlerësuar është e mallrave dhe shërbimeve.

Në vijim janë paraqitur OB-të të cilat kanë vlerën më të lartë të keqklasifikimit.

Tabela 11 - Keqklasifikimet me planifikim të buxhetit dhe vendime gjyqësore

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
Komuna e Prishtinës	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	4,155,158	Pagesat për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike, deratizimin e podrumeve, dezinfektimin hapësinor, shërbime kontraktuese tjera, etj.
Ministria e Mbrojtjes	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	1,129,999	Pagesa për municion dhe armë zjarri
Komuna e Prizrenit	Investimet kapitale	Subvencionet dhe Transferet	720,185	Shpenzimet e participimeve me fermerët për projekte të ndryshme bujqësore
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	485,295	Pagesa për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve
Ministria e Shëndetësisë	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	410,926	Pagesë për pajise mjekësore
Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	391,693	Blerje e bombolave të oksigjenit, furnizime me materiale mjekësore, pajisje mjekësore, instrumente mjekësore, etj.
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	352,040	Shpenzime për furnizim me inventar, pajisje për salla të sportit, vlerje e pajisjeve të IT-së, etj.

Qeveria, sipas procesit të rregullt buxhetor, i kishte dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa Projektligjin e Buxhetit për vitin 2021, dhe ky Komision më pas i kishte dorëzuar Kuvendit këtë projektligj për miratim me një numër të madh amendamentesh

të Komisioneve parlamentare, grupeve parlamentare dhe deputetëve, të cilat në masë të madhe edhe ishin aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në ligjin përfundimtar. Kjo edhe kishte ndikuar që shumë nga këto shpenzime të planifikuara me ndarje buxhetore, të mos klasifikohen drejtë.

Rekomandim për Qeverinë

- Qeveria duhet të sigurojë se janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e të punësuarve duke siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë, si dhe monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

- Ministri duhet të siguroj që pas ratifikimit të marrëveshjeve në Kuvendin e Kosovës, me rastin e bartjes së fondeve të huave në SIMFK, numri i huamarrjes së ratifikuar të lidhet me kod të projektit, në mënyrë që pagesat për projektin përkatës të jenë të dallueshme dhe të evitohen tejkalimet e shpenzimeve dhe raportimet jo të drejta në PFV.
- Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale; dhe
- Në koordinim me Ministrat të instalojnë mekanizma mbikëqyrës për të siguruar zbatimin e projekteve dhe raportimin në MFPT konform kërkesave ligjore në lidhje me ecurinë e realizimit të projekteve me financim nga huamarrja.

3.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë shumat e pa shpenzuara të fondeve nga: paratë në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor i mirëbesimit, paraja e gatshme transit, kuota në IFN, llogaritë e Misioneve Diplomatike, paratë e gatshme (arka) dhe avancet e hapura.

Fondet për qëllime specifike përbëhen nga: grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat vetanake të bartura, fondi i mirëbesimit për zhvillim, të hyrat e dedikuara, të

tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave) dhe Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2021 dhe të bartura në vitin 2022.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh), dhe pjesa më madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma totale e parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2021 ishte 442,189,000€

Tabela 12 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve ('000 në €)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Banka Qendrore e Kosovës	423,322	316,897	444,301
Kuotat në INF	3,734	1,741	1,741
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	2,636	1,971	4,754
Paraja në transit	6,946	4,851	4,632
Para në llogaritë e MDK-ve	2,068	1,751	1,135
Para të gatshme (arka)	3,484	2,744	1,687
A. Gjithsej: pasurit financiare ne PG	442,189	329,955	458,251
Bilanci i fondeve	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Garantët e përcaktuara të donatorëve	15,818	9,752	8,866
Të hyrat vetiake të bartura NQ	1,436	1,765	5,741
Të hyrat vetiake të bartura në NL	79,442	55,994	49,477
Fondi zhvillimor në mirëbesim	7,354	7,078	6,837
Të hyrat e dedikuara	467	52	803
Të hyrat tjera	19,812	15,894	17,504
Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja	5,131	3,941	7,000
Fonde qëllime specifike	129,459	94,475	96,267
Të pashpërndara	312,730	235,480	361,983
Gjithsej fondet (A+B)	442,189	329,955	458,251

Bilanci i llogarive rrjedhëse të mbajtura në BQK për vitin 2021 është rritur në krahasim me bilancin e vitit 2020 për 112,234,000€. Kjo rritje është rezultat i përmirësimit të aktiviteve ekonomike të cilat në vitin paraprak ishin të ndikuara nga efektet e pandemisë Covid-19.

Paraja e gatshme në Bankën Qendrore të Kosovës është 423,322,000€ apo rreth 96% e totalit të parasë së gatshme.

Nga tabela më lartë shihet se bartja e të hyrave vetanake si të hyra të pa shpenzuara të nivelit lokal, po rritet nga viti në vit. Këtë vit rritja krahasuar me vitin paraprak ishte për 24,084,000€ apo rreth 42%.

4. Analiza e shënimeve shpjeguese

Qeveria dhe OB-të kontrollojnë dhe menaxhojnë me fonde publike, si dhe i përdorin këto burime për të arritur objektivat e realizimit të shërbimeve.

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) inkurajon që të përmbahen shpalosjet e informatave shtesë, aty ku është e mundshme, në mënyrë që të ngritet transparenca dhe përgjegjësia financiare. Shpalosja e informatave të përshtatshme në PFV-të në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të Qeverisë, mund të rrisë transparencën e raporteve financiare dhe të ofroj mundësi për kuptimin më të mirë të relacionit ndërmjet aktiviteteve qeveritare dhe palëve të interesit.

Përmbajtja e shpalosjeve apo shtojcave në RVF-të duhet të jetë e qartë dhe të ofroj informacion të mjaftueshëm dhe cilësor për të gjithë zërat e pasqyrave, në mënyrë që shfrytëzuesit e RVF -ve t'i kuptojnë më mirë fushat e raportuara, përkatësisht trendet vjetore të buxhetit dhe arsyet për ndryshime.

Në përgjithësi RVF-të përmbajnë shpalosje, të cilat ofrojnë informacione të hollësishme për përmbajtjen e shifrave në tri pasqyrat kryesore. Në vlerësojmë se përkundër shpalosjeve analitike të informatave vetëm prezantimi në mënyrë analitike i shifrave nuk është i mjaftueshëm pa dhënë edhe sqarime shtesë në lidhje me ndryshimet brenda vitit si dhe krahasimet me vitet paraprake, të cilat mundësojnë që përdoruesit e tyre të kuptojnë lehtësisht.

4.1 Konsolidimi i të dhënave për shpalosjet në RVF-BRK

Procesi i auditimit të organizatave buxhetore ka nxjerrë në pah një sërë mospërputhesh ndërmjet pasqyrave individuale dhe konsolidimit të tyre në Pasqyrat financiare të Qeverisë. Kjo për shkak se disa prej OB-ve nuk kanë regjistruar dhe pasqyruar drejt disa zëra në pasqyrat e tyre financiare, të cilat janë kryesisht pjesë e shpalosjeve..

Mospërputhjet në shifrat e konsoliduara, kanë të bëjnë me çështjet si më poshtë:

- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.7 në RFV-të e BRK-së për vitin 2021, pasuria kapitale mbi 1,000€ është prezantuar në vlerë prej 9,130,085,941€, ndërsa sipas auditimeve individuale, pasuria kapitale mbi 1,000€ ka rezultuar të jetë 9,044,466,976€, me një mbivlersim prej 85,618,965€. Kjo diferencë mbetet pas thyerjeve të saldove, për shkak se disa organizata kanë paraqitur më shumë pasuri se sa që posedojnë;
- Në pasqyrën e shpalosjeve/ shtojca nr.8 në RFV-të e BRK-së për vitin 2021, pasuria nën 1,000€ në është në vlerë 54,800,072€, ndërsa sipas auditimeve individuale, vlera e pasurive është 56,911,631€, me një nënvlerësim prej 2,111,559€;
- Stoqet në pasqyrën e shpalosjeve në RFV të BRK-së ishin në vlerë 34,837,700€, ndërsa sipas auditimeve individuale kjo vlerë rezulton 34,738,702€, me një mbivlerësim prej 98,998€;
- Detyrimet e papaguara në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca Nr.12 janë prezantuar në vlerë prej 190,909,239€, kurse sipas raporteve individuale të auditimit vlera e obligimeve të papaguara ishte 191,179,554€, me një nënvlerësim prej 270,315€;
- Detyrimet kontingjente në RFV-të e BRK-së janë paraqitur në vlerë 237,230,086€, ndërsa vlera e këtyre detyrimeve sipas auditimeve individuale ishte 224,615,219€, apo me një mbivlerësim prej 12,614,867€; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme ishin prezantuar në RFV-të e BRK-se në vlerë prej 773,205,357€, kurse sipas auditimeve individuale, vlera e këtyre llogarive ishte 777,698,602€, me një nënvlerësim prej 4,493,245€.

4.2 Borxhet publike (të brendshme dhe të jashtme) dhe garancitë shtetërore, si dhe stoqet e borxhit shtetëror

Borxhi i përgjithshëm publik/shtetëror përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Borxhi i brendshëm përkufizohet si borxh shtetëror i cili i nënshtrohet ligjeve të Republikës së Kosovës ndërsa borxhi ndërkombëtar si borxh shtetëror i nënshtrohet marrëveshjeve me qeveritë e huaja, agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare financiare apo organizata dhe kompani tjera të huaja në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, traktateve, konventave apo marrëveshjeve tjera të ngjashme të cilat i nënshtrohen ligjeve të një juridiksioni legal përveç atij të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës ka filluar të marrë borxhe ndërkombëtare që nga viti 2009, ndërsa prej vitit 2012 ka filluar edhe marrja e borxhit të brendshëm përmes emetimit të letrave me vlerë.

Portofolio e borxhit të përgjithshëm shtetëror/publik në fund të vitit 2021 përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe borxhi ndërkombëtar, si dhe dy garanci shtetërore. Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara. Deri më tani, Republika e Kosovës nuk ka borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara.

Në fund të vitit 2021, borxhi i përgjithshëm shtetëror arriti vlerën prej 1,682,890,000€ që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej rreth 13.12%. Sipas Ligjit për Borxhet Publike nr.03/L-175 është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind (40%) të BPV-së. MFPT për vitin 2021 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e borxheve publike, ku në këtë vit borxhi i përgjithshëm në raport me BPV-në ishte 21.92%.

Në vazhdim paraqitet ecuria e borxhit gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 13-Borxhi i brendshëm dhe ai ndërkombëtare (në milionë €)

Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Borxhi ndërkombëtar	576.75	525.80	409.10
Borxhi i brendshëm	1,106.14	961.90	791.94
Borxhi i Përgjithshëm	1,682.89	1,487.69	1,201.05
Garancitë Shtetërore	30.63	31.65	42.68
Borxhi i Përgjithshëm (% në raport me BPV-së) ⁶	21.92	22.44	17.63
BPV nga ASK⁷	7,816.58	6,771.60	7,056.17

6. Borxhi Ndërkombëtar ndryshon nëpër vite edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutor.

7. BPV është rishikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, pasi ka pasur rishikim retroaktiv të BPV, ndryshimi reflektohet edhe për vitet paraprake. Si rrjedhojë e kësaj vlerat e prezantuar në RVA 2020 për BPV dhe % nuk mund ti marrim si referente.

Të dhënat në tabelë tregojnë se pjesa më e madhe e borxheve në masën prej 65.73% janë nga huamarrja e brendshme, ndërsa borxhet e ndërkombëtare marrin pjesë me 34.27% në totalin e borxhit të përgjithshëm. Në raport me vitin paraprak borxhi i përgjithshëm është rritur për 195,200,000€, prej tyre borxhi ndërkombëtare është rritur për 50,950,000€, ndërkaq borxhi i brendshëm për 144,240,000€. Përderisa, Qeveria aktualisht ka garancione shtetërore në vlerë prej 30,630,000€⁸.

Borxhi i brendshëm

Republika e Kosovës ka filluar emetimin e letrave me vlerë nga janari i vitit 2012. Zhvillimi i tregut ka rezultuar të jetë mjaft i suksesshëm në aspektin e interesimit të investitorëve dhe kostos së huamarrjes me ç' rast ky lloj i huamarrjes ka kontribuar si katalizatori kryesor në financimin e deficitit buxhetor.

Në vitin 2021, borxhi i brendshëm është 1,106,140,000€ në raport me vitin e kaluar është rritur për 144,250,000€ si rezultat i emetimit të letrave me vlerë. Borxhi i brendshëm përbën 65.73% të total të borxhit të përgjithshëm shtetëror apo 15.07% e BPV.

Tabela 14. Borxhet i Brendshëm në tre vitet e fundi (në milion €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Emetimet e Reja	144.25	169.95	115.32
Stoku i Borxhit të Brendshëm	1,106.14	961.90	791.94

Siç shihet në tabelë, borxhi i brendshëm ka një trend rritës nëpër vite.

Borxhi ndërkombëtar

Në fund të vitit 2021, borxhi ndërkombëtar ishte në vlerë prej 576,750,000€, në raport me vitin paraprak ka shënuar rritje për 50,950,000€ apo 9.69%. Pjesëmarrja e borxhit ndërkombëtar në totalin e borxhit të përgjithshëm është 34.27% apo 7.86% e BPV-së.

8. Garancia aktuale për Trafikun Urban - Prishtinë është në vlerë prej 6.63 milion€ dhe Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë prej 24 milion€.

Organizatrat buxhetore për projekte të cilat financohen nga borxhi ndërkombëtar kanë vazhduar të tërheqin fonde nga kreditë, vlera e këtyre tërheqjeve në fund të vitit 2021 ishte 123,230,000€. Në vlerë më të vogël edhe kompanitë publike kanë vazhduar të tërheqin fonde nga kreditë e nën-huazuara nga MFPT. Tërheqjet në shumatat më të larta janë realizuar nga BE, ANZh, BZhKE dhe BERZh.

Tabela 15. Borxhi ndërkombëtar (në milionë €)

Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Borxhi ndërkombëtar	576.75	525.80	409.10
Qeveria qendrore	532.30	479.50	359.45
Borxhi i nën-huazuar	44.44	46.29	49.65
Borxhi i Jashtëm (% e BPV-së)	7.86%	7.76%	5.80%
BPV nga ASK	7,816.58	6,771.60	7,056.17

Gjatë vitit 2021 janë ratifikuar pesë kredi/marrëveshje financiare në mes Qeverisë së Kosovës dhe kreditorëve. Marrëveshjet financiare të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës në vitin 2021 janë:

1. Marrëveshja financiare me BEI-në, për kredinë "Projekti i Impiantit të Ujërave të Zeza Gjilan" në shumën 11,000,000€;
2. Marrëveshja financiare me BZHKE-në, për kredinë Instrumenti për Financim të sektorit Publik për Reagim emergjent ndaj Covid-19- Amandamenti nr.1 në shumën 25,000,000€;
3. Marrëveshja financiare me ANZHE-në, për kredinë "Projekti Emergjent Covid-19 për Kosovën-Financim shtesë " në shumën 15,000,000€;
4. Marrëveshja financiare me BEI-në, për kredinë "Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë Covid-19 për NMV-të " në shumën 40,000,000€; dhe
5. Marrëveshja financiare me BERZH-në, për kredinë "Kredia për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale" në shumën 30,000,000€.

Po ashtu, gjatë vitit 2021 janë negociuar dhe nënshkruar gjashtë (6) kredi të reja. Marrëveshjet e reja financiare në vitin 2021 janë realizuar me qëllim të financimit të projekteve në sektorin e infrastrukturës ujore, për menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe reformimin e sistemit të skemave sociale.

Në vijim janë paraqitur marrëveshjet dhe qëllimi i tyre:

1. Përmes Marrëveshjes financiare për kredi në mes Republikës së Kosovës dhe BZhKE-së është miratuar Amendamenti Nr. 1 - Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj Covid-19, në shumën totale prej 25,000,000€ në përpjekjet e saj për të siguruar shërbime mjekësore për ata që preken nga virusi Covid-19 dhe të ndihmoj në menaxhimin e pandemisë.
2. Marrëveshja financiare për kredinë Reagimi i Kosovës ndaj Pandemisë COVID-19 për NMV-të me BEI ka për qëllim t'i ofroj kapitalin e nevojshëm Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 40,000,000€, në mënyrë që i njëjti të ofroj garanci kreditore ndërmjetësuesve financiar për t'i mbuluar humbjet që mund të shkaktohen nga ndërmjetësuesit financiarë sipas kredive investuese ose kredive për kapital punues të vëna në dispozicion për NVM-të.
3. Marrëveshja financiare për kredinë Projekti Emergjent Covid-19 për Kosovën - Financim Shtesë me ANZh në vlerë prej 15,000,000€, ka për qëllim parandalimin, detektimin dhe reagimin ndaj kërcënimit të paraqitur nga pandemia Covid-19 dhe forcimit të sistemeve kombëtare për përgatitjen e shëndetit publik në Kosovë.
4. Marrëveshja financiare Projekti i Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë me ANZh në vlerë prej 47,000,000€ ka për qëllim përmirësimin e barazisë dhe përshtatshmërisë së rrjetit të sigurisë sociale të Kosovës.
5. Marrëveshja financiare për kredinë Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë me BEI në vlerë prej 19,800,000€ ka për qëllim asgjësimin e të gjithë ujërave të zeza të gjeneruara në zonën urbane të qarkut të Mitrovicës, dhe të trajtojnë këto ujëra të ndotura sipas standardeve të përcaktuara në Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane 91/271/EEC; dhe
6. Marrëveshja financiare për kredinë Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë me BERZh në vlerë prej 13,500,000€ ka për qëllim të realizoj rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujërave të zeza në Komunën e Mitrovicës dhe Komunën e Vushtrrisë, si dhe lidhjen e komuniteteve fqinje.

Këto gjashtë (6) kredi të cilat janë kontraktuar gjatë vitit 2021 i përkasin sektorit të shëndetësisë 25%, mirëqenies sociale 30%, sektorit të infrastrukturës ujore 20% dhe mbështetjes financiare 25%.

Tabela 16. Borxhi ndërkombëtar sipas kreditorëve (në milionë €)

Kreditori	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
BNRZh	112.97	124.31	135.64
FMN	63.09	111.44	132.60
ANZh	163.37	132.20	60.53
BIZh	15.32 ⁹	14.27	8.83
FOZhN	0.63	0.57	1.24
FSZh	1.66	1.23	2.08
BERZh	19.51	6.32	4.11
BEI	7.00	7.00	7.00
UniCredit	23.13	20.91	13.26
RBI-Austria	5.13	3.35	1.03
BZhKE	35.00	17.78	0.00
BE	100.00	50.00	0.00
KfW	29.93	36.41	42.79
Gjithsej	576.75	525.80	409.10

Mbjajtësit e Letrave me Vlerë

Sipas Rregullores MFPT-BQK Nr. 01/2014 për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përveç Akterëve Primar dhe Participantëve Primar, edhe personat e tjerë fizik dhe juridik kanë të drejtë të blejnë Letra me Vlerë në Tregun Primar si dhe atë Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Si rezultat, përveç bankave komerciale që janë Akterë Primar si dhe Trustit Pensional si Participant Primar, Letra me Vlerë mbajnë edhe investitorë të tjerë fizikë dhe juridikë (biznese dhe individë privat). Në vijim kemi paraqitur në tabelë gjendjen sipas mbajtësve të Letrave me Vlerë për vitet 2019-2021.

9. Borxhi përfshinë edhe vlerën e ardhshme të shumës së disbursuar.

Tabela 17. Mbajtësit e Letrave me Vlerë (vlerë nominale në milion€)

Instrumenti	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Bankat Komerciale	327.39	272.48	283.03
Fondet Pensionale	490.47	450.12	298.56
Institucionet Publike	228.37	198.86	181.02
Kompanitë e Sigurimeve	41.42	33.8	26.04
Të tjerë	22.4	10.01	6.24
Gjithsej	1,110.05	965.27	794.89

Garancitë shtetërore

Në fund të vitit 2021 portofolio e garancive shtetërore të Republikës së Kosovës përbëhet nga dy garanci shtetërore të emetuara.

Garancinë e parë ndërkombëtare, Republika e Kosovës e ka emetuar gjatë vitit 2016, përmes së cilës e garanton ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e ofruar nga BERZh në vlerën 10,000,0000€. Vlen të theksohet që kjo kredi është e garantuar në kuadër të institucioneve të Kosovës fillimisht, nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Me këtë kredi është paraparë avancimi i Trafikut Urban të Prishtinës. Kredia u disbursua në tërësi në vitin 2018 dhe ka filluar të kthehet po në këtë vit. Deri në fund të vitit 2021 huamarrësi ka kthyer shumën e kredisë në vlerë 3,370,000€.

Në fund të vitit 2016, Republika e Kosovës ka emetuar garancinë e dytë shtetërore në shumën 24,000,000€, e cila i është vënë në dispozicion Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës për linjën e dytë kreditore të ofruar nga BERZh. Kjo linjë kreditore përbën vazhdimësi të linjës së parë kreditore që është vënë në dispozicion në vitin 2013, për mbulimin adekuat të depozituesve të siguruar në mënyrë proporcionale me rritjen graduale të përcaktuar me ligj të limitit të mbulesës për çdo depozitues.

Tabela 18. Gjendja e garancive shtetërore

Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Garancitë Shtetërore	30.63	31.65	42.68
BERZh Garancia për Trafikun Urban-Prishtinë	6.63	7.65	8.68
BERZh Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	24.00	24.00	24.00
Garancitë Shtetërore (% e BPV-së)	0.42	0.47	0.60

Vonesa në shfrytëzimin e kredive ndërkombëtare

Sipas aneksit 21.1 të PFV të BRK-së për shpалosjen e borxhit ndërkombëtar vërejmë që kreditë e ratifikuara për pesë (5) projekte në vlerë totale prej 230,500,000€ të viteve të më hershme nuk janë tërhequr fare mjetet financiare. Po ashtu, janë edhe dy (2) kredi të vitit 2021 në vlerë totale prej 65,000,000€ të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e pandemisë covid -19 nuk kishte asnjë tërheqje të fondeve. Fondet e pashpenzuara kanë të bëjnë me projektet si në vijim:

1. Projekti i rrugës 6 nga Kijeva në Pejë në vlerë 80,000,000€, ku zbatuese e projektit ishte MMPHI, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2018;
2. Projekti për Autostradën Kijev - Zahaq në vlerë 71,000,000€, zbatuese e projektit ishte MMPHI, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2018;
3. Projekti Trajtimi i ujërave të zeza në Prishtinë në vlerë 66,000,000€, zbatuese e projektit ishte ME, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2017;
4. Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan në vlerë 11,000,000€, zbatuese e projektit ishte ME/Komuna e Gjilanit/KRU Hidromorava, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2020;
5. Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në komunat: Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan, zbatuese e projektit ishte Komunitat përkatëse, në vlerë 2,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2016;

6. Projekti Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për reagim emergjent ngaj COVID -19, zbatuese e projektit MFPT, në vlerë prej 25,000,000€, viti i ratifikimit 2021; dhe
7. Projekti Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë COVID -19 për NVM-të, zbatues i projektit MFPT/FKKG, në vlerë prej 40,000,000€, viti i ratifikimit 2021.

Për projektet e lartpërmendura, organizatat zbatuese të projekteve përkatëse raportojnë çdo 3 muaj në MFPT, si dhe për të njëjta, MFPT raporton çdo 6 muaj në Qeveri mbi rrjedhën e ecurisë së realizimit të këtyre projekteve. Ne kemi vërejtur se raportimet janë formale dhe jo të mirëfillta, duke mos i listuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe pengesat që paraqiten në terren në realizimin e këtyre projekteve në mënyrë që pasqyrojnë veprimet konkrete në eliminimin e tyre.

Hyrja në marrëveshje të kredive ndërkombëtare dhe vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, është pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes. Si pasojë e këtyre mangësive, Qeveria në vazhdimësi është duke paguar tarifë të zotimit për këto kredi të pashfrytëzuara.

Mospërputhje e dinamikës kohore në mes alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, për 10 kreditë efektive që përfshijnë vitet e ratifikimit 2016- 2021, që parashihen tarifa zotimi për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit, Qeveria në vitin 2021 ka paguar tarifa të zotimit në vlerë prej 435,890€.

Për shkak të vonesave të mëdha në shfrytëzimin e fondeve nga këto huamarrje, Qeveria në të ardhmen pritet që të paguajë një tarifë shumë më të lartë të zotimeve. Ne analizuam projektin e autostradës Kijevë-Zahaq të ratifikuar në vitin 2018 në vlerë 71,000,000€ e cila nuk është bërë efektive. Bazuar në këtë marrëveshje parashihen tarifa të zotimit¹⁰, dhe nga momenti që kredia bëhet efektive Qeveria obligohet që të paguajë tarifën e zotimit duke përfshirë periudhën nga nënshkrimi i marrëveshjes deri te tërheqja e mjeteve. Vlera e tarifës së zotimit për periudhën 2018-2021, pritet të jetë rreth 1,400,000€.

10. Në paragrafin 2.02, kushtet tjera financiare të huasë pika g) norma e tarifës së zotimit do të jetë 0,5% në vit, në momentin kur marrëveshja bëhet efektive sipas section 3.05 të Standard terms and Conditions, commitment charge paguhet në datën e parë të pagesës pas efektivitetit të kredisë.

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për huamarrje, të bëhen analiza të hollësishme nëse ekzistojnë të gjitha parakushtet dhe janë bërë përgatitjet e duhura për inicimin e procesit të huamarrjes dhe shfrytëzimin sa më efikas të këtyre fondeve. Po ashtu, duhet të shqyrtoj në baza të rregullta raportet vjetore të MFPT-së për borxhet publike dhe t'i përdor ato në diskutimet gjithëpërfshirëse kur vlerëson rezultatet dhe pengesat në proces.

Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimet konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjta të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.

Rekomandime për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

- Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave; dhe
- Të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse ato kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyre projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur.

5. Pasuritë

Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.

Pasuritë jo financiare sipas klasifikimit kontabël ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, kanë vlerë financiare mbi 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, kanë vlerë financiare më pak se 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja; dhe
- Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materiali për zyre.

5.1 Pasuritë jofinanciare kapitale dhe jo kapitale

Menaxhimi i pasurive bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrit kontabël i SIMFK-së si sistem i integruar në kuadër të MFPT-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000 € , si dhe sistemi/aplikacionit “E - pasuria” që është një sistem i integruar në kuadër të MPB, ku të gjitha organizatat buxhetore duhet të evidentojnë, menaxhojnë dhe raportojnë për pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet/pajisje rezervë dhe material zyre.

Por, aplikacioni E-pasuria nuk ka funksionuar si i tëri ose me të gjitha funksionalitetet. Arsyja e mos funksionaliteteve të plotë të këtij aplikacioni është skadimi i kontratës së mirëmbajtjes me operatorin ekonomik. Kontrata e mirëmbajtjes ka skaduar në dhjetor 2020, dhe deri në përfundimin e auditimeve për vitin 2021, ministria nuk kishte angazhuar ndonjë operator ekonomik për mirëmbajtjen e këtij aplikacioni edhe përkundër faktit se ishin zhvilluar procedura të prokurimit të cilat sipas pohimeve të zyrtareve përgjegjës kishin dështuar disa herë. MPB është në proces të nënshkrimit të kontratës së re për mirëmbajtjen e këtij aplikacioni.

Rezultatet e auditimit tregojnë se shpalesjet mbi pasuritë jo financiare në vitin 2021 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive SIMFK dhe e-pasuria, janë jo të plota. Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive janë duke vazhduar edhe me tutje si te institucionet e nivelit qendror po ashtu edhe ato lokale, edhe pse vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e kontrolleve mbi pasuritë jo financiare. Si rezultat i mosfunksionimit të plotë të sistemit e-pasuria, janë krijuar vështirësi në menaxhimin dhe raportimin e pasurive jo kapitale dhe stoqeve. Në këtë kishite ndikuar mungesa e emërtimit të disa produkteve në katalog duke pamundësuar regjistrimin e tyre në sistemi, si dhe mos regjistrimi me kohë i artikujve, apo edhe regjistrimi në kategorinë jo të duhur.

Organizatat buxhetore, kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PFV-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në RVF. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Tabela 19 - Pasurit jofinanciare kapitale dhe jokapitale

Institucionet	Pasurit jo financiare kapitale dhe jo kapitale	Vlera e pasurisë e prezantuar në RVF-BRK nga MF	Sipas Auditimeve	Mbivlerësimi/nënvlerësimi
Pasurit kapitale mbi 1,000€	Niveli qendror	2,968,583,804	2,894,482,719	74,101,085
	Niveli lokal	6,161,502,137	6,149,984,257	11,517,880
Pasurit kapitale nën 1,000€	Niveli qendror	33,125,216	34,024,034	-898,818
	Niveli lokal	21,674,856	22,887,597	-1,212,741
Totali i pasurive		9,184,886,013	9,101,378,607	83,507,406

Nga tabela e mësipërme vërejmë se pasuritë jo financiare në total ishin mbivlerësuar për 83,507,406€ (pasuritë mbi 1,000€ janë mbi vlerësuar në vlerë 85,618,965€, përderisa pasuritë nën 1,000€ janë nënvlerësuar në vlerë 2,111,559€). Në raport me vitin e kaluar kemi një përmësim pasi që totali i mbivlerësimit ishte zvogëluar për 13,078,511€ (në vitin 2020 mbivlerësimi ishte 96,585,918).

Niveli Qendror

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa organizata buxhetore kanë përfshirë në regjistrat e tyre të pasurive, të cilat nuk i plotësojnë kriteret për tu konsideruar si pasuri, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RVF-BRK është mbivlerësuar për pasurit kapitale për 74,101,085€, ndërsa si rezultat i mospërfshirjes në regjistra pasurit jo kapitale ishin nënvlerësuar për 898,817€.

Arsyet e këtyre diferencave të larta vijnë kryesisht nga shkaqet si në vijim:

- Regjistrimi i shpenzimeve operative (mirëmbajtja e rrugëve) si pasuri;
- Regjistrimi i pasurive finale si investime në vijim përkundër pranimit teknik;
- Mos regjistrimi i plotë i pasurive; dhe
- Aplikimi jo i duhur i normave të zhvlerësimit, etj.

Gabimet e identifikuara apo mospërputhjet e gjendjes së pasurive kapitale dhe jo kapitale kanë rezultuar në mbivlerësimin ose nënvlerësimin e pasurisë në 24 organizata të nivelit qendror, ku përfshinë 13 ministri, Zyra e Kryeministrit, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, Kuvendit të Kosovës dhe tetë Agjenci të Pavarura ose 48% e institucioneve qendrore nuk i kanë prezantuar saktë pasurit kapitale dhe jo kapitale.

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhim të pasurive të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimeve individuale janë:

- Në 11 institucione nuk është kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë;
- Në 10 institucione nuk kishte funksionuar sistemi e-pasuria ose të gjitha pasurit jo kapitale, nuk janë vendosur ose vendosur pjesërisht në sistemin e-pasuria;
- Në katër institucione procesi i inventarizimit vjetor ishte i pjesshëm apo procesi kishte përfunduar pasi ishin dorëzuar pasqyrat financiare vjetore; dhe
- Dobësi tjera të cilat janë vërejtur në nivelin qendror por në numër me të vogël janë: Mangësi në regjistrimin e pasurisë në vijim si dhe mos formimi i komisioneve për vlerësimin e pasurisë, si dhe vonesa në vlerësimin e pasurisë

Niveli Lokal

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa komuna nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RVF-BRK është mbivlerësuar për pasurit kapitale për 11,517,879 €, ndërsa për pasurit jo kapitale nënvlerësuar për 1,212,741€.

Nga gjithsej 38 komuna, 33 prej tyre kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë e prezantuara në RVF-BRK, ose 87% e komunave nuk i kane prezantuar saktë pasurit kapitale dhe jo kapitale.

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

- Komuna e Zubin Potokut dhe Leposaviqit nuk kanë raportuar pasuritë kapitale;
- Komunat e Ferizajt, Zveqanit, Kllokotit, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Novobërdës nuk kanë raportuar pasuritë jo kapitale;
- Në 10 komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes regjistrit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit;
- Në 20 komuna, nuk ka funksionuar sistemi e-pasuria ose të gjitha pasuritë nën 1000 janë vendosur pjesërisht në sistemin e-pasuria;
- Në nëntë komuna ka munguar inventarizimi i pasurisë ose është bërë inventarizim i pjesshëm; dhe
- Në nëntë komuna, pronat komunale (parcelat dhe objektet) nuk janë të regjistruara në regjistrat kontabël.

5.2 Stoqet për nivelin Qendror dhe Lokal

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK janë 34,837,700€, ndërsa sipas auditimeve individuale 34,738,702€, me një mbivlersim prej 98,998€. Vlen të theksohet se në fund të vitit 2021, nëntë komuna nuk kanë raportuar stoqe.

Rekomandimet për Qeverinë:

- Qeveria përmes MFPT duhet të siguroj trajnime të mjaftueshme për zyrtarët e pasurisë dhe ZKF lidhur me procesin e regjistrimit të pasurive dhe prezantimin e saktë të tyre në Pasqyra financiare individuale;
- Qeveria përmes MPB duhet të siguroj mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit e-pasuria në mënyrë që sistemi të jetë funksional duke siguruar përditësimin e plotë dhe të saktë të pasurive; dhe
- Qeveria përmes MFPT/Thesarit duhet të siguroj kontrolle formale në veçanti lidhur me raportimin e pasurive kapitale dhe jo kapitale dhe për diferenca të theksuara të kërkoj sqarime shtesë nga organizatat buxhetore.

6. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme paraqesin një zë të rëndësishëm të pasurive afatshkurtëra, ato kërkojnë vëmendje të shtuar, si për qëllime të auditimit ashtu edhe përgjatë procesit të tërësishëm të buxhetit aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

Për vitin 2021 vlera e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF, ishte 773,205,357€, kurse sipas auditimit vlera e tyre ishte 777,698,602€, me një nënvlerësim prej 4,493,245€ (LLA të nënvlerësuara ishin 4,857,177€ dhe e mbivlerësuar për 363,932€).

Shpalosja jo e saktë e LIA ishte si rezultat i gabimeve gjatë prezantimit të tyre në PFV-të e OB-ve.

Sipas RVF 2021 vlera e LIA ishte rritur krahasuar me vitin paraprak për 78,440,936€ apo 11.29%. Llogaritë e arkëtueshme në krahasim me vitet paraprake kanë shënuar rritje, si rezultat i gjendjes pandemike COVID-19.

Tabela 20. Përmbledhja e llogarive të arkëtueshme në tri vitet e fundit në

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2021	Sipas RVF 2021			Krahasimi 2021-2020/ në %
		2021	2020	2019	
Niveli qendror	560,272,355	560,254,493	481,745,871	451,993,627	16.30%
Niveli lokal	217,426,247	212,950,864	213,018,550	180,968,026	-0.03%
Gjithsej	777,698,602	773,205,357	694,764,421	632,961,653	11.29%

Llogaritë e arkëtueshme të Nivelit Qendror

Vlera e LIA në RVF 2021 për nivelin qendror është 560,254,493€, ndërsa sipas auditimit 2021, kjo vlerë ishte nënvlerësuar për 17,862€. Vlera më e madhe e llogarive të arkëtueshme në nivelin qendror përbëhet nga të arkëtueshmet nga MFFT 478,972,668€, KPMM 33,657,802€, MPB 25,526,791€, ARKEP 10,154,529€ etj.

Llogaritë e arkëtueshme të Nivelit Lokal

Sipas raportit të konsoliduar financiar (RVF), bilanci i llogarive të arkëtueshme në 36¹¹ komuna është 212,950,864€, ndërsa sipas auditimit vlera e llogarive të arkëtueshme është 217,426,247€, me një nënvlerësim prej 4,475,383€.

Arsyeja e nënvlerësimit kryesisht ka të bëjë me pakujdesinë gjatë raportimit të të dhënave si dhe harmonizimit të tyre.

Në vijim janë të paraqitura komunat të cilat i kanë nënvlerësuar LIA në vlera më të larta (ndryshimet në mes të pasqyrave të konsoliduara dhe vlerës sipas auditimit):

- Komuna e Graçanicës - LIA i kishte nënvlerësuar për 1,190,365€. Arsyeja e nënvlerësimit ishte prezantimi i LIA vetëm të viti 2021, pa i përfshirë vlerat e pa arkëtuara nga vitet e më hershme;
- Komuna e Istogut - LIA i kishte nënvlerësuar për 40,324€. Arsyeja e nënvlerësimit ishte prezantim jo i drejtë i LIA nga lejet ndërtimore, shfrytëzimi i pronës komunale, si dhe nga tatimi në pronë;
- Komuna e Pejës - LIA i kishte nënvlerësuar për 1,147,997€. Arsyeja e nënvlerësimit ishte prezantim jo i drejtë i LIA nga tatimi në pronë, si dhe për pronat të cilat nuk janë në posedim të komunës;
- Komuna e Vushtrrisë - LIA i kishte nënvlerësuar për 199,290€. Arsyeja e

11. Komuna e Zubin Potokut dhe Mitrovica Veriore nuk kanë deklaruar Llogari të Arkëtueshme

nënvlerësimit ishte prezantim jo i drejtë i takës së mbeturinave si dhe saldove të LIA nga shfrytëzimi i pronës publike;

- Komuna e Kamenicës - LIA i kishte nënvlerësuar për 147,989€. Arsyeja e nënvlerësimit ishte prezantimi jo i drejtë i llogarive të arkëtueshme nga lejet ndërtimore dhe nga shfrytëzimi i pronës publike; si dhe
- Komuna e Ferizajit - LIA i kishte nënvlerësuar për 1,435,171€.

Në vijim janë të paraqitura komunat të cilat i kanë mbivlerësuar LIA

- Komuna e Prishtinës - LIA i kishte mbivlerësuar për 64,727€. Arsyeja e mbivlerësimit ishte mos prezantim i saktë i LIA nga tatimi në pronë.
- Komuna e Prizrenit - LIA i kishte mbivlerësuar për 268,532€. Arsyeja e mbivlerësimit ishte mos prezantim i drejtë i tyre ne PFV.
- Komuna e Klokotit - LIA i kishte mbivlerësuar për 30,673€. Arsyeja e mbivlerësimit ishte mos prezantim i drejtë i taksës për shërbimet e ofruara për largimin e mbeturinave.

Në llogari të arkëtueshme të nivelit lokal përfshihen në përgjithësi të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, taksat në biznes, taksat për shërbimet e mbeturinave, qiratë dhe tjera. Kjo kategori dominohet nga ajo e tatimit në pronë në të cilat përfshihen ngarkesat aktuale si dhe kamatat e dënimit për mos kryerje të obligimeve të mëhershme.

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria në koordinim me MFPT dhe MAPL duhet të rivlerësojë mekanizmat aktual për inkasimin e borxheve, strukturën e tyre, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe duke krijuar mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, duhet siguroj raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme.

7. Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente

Detyrimet e papaguara

Detyrimet e papaguara paraqesin faturat e pranuarra për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhërblenjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë.

Detyrimet totale të papaguara sipas auditimit janë 191,179,554€, ndërsa sipas RVF janë paraqitur në shumën 190,909,239€, me një nënvlerësim prej 270,315€. Krahasuar me vitin paraprak sipas RFV-2021 detyrimet janë zvogëluar për 127,077,819€, apo shprehur në përqindje janë zvogëluar rreth 40%.

Shlyerja më e theksuar e detyrimeve ka ndodhur nga pagesat që janë bërë për shpronësimet e viteve të mëhershme në vlerë prej 65,825,781€ (pagesat më të larta ishin te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vlerë 33,909,538€), dhe nga vetë OB-të janë shlyer detyrime në vlerë prej 61,252,042€. Ky zvogëlimi ka ndodhur për faktin se Qeveria i kishte dhënë prioritet shlyerjes së obligimeve.

Tabela 21 - Detyrimet e papaguara në tri vitet e fundit

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2021	Sipas RFV 2021			Krahasimi 2021 - 2020/ në %
		2021	2020	2019	
Niveli qendror	159,315,069	160,143,780	283,901,529	334,271,052	-44
Niveli lokal	31,864,484	30,765,459	34,085,529	23,365,219	-10
Gjithsej	191,179,554	190,909,239	317,987,058	357,636,271	-40

Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Mosbarazimet më të theksuara kanë ndodhur kryesisht te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ku kishte nënvlerësuar detyrimet për 1,548,738€, të cilat i ka deklaruar më pak në PFV-të dhe rrjedhimisht këto mangësi/shënime janë bartur edhe në RFV-në, dhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kishte mbivlerësuar detyrimet për 2,313,000€, të cilat i ka deklaruar më shumë në PFV dhe rrjedhimisht këto mangësi/shënime janë bartur edhe në RFV-në.

Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Gabimet në raportim, në nivelin lokal janë kryesisht nga komuna e Ferizajit, ku kishte nënvlerësim në RVF/BRK për 1,158,783€ si dhe nga komuna e Prizrenit kishte mbivlersim në RVF/BRK për 126,158€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i korrigjimeve të bëra në PFV nga këto komuna por të cilat ndryshime/korrigjime nuk ishin reflektuar në RVF. Më tej për komunën e Graçanicës, vlera prej 46,304€ nuk ishte prezantuar në RVF/BRK.

Komunat me detyrimet më të larta janë ajo e Gjilanit me 11,034,956€ apo 35% të gjithësej borxheve të nivelit lokal, pastaj Ferizaji me 6,654,378€ apo 21%, si dhe Prishtina me 2,566,567€ apo 8%.

Shpalosjet e pasakta të detyrimeve paraqesin një pasqyrë jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe Qeverisë ku mund të rezultojnë me vendime joadekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrolltet e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të plotë të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

Rekomandim për Qeverinë

MFPT duhet të vendos kontrole përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe aty ku vëren devijime nga afatet ligjore të ndërmerren masa.

Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, shpalosen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Në raportin e konsoliduar, detyrimet kontingjente për vitin 2021 janë gjithsej 237,230,086€, ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente ishin në vlerë prej 224,615,219€. Bazuar në këto analiza rezulton se detyrimet kontingjente ishin të mbivleresuara për 12,614,867€. Kjo kategori si e tillë është subjekt i gabimeve potenciale në shpalosje. Por, diferencat gjithashtu kanë të bëjnë edhe me disa gabime që janë lëshuar nga niveli qendror dhe niveli lokal gjatë konsolidimit të shënimeve. Është shqetësues trendi pozitiv i këtyre detyrimeve dhe njëkohësisht pakujdesia dhe mos përkushtimi i duhur në raportimin e tyre.

Tabela 22 - Përmbledhje e detyrimeve kontingjente

Detyrimet kontingjente	Sipas auditimit 2021	Sipas RVF 2021			Krahasimi 2021 - 2020 / në %
		2021	2020	2019	
Niveli qendror	157,629,778	180,450,668	131,054,401	68,513,132	38
Niveli lokal	66,985,441	56,779,418	80,336,826	73,557,684	-30
Gjithsej	224,615,219	237,230,086	211,391,227	142,070,816	12

Detyrimet Kontingjente të Nivelit Qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente të Nivelit Qendror sipas në RVF-BRK në 2021 ishte 180,450,668€, ndërsa sipas auditimit 157,629,778€, me një mbivlerësim për 22,820,890€. Arsya për këtë është cilësia e dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve nga OB-të tek MF-ja. Disa nga gabimet ishin:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MPHI) ka raportuar në RFV-të e saj 86,169,601€ detyrime kontingjente, ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente janë 60,061,827€. Pra, kemi një mbivlerësim të detyrimeve kontingjente prej 26,107,774€. Kjo kishte rrjedhur si rezultat

i gabimeve teknike të raportuara në PFV si dhe pakujdesisë në kontrollin e brendshëm;

- Ministria e Punëve të Brendshme ka raportuar në RFV-të e saj 8,094,899€ detyrime kontingjente, ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente janë 10,921,430€. Pra, kemi një nënvlerësim të detyrimeve kontingjente prej 2,826,532€. Kjo kishte rrjedhur si rezultat i gabimeve teknike në raportim të detyrimeve dhe mungesës në kontrollin e brendshëm;
- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 454,473€. Shkaku i këtij nënvlerësimi ishte se prezantimi i detyrimeve kontingjente të AZHB-së ishte bërë vetëm për vitin 2021 por jo edhe të atyre të vitit 2020.
- Edhe Fondi i Sigurimit Shëndetësor, kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 117,326€, si rezultat i mos prezantimit të detyrimeve kontingjente të viteve paraprake por ishin përfshi vetëm ato të vitit 2021; dhe
- Zyra e Kryeministrit, kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 104,751€. Kjo vlerë ishte prezantuar në PVF edhe pse kishte një vendim të gjykatës së Apelit.

Detyrimet Kontingjente të Nivelit Lokal

Detyrimet kontingjente të Nivelit Lokal janë dukshëm më të vogla në krahasim me ato të Nivelit Qendror. Paditë ndaj komunave janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilarë e deri tek paditë për shpronësime. Për shkak të qasjes aspak të strukturuar dhe jo formale në harmonizimin e të dhënave, auditimi ka nxjerrë një mori gabimesh. Shuma e raportuar e detyrimeve kontingjente sipas RVF, ishte 56,779,418€, ndërsa sipas auditimit është 66,985,441€, me një nënvlerësim prej 10,206,023€.

Në vijim i shpalosim disa nga ndryshimet më domethënëse:

- Komuna e Prizrenit i kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 9,439,626€. Këto detyrime kontingjente nuk i kishte raportuar në RFV-në dhe as në PFV-të e vitit 2021;
- Komuna e Deçanit kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,260,823€;
- Komuna e Istogut kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 396,234€;

- Edhe Komuna e Gjilanit kishte mbivlerësuar detyrimet kontigjente në vlerë prej 301,299€; dhe
- Komuna e Kaçanikut kishte nënvlerësuar detyrimet kontigjente në vlerë prej 414,546€.

Shpalosja e jo saktë e detyrimeve kontingjente ka ndikuar që të mos pasqyrohet gjendja e drejtë dhe e plotë. Kjo mund të ndikoj që informacioni i shpalosur për këto detyrime të jetë qorientues për palët e interesit.

Rekomandim për Qeverinë

Që përmes Ministrisë së Drejtësis (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinimin me zyret ligjore të organizatave buxhetore të verifikoj vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jetë të sakta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korigjohen.

8. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPP

Në bazë të autorizimeve që jep LMFPP-ja, neni 39, paragrafi 2, Thesari i Kosovës gjatë vitit ka trajtuar kërkesat e operatorëve ekonomik për pagesa të faturave të vonuara (mbi 60 ditë) bazuar në këtë ligj, prej të cilave janë aprovuar dhe është bartë shpenzimi nga buxheti i organizatës buxhetore përkatëse për shlyerje të detyrimeve të krijuara.

Vlera e këtyre pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vitin 2021 ishte 83,149€. Krahasuar me vitin paraprak 2020, ku vlera e pagesave të ekzekutuara ishte 190,698€, ka një rënie prej 56% apo 107,549€. Nga tabela e mëposhtme për tri vitet e fundit vërehet se ka një trend të theksuar të rënies në vlerën e përgjithshme të këtyre pagesave.

Nga analiza sipas kategorive ekonomike vërehet se tek kategoria e investimeve vlera ka rënë ndjeshëm ndër vite, derisa tek mallrat dhe shërbimet ka pasur një rritje të këtyre pagesave. Marrë parasysh trendin e kundërt të rritjes/zvogëlimit sipas kategorive ekonomike nga pagesat përmes vendimeve gjyqësore në tabelën e radhës, rezulton që një pjesë e pagesave sipas nenit 39.2 janë lënë për t'u paguar si vendime gjyqësore.

Tabela 23- Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPP-së për kategori ekonomike, për tri vite¹² (në €)

Pagesat sipas kategorive ekonomike	2021	2020	2019
Mallra dhe shërbime / komunalitë	75,719	67,283	52,066
Investime kapitale	7,430	123,415	1,507,626
Gjithsej	83,149	190,698	1,559,692

Shikuar nga pjesëmarrja e këtyre shpenzimeve sipas organizatave buxhetore, pjesën më të madhe e përbëjnë organizatat e nivelit lokal (komunat). Në vijim, janë pasqyruar shpenzimet sipas nenit 39.2 të LMFPP sipas organizatave buxhetore:

Bazuar në raportet e auditimit të OB-ve për vitin 2021, me rastin e rishikimit të procesit të këtyre pagesave, nuk kemi vërejtur parregullsi dhe se procedura për trajtimin e kërkesave të furnitorëve për obligimet e vonuara dhe të papaguara sipas nenit 39.2 të LMFPP-së është zbatuar me konsistencë nga ana e Thesarit.

8.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore

Mbështetur në LMFPP, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi, dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrorit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.

Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe vendimeve të përmbartuesve privat për vitin 2021 ishin në vlerë 51,917,629€. Në raport me vitin 2020, vlera e këtyre pagesave është rritur për 21,952,318€ apo 73%, ndërsa në raport me vitin 2019, rritja është më e madhe për 26,083,391€ apo 101%. Përderisa shkaktarët e kësaj gjendje janë pothuajse të njëjtë me vitet paraprake, mund të themi se trajtimi i këtyre shkaqeve nga përgjegjësit nuk ishte në nivelin e duhur.

12. Vlerat në tabelën e mësipërme janë sipas shënimeve të SIMFK-së, përderisa në RVF_BRK 2021 kemi disa diferenca të vogla.

Tabela 24 - Pagesat me vendim të gjykatave dhe përbarimeve për tri vitet e fundit (në €)

Pagesat sipas kategorive	2021	2020	2019
Pagat dhe mëditjet	19,998,545	73,976	819,679
Mallrat dhe shërbimet/komunalitetë	10,697,725	12,881,930	7,088,607
Subvencione dhe transfere	1,237,288	259,151	603,395
Investimet kapitale	19,984,071	16,750,254	17,322,557
Gjithsej:	51,917,629	29,965,311	25,834,238

Pagesat për organizata të nivelit qendrorë ishin 20,010,276€, apo 39% e totalit, ndërsa pagesat në nivelin lokal ishin në vlerë prej 31,907,353€ apo 61% e totalit të vendimeve gjyqësore. Më poshtë, në mënyrë grafike, janë pasqyruar 11 organizata buxhetore tek të cilat janë ekzekutuar pagWesa në vlera më të mëdha se 1,000,000€ të cilat e përbëjnë mbi 76% të shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore mbi 39,500,000€.

Grafiku 1. Pagesa të kryera me vendime gjyqësore sipas OB-ve me vlerat më të larta



Moskryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbartimore) dhe shpenzimeve të interesit. Këto kosto shtesë kanë dëmtuar buxhetet e këtyre OB-ve dhe rrjedhimisht edhe objektivat e parapara t'i realizonin me ato mjete. Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë investimet kapitale, i bie se shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar si rezultat i këtyre kostove.

Pjesa më e madhe e vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me: kompensimin e punëtorëve për paga jubilarë dhe përcjellëse të cilat ishin të rregulluara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave; pagesa të shpronësimeve si rezultat i ankesave të pronarëve që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit; si dhe vonesa në pagesat e faturave nga ana e OB-ve për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës apo mungesës së mjeteve buxhetore.

Nga analiza e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore në SIMFK dhe bazuar në auditimet e OB-ve, ne kemi vërejtur se në shumicën e këtyre pagesave, Thesari nuk e ka bërë ndarjen e shpenzimeve të borxhit kryesor kundrejt shpenzimeve të procedurave përmbartimore gjyqësore, siç është e paraparë me planin kontabël. Nga gjetjet e raportuara në raportet individuale dhe shënimet e ofruara nga OB-të, ka rezultuar që nga vlera e pagesave përmes vendimeve gjyqësore prej 31,259,076€, shpenzimet shtesë ishin 5,346,800€ apo 17%, përderisa nga informatat e pranuar nga Thesari nga vlera e pagesave të ekzekutuara direkt nga Thesari prej 40,467,967€ rezultojnë shpenzime shtesë në vlerë 8,937,159€.

Më tutje, edhe në vitin 2021, kishte shpenzime nga vendimet gjyqësore të cilat ishin të keq klasifikuara në kategori ekonomike, duke shkaktuar nënvlerësim/mbivlerësim të kategorive ekonomike në PFV për të njëjtën shumë.

Rekomandim për Qeverinë

- Që përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime të panevojshme nga proceset eventuale gjyqësore si pasojë e mos përmbushjes së obligimeve eventuale që burojnë nga këto marrëveshje.

Rekomandim për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

- Ministri në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të siguroj që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbartimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.

9. Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 08/L-016 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, numri i lejuar i të punësuarve për nivelin qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura), dhe nivelin lokal ishte 86,188¹³, përderisa numri aktual i të punësuarve sipas RVF të BRK-së ishte 81,527¹⁴. Këtu duhet theksuar se numri i të punësuarve i prezantuar në

PFV të organizatave buxhetore është 80,677¹⁵, përkatësisht 850 më pak se numri i prezantuar në RVF-BRK.

Diferenca kryesisht ndikohet nga të dhënat e nivelit lokal, ku në disa raste RVF-BRK në kuadër të të punësuarve faktik ka përfshirë edhe asamblesitat e kuvendeve komunale, përderisa të njëjtit kryesisht nuk janë prezantuar nga PFV-të e komunave. Po ashtu duhet theksuar se Komuna e Mitrovicës Veriore kishte prezantuar të punësuar aktual 875 (sipas buxhetit të rishikuar), ndërsa sipas RVF-BRK ky numër është 524. Te Universteti i Prishtinës numri i të punësuarve është paraqitur 1,578 përderisa sipas PFV të OB-së dhe konfirmimit të ekipit auditues ishte 1,728.

Nëse e krahasojmë numrin e të punësuarve aktual të vitit 2021 me numrin faktik për të punësuarit në vitin 2020 (81,690), kemi një rënie për 163. Siç shihet, organizatat buxhetore në vitin 2021 nuk kishin arritur t'i plotësojnë të gjitha vendet e punës të lejuara me ligjin e buxhetit. Dallimi në mes numrit të lejuar dhe aktual i të punësuarve ishte për 4,661.

Mos plotësimi i numrit të aprovuar të të punësuarve sipas ligjit të buxhetit për vitin 2021, mund të rezultojë me performancë të dobët në nivel të organizatës dhe mos arritje të planeve dhe objektivave të synuara. Ndërsa mos përputhja e të dhënave mes PFV-ve të organizatave buxhetore dhe të dhënave në RVFBRK mund të rezultojë në prezantim jo të drejtë dhe jo të saktë lidhur me të dhënat e numrit të punëtorëve në nivel të administratës publike, rrjedhimisht mund të ndikojë edhe në keqinformimin e palëve të jashtme.

13. Prej tyre 41,884 ishin të punësuar të aprovuar në nivel qendror dhe institucione të pavarura dhe 44,304 të punësuar aprovuar në nivel lokal.

14. 38,533 numri faktik i të punësuarve në nivelin qendror dhe institucione të pavarura (përfshirë Zyrën Kombëtare të Auditimit (159 të punësuar) dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës (98 të punësuar) dhe 42,994 të punësuar faktik në nivelin lokal.

15. Këtu nuk janë përfshirë të punësuarit për Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës.

9.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave

Sipas PFV-ve të BRK-së për vitin 2021, numri total i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 1,784, ku institucionet e nivelit qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura) i kishin 1,576 ndërsa niveli lokal 208 punësuar jashtë listës së pagave. Nëse krahasojmë me vitin e kaluar kemi një rritje për 1,141 të punësuar (në 2020 numri i të punësuarve ishte 643). Mirëpo, duhet theksuar se numri i të punësuarve jashtë listës së pagave i prezantuar në PFV të organizatave buxhetore është 1,952¹⁶, përkatësisht 168 më shumë se numri i prezantuar në RVF-BRK. Diferencat janë për shkak se në RVF BRK nuk ishin paraqitur stafi prej 169 i angazhuar nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe në anën tjetër, RVF BRK ka paraqitur një person te Institucioni i Avokatit të Popullit, përderisa sipas konfirmimeve të ekipit auditues, nuk ka staf jashtë listës së pagave në këtë institucion (ndonëse PFV e organizatës kishte shpallur një person). Në vijim janë OB-të me numrin më të lartë të të punësuarve jashtë listës së pagave:

- Në Ministrinë e Shëndetësisë, ishin angazhuar 1,460 persona me vendim të qeverisë për menaxhimin e pandemisë COVID 19;
- Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit ishin 169 punëtorë të angazhuar për përgatitjen e materialit mësimor gjatë procesit të organizimit të mësimit në distancë;
- Në Komunën e Mitrovicës Jugore ishin 62 persona si staf i angazhuar pa procedura të rekrutimit;
- Në Komunën e Fushë Kosovës ishin angazhuar 53 punonjës jashtë numrit të planifikuar me buxhet në drejtorinë e arsimit për zëvendësimin e punonjësve të arsimit.
- Në Komuna e Drenasit ishin angazhuar 32 persona si staf në sektorin e arsimit për zëvendësimin e lehonave.

9.2 Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta

Sipas RVF-BRK për vitin 2021, numri total i të angazhuarve përmes MSHV-ve ishte 63,841, numër ky i konfirmuar edhe sipas PFV-ve të organizatave buxhetore. Prej tyre, 62,417 janë të angazhuar nga KQZ në procesin e zgjedhjeve parlamentare të mbajtura me 14 shkurt 2021 dhe në zgjedhjet lokale të mbajtura në muajt tetor dhe nëntor 2021.

Duke përjashtuar stafin të angazhuar nga KQZ, edhe në vitin 2021 kishte një numër të këtyre të punësuarve që ishin qoftë të trashëguar ndër vite a po të angazhuar pa ndonjë procedurë gjatë vitit 2021 për pozita të rregullta të punës.

Megjithatë analizuar nga numri i të angazhuarve me MSHV (duke përjashtuar stafin e MSHV në KQZ) për gjatë tri viteve vërehet një trend në rënie¹⁷ i të punësuarve përmes MSHV.

16. Këtu nuk janë përfshirë të dhënat për Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës.
17. Në vitin 2021 ishin 1424, në 2020 ishin 2232 dhe në 2019 ishin 2744 (Në këta numëra janë përjashtuar të angazhuarit në KQZ)



II

Përmbledhje e rezultateve nga auditimet individuale



10. Opinionet e auditimeve dhe konkluzioneve të dalura nga raportet në raportet individuale 2021

ZKA-ja për vitin 2021, ka përfunduar 90 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin qendror dhe lokal të organizatave buxhetore¹⁸. Auditimet janë kryer në bazë të doracakut dhe metodologjisë së përditësuar të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Në bazë të kësaj metodologjie ne kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat Financiare, në përputhje me SNISA-t, dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën Organizatë Buxhetore (OB).

10.1. Përmbledhje e opinionëve të auditimeve për PFV-të e OB-ve

Opinionet e auditimit në lidhje me Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) e OB-ve, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 25-Lloji dhe numri i opinionëve për PFV-të individuale të OB-ve për vitin 2021

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	Totali
Niveli Qendror ¹⁹	8	14	1	23
Niveli Lokal	13	24	1	38
Institucionet e Pavarura	25	4	0	29
Totali	46	42	2	90

Nga 90 të PFV-ve individuale të OB-ve 46 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 44 me opinion të modifikuar (42 opinione të kualifikuara dhe 2 opinione të kundërta). Krahasuar me vitin 2020 opinionet e modifikuara janë rritur për 17 PFV të OB-ve (2020 ishin 27) që tregon se numri i OB-ve të cilat kanë pasur gabime me raportimin dhe shpalosjen e informatave të kërkuara në PFV është në rritje, dhe se ky ndryshim është reflektuar kryesisht te niveli lokal.

Arsyet kryesore për modifikimin e opinionëve të auditimit ishin paraqitjet jo të drejta dhe të sakta të informatave në PFV. Modifikimi i opinionëve është ndikuar nga klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve (nga planifikimi i gabuar, nga pagesat me vendime gjyqësore/përmbartimore dhe nga vetë OB-të), raportimi jo i saktë i pasurive

18. Në këto auditime nuk janë përfshirë Ndërmarrjet Publike, për të cilat, çështjet janë paraqitur në pjesë të veçantë në këtë raport.

19. Në Institucionet e Nivelit Qendror janë: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, SHSKUK, ATK, Dogana dhe RTK.

kapitale dhe jo kapitale, pagesat për punëtorët që nuk kanë vijuar punën (te Ministrinë – për ish pjesëtarët e mbrojtjes civile), shpalojta jo e saktë e Llogarive të Arkëtueshme dhe Detyrimeve Kontingjente²⁰ në PVF-të individuale etj.

Në disa raste, modifikimi i opinionit ka rezultuar si pasojë e ndikimeve jashtë OB-ve për të cilat OB-të nuk kanë pasur mundësinë e korigjimeve të duhura. Kjo ishte si pasojë e ndarjeve jo adekuate me Ligjin e buxhetit apo vendimeve të Qeverisë, përkundër që disa OB²¹ kërkesat buxhetore i kishin bërë në kategoritë adekuate apo ridestinin të buxhetit nga MFPT. Për më tepër, raste të ngjajshme të keqklasifikimit kishte edhe në Komunën e Rahovecit dhe Suharekës, të cilat nuk kishin mundësinë që mjetet e buxhetuara për transfere kapitale ti rialokonin në kategorinë përkatëse për Subvencione. Ndërsa, keqklasifikimet e evidentuara në 14 Komuna lidhur me pagesën e pagave jubilarë, bazuar në kontratën kolektive, kanë të bëjnë me pagesat që janë realizuar nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore /përmbarimore, për të cilat komunat nuk kishin mundësitë buxhetore për pagesë për shkak të mos ndarjeve buxhetore për këtë qëllim. Në këtë vit janë dhënë edhe dy opinione të kundërta për Radio Televizionin e Kosovës dhe Komunën e Istogut. Opinioni i kundërt për RTK ishte për shkak se i ka njohur të hyrat në kundërshtim me standardin ndërkombëtar të raportimit financiar, në mungesë të konfirmimeve të saldove nga ana e furnitorëve, mos prezantimi i drejtë i obligimeve ndaj furnitorëve etj. Ndërsa te Komuna e Istogut për shkak të mos përgatitjes së PVF-ve në pajtim me kërkesat ligjore dhe gabimeve në prezantimin dhe shpalojen e vlerave.

10.2. Përmbledhje e konkluzioneve për pajtueshmëri

Përveç auditimit financiar që për objektiv ka përgjigjen në pyetjen nëse Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë, në kemi audituar edhe aspektin e pajtueshmërisë nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit. ZKA-ja për vitin 2021, ka dhënë edhe konkluzione të pajtueshmërisë për të gjitha OB-të e audituara.

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me OB-të, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

20. Në vlera materiale kjo është më e dukshme te Komuna e Prishtinës për 23 mil. dhe Komuna e Prizrenit për 10 mil.

21. MASHT, MSH dhe MM.

Tabela 26 – Lloji dhe numri i konkluzioneve të OB-ve për vitin 2021

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Konkluzion i kundërt	Totali
Niveli Qendror	10	12	1	23
Niveli Lokal	1	32	5	38
Institucionet e Pavarura	24	5	0	29
Totali	35	49	6	90

Nga 90 OB-të e audituara 35 konkluzione janë të pamodifikuara dhe 55 të konkluzione të modifikuara (49 të kualifikuara dhe 6 të kundërta). Sipas tabelës vërehet se rreth 61% të OB-ve kanë konkluzion të modifikuar që tregon se kanë probleme me pajtueshmërinë me autoritetet, apo transkasionet financiare nuk janë në pajtim me kërkesat ligjore.

Arsyet kryesore për konkluzion të kualifikuar dhe të kundërt ishin kryesisht lidhur me: angazhimin e zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa udhëhequr procedurat e prokurimit, mos verifikimi i 20% të pronave të tatueshme siç kërkohet me Ligj, mos respektimi i procedurave të prokurimit tek procesi i tenderimit, mungesa e planeve vjetore për subvencionim të OJQ-ve, përdorimi i kontratave jo adekuate që ka shkaktuar tejkallim të vlerës së tyre në raport me vlerën e parashikuar etj.

Te Radio Televizioni i Kosovës, arsyeja për konkluzion të kualifikuar ishte lidhur me pagesat për shtesa dhe shpërblime për punonjësit e saj, përkundër rekomandimit të Bordit për ndalimin e pagesës për shtesa dhe shpërblime.

10.3 Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2021

Në raportet individuale të OB-ve për vitin 2021 kemi dhënë 695 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Në tabelën e mëposhtme i kemi paraqitur rekomandimet e dhëna për tri vitet e fundit.

Tabela 27 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të OB-ve

Subjektet e audituara	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Niveli Qendror	204	244	263
Niveli Lokal	438	367	488
Institucionet e Pavarura	53	43	52
Total	695	654	803

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për rritje të numrit të rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak. Rritja më e madhe e numrit të rekomandimeve këtë vit vërehet tek komunat përdërisa rritje kemi edhe tek institucionet e pavarura, ndërsa rënie kemi tek institucionet e nivelit qendror.

11. Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm i sistemit i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP), dhe mbështetës për auditorët e brendshëm duke siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në kuadër të objektivave të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike është avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillimin profesional, sigurimit të cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore.

Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm është koordinatore e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera monitoron subjekte të sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Edhe pse plani vjetor NJAB-ve ishte realizuara prej 95%, nga auditimet individuale për sistemin e auditimit të brendshëm identifikuam mangësitë si në vijim:

- Veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i OB-ve në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm ishin jo të kënaqshme, për faktin se 59% e rekomandimeve të dhëna ishin të pazbatuara apo në proces;
- Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm përcakton kriteret që duhet plotësuar për themelimin e NjAB-së dhe përcakton numrin minimal të auditorëve që duhet të ketë OB-ja. Bazuar në këto kriteret kemi identifikuar se, prej 63 OB-ve përkundër që e plotësojnë kriterin Komuna e Mitrovicës së Veriut dhe e Leposaviqit nuk e kishin të themeluar NjAB-në. Përderisa sa i përket stafit të mjaftueshëm me auditor nga 61 OB që kanë NjAB-në, prej tyre në 33 OB apo 54% kishin numër të auditorëve më pak se sa që e parasheh rregullorja.
- Nga 61 OB-të që e kishin NjAB-në, në katër (4)²² prej tyre nuk e kishin themeluar KA në vitin 2021. Më tej, nga 57 OB ku funksiononte KA është vërejtur se në 13 prej tyre, KA-të kishin mbajtur me pak se katër (4) takime apo jo në pajtueshmëri me kërkesat UA 01/2019. Po ashtu, 25 KA nuk e kishin dorëzuar raportin vjetor siç kërkohet me nenin 10 të UA 01/2019. Kjo tregon se KA-të ende nuk janë mjaftueshëm efektive për të mbështetur plotësisht punën e NjAB-së.

Auditimet e brendshme vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në auditime të performancës dhe të sistemeve.

Sistemi i kontrollit të brendshëm përkundër përmirësimeve nga viti i kaluar, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, në mënyrë që AB-të të veprojnë si këshilltarë dhe mekanizëm parandalues i gabimeve dhe parregullsive.

Rekomandim për Qeverinë

- Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në sipas rregullores QRK-nr. 01/2019, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, shërbimet e auditimit të brendshëm t'i realizojnë përmes mënyrave tjera të parapara me këtë rregullore; dhe

- Po ashtu, përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së, dhe që këto Komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve, në raportime vjetore siç kërkohet me UA dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së.

12. Prokurimi

Në vitin 2021, përmes prokurimit publik 160 AK kanë lidhur 9,892 kontrata në vlerë mbi 429,6 milion€, prej tyre 7,175 kontrata të prokurimit ishin nga OB-të apo 73% dhe 2,712 kontrata ishin të ndërmarrjet publike apo 27%, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rënie në vlerë prej 14% (499,3 milion€).

Burimi kryesor i financimit për tenderët publik ishte nga buxheti i Kosovës me rreth 80%, nga të hyrat vetjake me afër 19% dhe 0,4% ishin financiar nga donacionet.

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) ka mandat të veprorë si autoritet kontraktues në emër të të gjitha OB-ve, por, nuk ka iniciuar asnjë aktivitet të prokurimit gjatë vitit 2021 për shkak se ka munguar vendimi i Qeverisë së Kosovës për listën e artikujve për përdorim të përbashkët.

Megjithatë, AQP-ja ka lidhur tri kontrata të centralizuara në vlerë prej 9,5 milion euro për aktivitetet e prokurimit që ishin iniciuar në vitin 2020. Përveç kësaj, AQP-ja ka zhvilluar 82 aktivitete të prokurimit (për 16 IP) dhe ka lidhur po aq kontrata për OB-të që nuk e kanë funksionin e prokurimit të inkuorporuar brenda organizatës së tyre (agjencitë e pavarura me më pak se 50 të punësuar). Vlera e këtyre kontratave është mbi 1,6 milion euro ose 6,6% më lartë se në vitin paraprak.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), mandati i të cilit është të shqyrtojë ankesat nga palët me interes lidhur me shkeljet e pretenduara të Ligjit të Prokurimit Publik, ka qenë jo funksional që nga prilli i vitit 2021 për shkak se ka i munguar Bordi. Sipas raportit vjetor 2021 të OSHP-së, gjatë vitit janë pranuar gjithsej 881 ankesa, prej tyre, ishin shqyrtuar 255 ankesa të parashtruara deri në prill të vitit 2021, ndërsa 626 ankesat tjera apo 71% e tyre kanë mbetur pa u trajtuar.

Vendimet e OSHP-së kanë qenë në favor të OE në 43% të rasteve apo 110 aktivitete të prokurimit të cilat janë kthyer në rivlerësim, 79 vendime janë aprovuar në favor të AK që përbëjnë 31% të numrit të përgjithshëm të ankesave të shqyrtuara, dhe të tjera janë 26.

Numri i ankesave të dorëzuara gjatë vitit 2021 ka shënuar rënie prej më shumë se 25% në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë, edhe këtë vit raporti i ankesave kundrejt aktiviteteve të prokurimit mbetet 1 ankesë për çdo të 11-tin tender të publikuar. OSHP-ja nuk ka shqyrtuar asnjë gjorbë për AK-të apo për OE-të gjatë vitit 2021.

Çështja më e shpeshtë që është vërejtur në tenderët publik është hyrja në obligime kontraktuese pa buxhet të mjaftueshëm si dhe zhvillimi i aktivitetit të prokurimit dhe lidhja e kontratave (të ndërtimit) në mungesë të projekteve kryesore (ekzekutive).

Zyra Kombëtare e Auditimit e ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të OB-ve për vitin 2021, që ka rezultuar me gjetje të ndryshme në fushën e prokurimit që kanë të bëjnë me fazën e planifikimit, tenderimit dhe të menaxhimit të kontratave.

Parregullsitë në fushën e prokurimit publik

Në raportet individuale të auditimit janë raportuar gjithsej 92 çështje lidhur me prokurimin, në të gjitha fazat e aktivitetit të prokurimit, nga planifikimi deri në menaxhimi i kontratave publike. Çështjet që kanë të bëjnë me hartimin e dosjes së tenderit janë gjithsej 33, mangësi gjatë vlerësimit të tenderëve janë 11 dhe 48 çështje të raportuara që kanë të bëjnë me mangësi në menaxhimin e kontratave.

Këto çështje paraqiten në gjithsej 40 entitete të audituara, 28 prej të cilave janë për komunitet, tetë (8) janë për ministri dhe katër (4) janë për agjenci (të pavarura ose ekzekutive).

Tabela 28 - Dobësitë e përsëritura në prokurimin publik

Çështja	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga autoritetet kontraktuese
Hyrja në obligime kontraktuese pa siguruar buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e kontratave.	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ka rezultuar me vonesa në zbatimin e kontratave ose vonesa në pagesa të obligimeve, njëkohësisht ka rezultuar me rritje të obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për periudhat vijuese.	Të forcojnë kontrollet duke siguruar që para inicimit të aktivitetit të prokurimit, të buxhetohen fondet të mjaftueshme për realizimin e projekteve të kontraktuara.
Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për kontrata për punë, në mungesë të projektit kryesor (ekzekutiv).	Inicimi i aktivitetit të prokurimit në mungesë të projektit kryesor ka rezultuar me anashkalim të kërkesës ligjore dhe mund të rezultojë me kosto shtesë apo mos realizim të plotë të projekteve që për pasojë reflektohet me vlerë të ulët për parane dhe shpenzuar.	Përmes menaxherit të prokurimit, të sigurojnë që asnjë aktivitet i prokurimit që ka të bëjë me punë të mos iniciohet pa u siguruar se ekziston projekti kryesor (ekzekutiv). Parapërgatitjet e duhura për një projekt nga njësi kërkuese do të kenë efekt direkt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.
Aplikimi i procedurave të duhura të prokurimit (kuotim i çmimit/procedurë me vlerë minimale/procedurë e negociuar publikim të njoftimit për kontratë).	Aplikimi i procedurave të tilla të prokurimit e zvogëlon konkurrencën dhe Transparencën, e bën autoritetin kontraktues jo efikas dhe rrit rrezikun që të blejë produkte me çmime jo ekonomike (më të shtrenjta se çmimet e tregut).	Të sigurojnë se procedura e prokurimit është në përputhje me natyrën e blerjes. Aty ku kërkesat mund të grumbullohen të zhvillohet procedurë e hapur duke shmangur procedurat me vlerë minimale dhe kuotimet e çmimit. Gjithashtu, të sigurojnë se procedura e negociuar përdoret vetëm në rastet e jashtëzakonshme siç është paraparë me ligj.

<p>Dhënia e kontratave operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm/komisionet për vlerësimin e tenderëve kanë anashkaluar kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit.</p>	<p>Dhënia e kontratës operatorëve ekonomik që nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, paraqet diskriminim. Kjo mund të rezultojë me ankesa nga operatorët ekonomik dhe rrjedhimisht të prolongojë përmbylljen e aktivitetit të prokurimit. Gjithashtu, mund të ndikojë që operatorët e shpërblyer të mos i dorëzojnë mallrat/ përfundojnë punët sipas cilësisë që kërkohet.</p>	<p>Të sigurojnë se po respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nga komisionet e vlerësimit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.</p>
<p>Komisionjo adekuat për pranim të punëve/projekteve ndërtimeore.</p>	<p>Pranimi i projekteve në mungesë të anëtarëve kompetent të komisionit të pranimit paraqet rrezik që të pranohen punë/projekte që s'janë në përputhje me kushtet e kontratës ose të cilësisë më të dobët.</p>	<p>Të sigurojnë se caktojnë persona kompetent për pranimin e punëve/projekteve në mënyrë që të sigurohet pranimi sipas kushteve të kontratës dhe cilësisë së paraparë.</p>
<p>Tejkalimi i sasive mbi 30% në kontrata kornizë.</p>	<p>Tejkalimi i kontratës kornizë mbi tavanin e lejuar, mund të rezultojë dhënie të kontratës ofertuesit që nuk është më i liri, por kjo mund të vërehet vetëm pasi që të jetë ekzekutuar kontrata gjë që e bën aktivitetin e prokurimit jo-ekonomik. Tejkalimi i sasive në pozicione të caktuara e fut autoritetin kontraktues në obligime të pa planifikuara.</p>	<p>Të sigurojnë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar prej 30%, si në çmimin total të kontratës, poashtu, edhe për pozicione individuale brenda kontratës. Kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.</p>
<p>Aneks kontratat deri në 10% të vlerës së kontratës bazë.</p>	<p>Anashkalimi i procedurave të hapura në rastet kur sasi të shtesë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës mund të ndikoj në dëmtim të konkurrencës. Gjithashtu, ndryshimi i paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar vë në dukje dobësitë e kontratës dhe të kontrolleve të ushtruara nga menaxhmenti.</p>	<p>Të sigurojnë se specifikat teknike janë hartuar në harmoni me projektet ekzekutive dhe aprovimet e ndryshimeve duhet të bëhen vetëm për rastet e lejuara me ligj. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë, të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme. Në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.</p>
<p>Shtyrje të afateve/vonesa në ekzekutimin e kontratave.</p>	<p>Vonesat në ekzekutimin e kontratave rezultojnë me jo efikasitet në dorëzimin e projekteve te qytetarët.</p>	<p>Të marrin të gjitha masat për të parandaluar paraqitjen e vonesave, të marrin parasysh veprimet që duhet ndërmarrë në fazën para tenderimit (shpronësimet/hartimin e projekteve kryesore) si dhe veprimet pas dhënies së kontratës (menaxhimi efektiv i kontratave, përfshirje aktive e menaxherëve të autoritetit kontraktues për të siguruar se kontratat ekzekutohen siç janë paraparë).</p>

Rekomandim për Kuvendin

Kuvendi përmes mekanizmave mbikëqyrës të siguroj se aktivitetet e prokurimit ofrojnë konkurrencë dhe transparencë në mesin e ofertuesve sipas kërkesave ligjore dhe përdorimit të procedurave adekuate të prokurimit për të siguruar kontrata më ekonomike.

13. Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19

Në vitin 2021, shpenzimet e buxhetuara për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin 254,291,807€, prej të cilave ishin shpenzuar 234,026,687€ apo 92%. Këto kanë të bëjnë me mjetet e ndara me vendime të Qeverisë sipas autorizimeve të Ligjit të Buxhetit të vitit 2021 për: zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike lidhur me mbështetjen e rikthimit në punë të atyre që e kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë; mbështetjen e të punësuarve të formalizuar; mbështetjen e punësimit të grave; pagesën e lehonave; pagesën e shtesave të fëmijëve; mbështetjen e familjeve për humbjen e familjarit nga Covid-19; financimit të interesit të kredisë; mbështetjen e fermerëve dhe bujqve; mbështetjen e ndërmarrjeve publike dhe subvencionimin e tejkalimit të krizës energjetike; furnizime mjekësore; kompensimin e pagave të stafit, etj.

Tabela 29- Totali i pagesave për menaxhimin e pandemisë Covid-19

Përshkrimi	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike (kodi 0098)	242,036,090€	229,143,042€	95%
Pakoja Emergjente (kodi 0099)	12,255,718€	4,883,645€	40%
Gjithsej	254,291,808€	234,026,687€	92%

Buxheti dhe pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin nga Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike dhe Pakoja Emergjente të cilat janë të paraqitura sipas kategorive përkatëse në tabelat ndaras si në vijim:

Tabela 30 - Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 - Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike (00098)

Kategoria ekonomike	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	22,750,147€	22,750,147€	100%
Mallra dhe shërbime	24,691,620€	17,134,297€	69%
Shërbime komunale	47,000€	23,894€	51%
Subvencione dhe transfere	194,547,323€	189,234,704€	97%
Gjithsej	242,036,090€	229,143,042€	95%

Tabela 31 - Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 - Pakoja Emergjente (00099)

Kategoria ekonomike	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	85,539€	68,740€	80%
Mallra dhe shërbime	10,288,672€	3,693,413€	36%
Subvencione dhe transfere	749,013€	695,812€	93%
Shpenzime kapitale	1,132,494€	425,680€	38%
Gjithsej	12,255,718€	4,883,645€	40%

Siç shihet në tabelat e mësipërme (në të dy pakot), pjesa më e madhe apo 81% e shpenzimeve ishte realizuar në kategorinë për subvencione dhe transfere, 10% për paga dhe mëditje, rreth 9% për kategorinë mallra dhe shërbime dhe 0,2% për investime kapitale.

Ministria e Financave, përkatësisht Thesari me datën 10.12.2021 kishte nxjerr Qarkoren mbi proceset dhe afatet për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore 2021. Në këtë qarkore ishte kërkuar që pasqyrat financiare të OB duhen të përmbajnë një seksion të veçantë (shtojcë), ku raportohen dhe shpalosen shpenzimet lidhur me menaxhimin e pandemisë (Covid-19), me shpjegimet e nevojshme për transparencë buxhetore. Bazuar në këtë, OB kishin shpalosur shpenzimet për menaxhimin e pandemisë, me përjashtim të ZKM-së në vlerë prej 850,414€ dhe MBPZHR në vlerë prej 19,343,924€.

Zyra Kombëtare e Auditimit në dhjetor të vitit 2021 ka publikuar Raportin e auditimit të performancës për furnizimin me barna dhe materiale shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me Covid-19. Auditimi ka konkluduar se institucionet publike shëndetësore përkundër sfidave kanë arritur të riorganizojnë dhe të vendosin disa procese të duhura të cilat kanë ndihmuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët me Covid-19 duke u bazuar në mundësitë dhe kapacitetet teknike dhe resurset njerëzore në dispozicion për trajtimin e pacientëve.

Rekomandim për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Thesari të siguroj se OB-të respektojnë rregullat me rastin e përgatitjes së PFV-ve për vitin 2022 duke i përfshirë shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19.





III

Auditimet e performancës dhe ndërmarrjeve publike

14. Auditimet e performancës, prokurimit dhe TI-së

Zyra Kombëtare e Auditimit, vazhdon me fokus të veçantë ndaj auditimeve të performancës, si faktor i rëndësishëm në ndryshimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Auditimet e performancës vlerësojnë se sa fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive dhe në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Përmes rezultateve të auditimit, Kuvendi dhe qytetarët do të jenë në gjendje që t'i mbajnë llogaridhënës administruesit e fondeve publike. Për sezonin auditues 2021-2022 janë mbuluar fusha me rëndësi ekonomike, ambientale, shëndetësore, të sigurisë dhe fushën e prokurimit publik dhe projekteve nga donatorët. Përmes këtyre auditimeve, Zyra Kombëtare e Auditimit ka synuar të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

ZKA-ja në vitet e fundit një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Këto auditime janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të pasur siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë, dhe efektivitetit të sistemeve të informacionit. Këtë sezonë janë përfshirë sisteme të informacionit me ndikim në institucionet publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Gjatë sezonit raportues, janë kryer 14 raporte të auditimit të performancës përfshirë prokurimin dhe teknologjisë së informacionit. Në vijim, shkurtimisht është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Tema 1: Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra.

Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) përbëjnë një element të rëndësishëm të sektorit të energjisë në Kosovë dhe është njëri nga format e rëndësishme për shfrytëzimin maksimal të resurseve natyrore për prodhimin e energjisë elektrike. Institucionet përgjegjëse, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duhet t'i sigurojnë qytetarët se shfrytëzimi i ujërave nga hidrocentralet për prodhimin e energjisë elektrike në vend realizohet në mënyrën e duhur sipas lejeve dhe licencave dhe se sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe ujërave nga kjo veprimtari. Në auditim janë përfshirë edhe niveli lokal, komunat: Deçan, Mitrovicë, Dragash dhe Shtërpçë.

Mesazhi i auditimit: *Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë mjaftueshëm për të mbrojtur mjedisin dhe ujërat nga operatorët ekonomik gjatë prodhimit të energjisë elektrike nga shfrytëzimi i ujit duke mundur që Hidrocentralet të operojnë pa zbatuar kriteret e kërkuara. Sistemi i vendosur nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka ofruar siguri të mjaftueshme se janë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara gjatë procesit të licencimit.*

Nuk ka një koordinim mes palëve për arritjen e caqeve vullnetare për prodhimin e energjisë elektrike nga uji. Mungojnë Plani për Administrimin e Ujërave dhe zbatimi i procesit të koncesionimit gjatë dhënies së të drejtës për shfrytëzim të ujit. Po ashtu mungonin licencat e prodhimit për Hidrocentralet të cilat kishin filluar operimin, dhe nuk ishin të pajisur me leje mjedisore dhe leje ujore gjatë aktiviteteve të prodhimit të energjisë elektrike. Ndërtimi i tyre nuk ishte realizuar sipas kriterëve duke u ndërtuar në afërsi të lumit kështu duke rrezikuar ujërat dhe mjedisin. Dështimet dhe dobësitë në inspektimin dhe përcjelljen e tyre nga inspektorati ishin evidente. Këto mangësi kanë ndikim negativ direkt në ujëra dhe mjedis nga hidrocentralet e gjithashtu kanë efekt negativ financiar dhe në mirëqenien e qytetarëve.

Tema 2: Menaxhimi i fondeve publike në Radio Televizionin e Kosovës

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) është i vetmi transmetues publik i cili i ofron shërbime publikut në fushën e veprimtarisë së radios dhe televizionit. Operon me katër kanale televizive dhe dy radio të cilat transmetojnë një gamë të gjerë programesh në kohëzgjatje 24 orë në rrjetin tokësor dhe satelitor. Themelues i institucionit publik të RTK-së është Kuvendi i Kosovës, i cili ka për detyrë që të mbrojë autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së. Qëllimi i auditimit ishte të vlerësojmë nëse Radio Televizioni i Kosovës ka menaxhuar në mënyrë të duhur fondet publike.

Mesazhi i auditimit: *Radio Televizioni i Kosovës nuk ka menaxhuar si duhet me fondet publike të dedikuara për burimet njerëzore dhe programet vendore. Mangësitë janë evidente që nga planifikimi, kontraktimi, menaxhimi dhe monitorimi i punës së burimeve njerëzore, përfshirë stafin e rregullt, angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm si dhe kontraktimin e programeve vendore. Kontrolli i dobët mbi menaxhimin e stafit të rregullt duke mos respektuar edhe vendimet e Bordit nga menaxhmenti, i ka kushtuar RTK-së keq menaxhim financiar në vlerë prej 806,898 euro për tre vitet (2019, 2020, 2021).*

Raporti thekson se angazhimi i stafit të rregullt nuk ishte bërë sipas projeksioneve buxhetore dhe nuk ishin respektuar procedurat e rekrutimit. Mbi 70% e angazhimeve të punëtorëve janë lidhur për pozita të rregullta pa një proces transparent dhe konkurrues duke mos shpallur konkurs publik, në anën tjetër këta persona nuk kanë gëzuar të drejtat e punëtorëve të rregullt si pushimin vjetor, shujta etj. Sistemimi dhe avancimi i stafit të Radio Televizionit të Kosovës është përcjell me mangësi të shumta, në raste të caktuara duke shpërfillur vendimet e Bordit dhe shkaktuar kosto shtesë. Gjithashtu, nuk është bërë vlerësim i detajuar për nevojat e programeve të jashtme nga drejtorët programor dhe nuk janë marrë për bazë disa nga kriteret për përzgjedhjen e këtyre programeve.

Tema 3: Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare

Arsimi fillor ka një rëndësi të madhe për të gjithë komunitetin dhe është një mekanizëm i fuqishëm për rritje të qëndrueshme ekonomike. Për të konkurruar dhe arritur sukses në një treg shumë kërkuar të punës dhe një ekonomi globale gjithnjë në rritje, duhet investuar në aftësitë sociale të nxënësve për të mësuar, zgjidhur problemet dhe për të komunikuar. Për të përfituar nga arsimi, një qeveri vendos mekanizmat arsimorë që ndihmojnë nxënësit të bëhen pjesë e botës me aftësitë dhe njohuritë e tyre.

Qëllimi i auditimit ka qenë të vlerësojmë nëse Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe shkollat kanë marrë masat e nevojshme për të përmirësuar gjendjen aktuale të rezultateve të nxënësve.

Mesazhi i auditimit: *Ka mangësi në metodologjinë e vlerësimit të nxënësve dhe mos zbatim të kërkesave që dalin nga kurrikula. MASHTI, drejtoritë komunale të arsimit dhe shkollat nuk kanë arritur të përmirësojnë metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me kërkesat e kurrikulës dhe praktikat më të mira të nxjerra nga Agjencia Evropiane për Sigurimin e Cilësisë. Rrjedhimisht, nxënësit vazhdojnë të marrin pjesë në orët e mësimit duke dëgjuar mësimdhënësit që ligjërojnë gjatë gjithë orëve të mësimit dhe aktivizohen vetëm në fund nëse kanë ndonjë pyetje dhe vlerësohen përmes pyetjeve me përgjigje të shumëfishta.*

Rezultatet e testeve ndërkombëtare (PISA) në të cilat ka marrë pjesë Kosova tregojnë se ne po marrim shumë pak pikë krahas me vendet e tjera (në vendin e tretë nga fundi prej 77 vendeve pjesëmarrëse), që është tregues se synimi i rezultateve sipas lëndëve në kurrikulë nuk po zbatohet siç është synuar. Në anën tjetër nxënësit kosovarë kanë arritur rezultate relativisht të mira në testet kombëtare mirëpo në testet ndërkombëtare, siç është PISA rezultatet e nxënësve janë shumë më të ulëta se mesatarja e Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe më të ulëta në rajon. Rezultatet e testit të arritshmërisë janë relativisht të larta dhe ndryshojnë shumë me vlerësimin vjetor që bëhen nga mësimdhënësit. Disa nxënës me notën 2 arritën të marrin deri në 84 nga 100 pikë. Për këtë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të analizuar këto dallime ndërmjet testeve ndërkombëtare dhe atyre kombëtare.

Tema 4: Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19

Përhapja globale e korona virusit të ri (COVID-19) që fillimisht u shfaq në Kinë dhe pastaj për shkak të përhapjes u shndërrua në pandemi në nivel global ka bërë që vendet e botës të përballën me një sfidë shëndetësore serioze duke shkaktuar shumë humbje jetë njerëzish. Për shkak të niveleve alarmuese të përhapjes, në mars 2020, OBSH-ja e shpalli COVID-19 si pandemi – përhapje e sëmundjes që mbulon një zonë

të gjerë gjeografike dhe prek një pjesë të madhe të popullsisë. Shtrirja me shpejtësi të madhe e pandemisë COVID-19 ndodhi edhe në Kosovë, e përcjellë me shumë të panjohura e që shkaktoj një ngarkesë të pa provuar më parë të sistemit shëndetësor në vendin tonë.

Qëllimi i auditimit ishte të vlerësohet procesi furnizimit me barëra dhe materiale shëndetësore të institucioneve shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19. Subjekt i auditimit ishte Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, spitali rajonal i Prizrenit dhe spitali rajonal i Pejës.

Mesazhi i auditimit: *Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore është realizuar nga institucionet e shëndetit publik duke ju përgjigjur nevojave pjesërisht krahas numrit dhe nevojave të pacientëve të infektuar me COVID-19. Përkundër këtyre, auditimi ka identifikuar disa mangësi të cilat në masë të madhe janë ndikuar nga mos funksionalizimi i plotë i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh).*

Raporti thekson se institucionet shëndetësore nuk kanë siguruar të gjitha barërat dhe materialet e nevojshme medicinale për trajtimin e pacientëve me COVID-19. Planifikimi i sasisë apo llojit të barërave dhe materialeve medicinale të nevojshme për trajtimin e pacientëve COVID-19 nuk bëhet bazuar në barërat që u ipen pacientëve. Barnatorja qendrore nuk kishte pasur një koordinim sistematik me barnatoret vartëse lidhur me sasinë e rezervave të barërave në dispozicion dhe projeksioneve kohore lidhur me mbulueshmërinë me ato barëra.

Tema 5: Optimizimi i resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19

Me qëllim të menaxhimit të situatës pandemike në vend, Qeveria e Kosovës ka themeluar Komitetin për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Emergjente me COVID-19 ku në bazë të rekomandimeve të tij janë aplikuar masa për parandalimin dhe trajtimin e pandemisë.

Qëllimi i auditimit ishte të vlerësohet procesi optimizimit të resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19.

Mesazhi i auditimit: *Optimizimi i resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19 është realizuar nga institucionet e shëndetit publik duke ju përgjigjur nevojave pjesërisht krahas numrit të pacientëve të infektuar dhe duke u përditësuar në vazhdimësi me udhëzimet e institucioneve ndërkombëtare shëndetësore.*

Raporti thekson se institucionet shëndetësore nuk kanë arritur që të sigurojnë personel të mjaftueshëm shëndetësor për t'u përballur me pandeminë COVID-19. Po ashtu, institucionet shëndetësore nuk kanë hartuar plane të veprimit për menaxhimin e hapësirave spitalore për trajtimin e pacientëve me COVID-19 me përjashtim të spitalit të Prizrenit nga spitalet rajonale të audituara, ndërsa SHSKUK-ja kishte hartuar një plan të veprimit në janar të vitit 2021. SHSKUK-ja nuk ka pasur një plan veprimi për menaxhimin e pajisjeve mjekësore të nevojshme për trajtimin e pacientëve me COVID-19.

Tema 6: Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Alplex dega në Kosovë – Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut –KOSTT

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut (KOSTT sh.a), operon si entitet i pavarur, aktiviteti kryesor është menaxhimi dhe operimi i sistemit të transmisionit dhe energjisë së Kosovës, si dhe është përgjegjëse për transmisionin e energjisë tek rrjetet elektrike të tensionit të lartë. Fokusi i auditimi ishte të vlerësojmë nëse vendimet lidhur me strukturën organizative të KOSTT janë sipas kriterëve të vendosura në legjislacion dhe nëse vendimet e APLEX-it dega në Kosovë kanë qenë në pajtim me aktet e saj. Ky auditim është kryer bazuar në kërkesën e Kuvendit të Kosovës..

Mesazhi auditimit: *KOSTT ka një strukturë organizative përmes së cilës përshkruan nivelet hierarkike, funksionet e njësisë organizative dhe aktivitetet e kompanisë. Megjithatë, ka disa mangësi gjatë vendimmarrjes lidhur me strukturën organizative dhe proceseve përcjellëse të saj.*

Në veçanti, mangësitë kanë të bëjnë me themelimin e pozitave të reja jashtë strukturës organizative, mungesën e një analize dhe arsyeshmërie të mirëfilltë lidhur me nevojën për ndryshime, si dhe me avancimin në pozita të ndryshme në KOSTT duke anashkaluar procedurat e parapara për mbulimin e këtyre pozitave. Lidhur me vendimet e ALPEX dega në Kosovë, vendimmarrja në përgjithësi ishte e bazuar në harmoni me marrëveshjen e aksionarëve të KOSTT.sh.a. dhe OST. sh.a. dhe në përputhje me Statutin e ALPEX.sh.a. Por, mungesa e një procedure formale për zgjedhjen dhe emërimet e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të ndryshëm ka ndikuar që në raste të caktuara përzgjedhja e kandidatëve për pozita menaxheriale të bëhet pa procese transparente dhe konkurruese.

Tema 7: Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)

Korporata Energjetike e Kosovës është shoqëri aksionare 100% në pronësi të Republikës së Kosovës. Aktiviteti kryesor i kompanisë është gjenerimi i energjisë elektrike si dhe aktivitetet minerare. Ajo është organizata me pjesëmarrjen më të madhe në prokurim publik në Kosovë. Gjatë viteve 2018-2020 përmes prokurimit

Korporata Energjetike e Kosovës ka lidhur 1,060 kontrata me vlerë të përgjithshme prej 181.5 milion euro.

Ne kemi audituar disa aktivitete të prokurimit që Korporata Energjetike e Kosovës kishte zhvilluar gjatë viteve 2018-2020 duke përfshirë aktivitetet që nga identifikimi i nevojave, zhvillimi i procedurave të prokurimit deri te menaxhimi i zbatimit të kontratës.

Mesazhi i auditimit - *Korporata Energjetike e Kosovës nuk kishte arritur që t'i përdorë fondet publike në mënyrë ekonomike dhe efikase, kishte mungesë të transparencës si dhe kufizim të konkurrencës. Kjo ka bërë që disa nga objektivat e përcaktuara përmes prokurimit publik të mos arrihen. Mungesa e analizave lidhur me përfitimet dhe kostot që rrjedhin nga aktivitetet e prokurimit/kontratave të zbatuara, ka bërë që Korporata Energjetike e Kosovës të vazhdojë me aktivitete të prokurimit që nuk i kishin kontribuar arritjes së objektivave.*

Aktivitetet e prokurimit janë realizuar kryesisht me negociim të çmimit e që nuk ka siguruar transparencë në prokurim. Kontratave të negociuara kishin rezultuar me çmime më të larta se sa kontratat paraprake apo pasuese të lidhura me tender të hapur. Gjithsej shpenzimi shtesë që kishte rezultuar nga prokurimet e negociuara ishte afër 739 mijë euro.

Njësitë kërkuese dhe zyra e prokurimit nuk kishin identifikuar si duhet nevojat për promovim të KEK-ut në media, dhe nuk kishin bërë analizë të tregut e që kishte rezultuar me objektiva të paqarta dhe të pamatshme të prokurimit. Për pasojë ishin lidhur, vit pas viti, kontrata efekti i të cilave ishte i panjohur në drejtim të realizimit të objektivave. Nga gjithsej 377,140 euro që ishin shpenzuar për promovim në media gjatë viteve 2018-2020, KEK-u kishte arritur vetëm 59,113 euro (15%) kthim përmes qendrës së trajnimeve profesionale.

Mos grumbullimi i nevojave për blerje të kushinetave kishte rezultuar numër të madh të aktiviteteve të prokurimit. Gjithsej 34 aktivitete të prokurimit ishin zhvilluar gjatë viteve 2018-2020 vetëm për këto blerje.

Menaxherët e projekteve/kontratave të prokurimit nuk kishin menaxhuar aktivisht kontratat me të cilat ishin ngarkuar, si mos përcjellja aktive e zbatimit të kontratës, mos azhurnimi i datave të dakorduara me kohë dhe mos aplikimi i gjobave për vonesa. Njësitë kërkuese kishin hasur në vështirësi në punë për shkak të vonesave në zbatim të kontratave.

Tema 8: Kontratave të centralizuara - Shërbimet e transportit ajror

Ky auditim ka mbuluar periudhën 2016-2019 dhe ka pas për qëllim që të vlerësojë nëse furnizimi me bileta për shërbimet e transportit ajror është kryer në përputhje me kontratat.

Për këtë qëllim janë audituar një numër i konsiderueshëm i furnizimeve me bileta në institucione si në Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, komunën e Gjilanit, Gjakovës, Vushtrrisë dhe të Suharekës.

Mesazhi i auditimit: *Disa nga organizatat buxhetore kishin bërë më shumë shpenzime se sa ishte parashikuar fillimisht për shkak të blerjes së numrit të madh të biletave të klasave më të larta se klasa ekonomike e udhëtimit e që ishin prej dy deri në gjashtë herë më të shtrenjta se biletat e klasës ekonomike.*

Rezultatet e këtij auditimit tregojnë se shpenzimet për udhëtime në klasa më të larta sesa klasa ekonomike përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve për shërbimet e transportit ajror.

Tre faktorët kryesor që kanë ndikuar në rritjen e vlerës së shpenzimeve për shërbimet të transportit ajror janë udhëtimet në biznes klasë, shtyrjet e udhëtimeve dhe anulimet e udhëtimeve. Shuma e rimbursimit për biletat e anuluar ishte mesatarisht rreth 59% e çmimit blerës. Kjo nënkupton se rreth 41% e vlerës së biletave të anuluar janë shpenzime për bileta që nuk janë shfrytëzuar, gjë që ka kontribuar në rritjen e shpenzimeve të përgjithshme të kontratave për shërbime të transportit ajror duke i quar në skadim të parakohshëm.

Tema 9: Menaxhimi i projektit “Bashkimi i qytetit të Ferizajt”

Është projekti më i madh i realizuar në 20 vitet e fundit në Ferizaj dhe lidhë dy anët e qytetit të ndara nga hekurudha duke bërë zgjidhje alternative sa i përket qarkullimit automobilistik dhe të këmbësorëve rreth hekurudhës. Pra ngërthen në vete nënkallimin për vetura dhe nënkallimin për këmbësorë. Projekti ka vlerën mbi 5.5 milion euro. Projekti “Bashkimi i qytetit të Ferizajt” është në përdorim nga qytetarët që nga korriku i vitit 2021.

Mesazhi i auditimit: *Komuna e Ferizajt nuk ishte efikase në planifikimin dhe menaxhimin e projektit “Bashkimi i qytetit” sepse kishte marrë më shumë kohë dhe kishte kushtuar më shumë se që ishte paraparë. Po ashtu Komuna nuk ka bërë matjen/dokumentimin e arritjes së objektivave të ndërtimit të projektit dhe nuk ka informacion si ka ndikuar investimi në përmirësimin e jetës së qytetarëve.*

Dobësitë në menaxhimin e projektit “Bashkimi i qytetit të Ferizajt” janë evidentuar në të gjitha fazat duke filluar nga: planifikimi, procedurat e prokurimit, menaxhimi dhe arritja e objektivave të projektit.

Komuna nuk e kishte përfshirë projektin në dokumentet strategjike duke e zbehur

kështu transparencën ndaj qytetarëve. Nuk ishin buxhetuar mjete të mjaftueshme për realizimin e projektit dhe si pasojë projekti nuk ka arritur të realizohet me kohë. Po ashtu, Komuna nuk kishte marrë të gjitha masat për të siguruar parakushte për ndërtim të papenguar të projektit. Përveç kësaj, kishte kontraktuar shërbime/punë me çmim shumë më të lartë se vlera e parashikuar e kontratave duke e kufizuar konkurrencën mes operatorëve ekonomik. Komuna i kishte paguar operatorit ekonomik punë të cilat ende nuk janë përfunduar dhe në anën tjetër operatori ekonomik ka përfunduar punë për të cilat ende nuk është paguar.

Për më tepër, Komuna nuk ka njohuri se a i ka arritur objektivat e projektit sepse nuk ka hartuar një metodë për të matur ndikimin që do të ketë projekti në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Tema 10: Projektet e financuara nga grantet e DEMOS

Në vitin 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ishin pajtuar për krijimin dhe financimin e një sistemi të grantit të performancës për komunat. Qëllimi i përgjithshëm i Grantit të Performancës Komunale është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Për vitin 2020 nga ky Grant kanë përfutur 23 komuna në vlerë 2,4 milion euro.

Mesazhi i auditimit: *Granti i Performancës Komunale në përgjithësi i ka ndihmuar komunat në arritjen e objektivave strategjike dhe është arritur qëllimi për të ofruar shërbime më të mira të infrastrukturës komunale për qytetarët. Komunat e audituara në përgjithësi kanë aplikuar rregullat dhe kanë ndjekur procedurat e prokurimit në fuqi ashtu siç parashihet edhe me kërkesat e Grantit.*

Megjithatë menaxhimi i projekteve dhe fondeve nga Granti ka nevojë për vëmendje më të madhe duke filluar nga vendosja e prioritetëve, realizimi i projekteve dhe rezultatet e arritura. Kemi vërejtur që procesi i prokurimit ende ka hapësirë për përmirësim në disa aspekte siç janë: përfshirja e projektit në planin e prokurimit publik, përlllogaritja e përafërt e vlerës së parashikuar të kontratës, evidentimi i pozicioneve të ndryshuara dhe trajtim i drejtë i Operatoreve Ekonomik në proceset tenderuese.

Gjysma e projekteve të audituara nuk ishin realizuar me kohë dhe nuk janë në shfrytëzim të plotë nga qytetarët. Vonesat në realizimin e projekteve ndërlidhen me mos shpronësimet me kohë të pronave private dhe pengesat për shkak të zhvillimit të dy projekteve në kohë dhe zonë të njëjtë.

Tema 11: Projektet Kapitale të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (2015-2021)

Sektori i energjisë në Kosovë, e në kuadër të tij sistemi i transmisionit të energjisë, ka rëndësi të veçantë prandaj janë kryer investime në vlerë të konsiderueshme, në përpjekje të arritjes së objektivave dhe synimeve afatgjata zhvillimore. Që nga viti 2008 KOSTT-i ka kryer investime kapitale me vlerë rreth 255 milion euro, prej të cilave 78,7 milion (mbi 31%) gjatë viteve 2015-2021 Nga këto 63,8 milion euro (81%) janë me financim të jashtëm, kurse 14,9 milion euro janë financuar nga buxheti vetanak.

Mesazhi i auditimit – *edhe pse vërehen avancime të dukshme të sistemit operues elektro-energjitik, KOSTT-i nuk kishte arritur disa nga objektivat e përcaktuara. Pra, krahas efekteve të mira në operim, këto aktivitete janë përcjellë me mungesë të efektivitetit, ekonomisë dhe efikasitetit. Me qëllim të përmirësimit të proceseve të prioritizimit të projekteve kapitale, të aktiviteteve të prokurimit, përfshirë edhe menaxhimin e kontratave, janë dhënë disa rekomandime për Bordin e Drejtorëve dhe Krye-shëfën Ekzekutiv të KOSTT-it.*

KOSTT-i ka vendosur procese për prioritizim të projekteve që janë në përputhje me praktikën ndërkombëtare por ka mangësi në zbatimin e prioriteteve. Kjo sepse disa projekte që ka vlerësuar se kanë prioritet të lartë, nuk janë zbatuar edhe pas pesë viteve që janë identifikuar, ndërsa ka realizuar projekte të cilat për nga prioriteti qëndrojnë më ulët. Për pasojë mund të ketë jostabilitet në furnizim me energji, në disa rajone të vendit, në kohën kur konsumi i energjisë është i lartë.

KOSTT-i nuk ka arritur të menaxhojë disa nga proceset e prokurimit në mënyrën e duhur për shkak se nuk kishte bërë hulumtim të mirë të tregut para përpilimit të specifikave teknike, ndarje jo të mirë të detyrave dhe menaxhim jo i mirë i kontratave publike, faktorë këta që kanë kontribuar në mosrealizim të objektivave të prokurimit.

Realizueshmëria e kontratave sipas raportimeve të KOSTT-it ka arritur që të reduktoj humbjet në energji dhe energjinë e padërguar te qytetarët, mirëpo mungesa e inspektimit të pajisjeve dhe stabilimenteve elektro-energjetike të nënstacioneve elektrike mund të rezultojë me defekte të paidentifikuara në këto pajisje e për pasojë investimi të jetë joefektiv dhe të mos arrihet qëllimi i furnizimit të mirë dhe i sigurt.

Auditimet e teknologjisë së informacionit

Tema 12: Sistemi Informativ i Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil

Qëllimi kryesor i regjistrimit civil është gjenerimi i dokumenteve ligjore të kërkuara me ligj që mbështet të drejtën e një individi për t'u njohur si person para ligjit dhe një marrëdhënie të tyre formale me shtetin. Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) është përgjegjëse për menaxhimin e proceseve në lidhje me aplikimin e personalizimit dhe

lëshimit të dokumenteve për shtetasit e Republikës së Kosovës, për shtetasit e huaj dhe për personat pa shtetësi, kur kanë banim të përkohshëm apo të përhershëm në territorin e Republikës së Kosovës. Auditimi ka vlerësuar administrimin dhe sigurinë e informacionit të sistemit informativ të gjendjes civile të Republikës së Kosovës, nëse është duke ruajtur sigurinë dhe privatësinë e të dhënave, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave. Në auditim janë përfshirë Agjencia e Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Komunitetet Prishtinë dhe Prizren.

Mesazhi i auditimit – Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për të vendosur mekanizma të përshtatshëm dhe funksional të qeverisjes së teknologjisë së informacionit. Sistemi për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit nuk garanton mjaftueshëm vazhdimësinë e sistemit dhe integritetin e të dhënave në çdo kohë si dhe kontrollet e aplikacionit që zbatohen në SGJC nuk sigurojnë që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në sistem.

ARC-ja nuk ka vendosur mekanizma të përshtatshëm dhe funksional të qeverisjes së teknologjisë së informacionit. Struktura dhe kontrollet në operacionet e TI-së nuk janë përcaktuar mirë duke ekspozuar organizatën ndaj rrezikut për arritjen e objektivave, sigurimin e vazhdimësisë së operimit të sistemeve informative dhe shfrytëzimin e pajisjeve elektronike. Sistemi për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit që zbatohet në ARC nuk garanton mjaftueshëm vazhdimësinë e sistemit dhe integritetin e të dhënave në çdo kohë. Gjithashtu, konsullatat në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Komunitetet e Prishtinës si përdorues të sistemit nuk garantojnë të kenë ruajtur si duhet integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në sistemin e informacionit. Kontrollet e aplikacionit që zbatohen në SGJC nuk sigurojnë që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në sistem. Si pasojë, ka qytetarë të cilët janë të regjistruar nga dy herë dhe janë të pajisur me dy numra personal si dhe qytetarë të ndryshëm të regjistruar me numër të njëjtë të librit. Gjithashtu, ka mungesë të ndërlidhjes së SGJC-së me bazën e të dhënave të Agjencisë Kadastrale për regjistrim të adresës.

Tema 13: Sistemi për Menaxhimin e Pagave-Payroll

Qeveria e Kosovës që nga viti 2004 ka vënë në funksion Sistemin për Menaxhimin e Pagave i cili nga viti 2015 menaxhohet nga Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Përmes këtij sistemi paguhen të gjithë të punësuarit në sektorin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë sistem administrohen mesatarisht tetëdhjetëetremijë (83,000) paga çdo muaj dhe menaxhohen rreth 30% të shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Thesari i Kosovës ka përgjegjësi të sigurojë efektivitetin e sistemit për menaxhimin e pagave dhe se përlllogaritja dhe ekzekutimi i pagave bëhet sipas legjisllacionit në fuqi. Në auditim është përfshirë Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Mesazhi i auditimit – Rezultatet e auditimit kanë venë në pah se procesi i ekzekutimit të pagave si dhe sistemi për menaxhimin e këtij procesi ka nevojë për përmirësim, me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe saktësisë së të dhënave. Mungon struktura e duhur organizative, nuk ka dokumentim të proceseve si dhe nuk ka kontrole të mjaftueshme për ndryshimet që bëhen në këtë sistem. Poashtu janë identifikuar mangësi në kontrollet e aplikacionit nga vendosja e të dhënave hyrëse, përpunimit të pagave si dhe në sigurinë e informacionit në këtë sistem.

Thesari i Kosovës nuk ka të vendosur strukturë organizative të përshtatshme për funksionimin e duhur të sistemit të pagave dhe procesi i punës nuk ishte i bazuar në objektiva strategjike duke rrezikuar mos përmbushjen e objektivit për menaxhimin e pagave për sektorin publik. Sistemi për menaxhimin e pagave nuk ka dokumentim të proceseve si dhe nuk ka kontrole të mjaftueshme për ndryshimet që bëhen në këtë sistem. Kjo rrit rrezikun që në sistem të ketë gabime, ndryshime të pa aprovuara ose aksidentale si dhe rrit varësin ndaj një individi duke rrezikuar që sistemi të mos vazhdoj të mbështes operacionet e Thesarit. Kontrollet e aplikacionit kishin mangësi që nga vendosja e të dhënave hyrëse, përpunimit të pagave si dhe në sigurinë e informacionit në këtë sistem. Kjo rrit rrezikun e gabimeve të mundshme gjatë procedimit të pagave, ndikon në efikasitetin e punës si dhe rrezikon integritetin e të dhënave.

Tema 14: Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve për Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës – SIMFK

Thesari i Kosovës menaxhon sistemin elektronik “Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK)”, i cili është sistem i centralizuar për të gjitha proceset e financave publike të Qeverisë së Kosovës dhe përdoret nga të gjitha organizatat buxhetore në të gjitha nivelet, si qendrore, ashtu edhe lokale. Ky sistem pasqyron një plan kontabël të detajuar për financat publike në Republikën e Kosovës, që mundëson kodifikimin dhe kontrollin e të gjitha transaksioneve financiare. Ky auditimi përcjellës ka për qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor të Auditimit 2020 lidhur me SIMFK-në. Në këtë auditim janë përfshirë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Thesari, si dhe Komuna e Obiliqit dhe Ministria e Punëve të Brendshme, përdorues të fundmë.

Mesazhi i auditimit - Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet përgjegjëse kanë bërë progres, por jo të mjaftueshëm në zbatimin e rekomandimeve. Nga trembëdhjetë rekomandimet e dhëna, gjashtë prej tyre janë zbatuar, një rekomandim është në proces të zbatimit, ndërsa gjashtë rekomandime të tjera janë ende të pazbatuara edhe pse janë ndërmarr veprime sipas planit kohor.

Thesari dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ende vazhdojnë të kenë mangësi në sigurimin e mekanizmave për sigurinë e informacionit. Ende nuk janë

harmonizuar pozitat e TI-së në raport me privilegjet dhe qasjet e tyre në sistemet e TI-së, gjithashtu nuk ka arritur të siguroj administrimin e bazave të të dhënave përmes obligimit kontraktual. Mungon zyrtari për sigurinë e informacionit dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjurmëve të auditimit. Nuk realizohet ende në baza të rregullta kohore testi i depërtueshmërisë për mbrojtje nga ndërhyrjet për sistemet e vendosura në rrjetin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Kontrollat e aplikacionit që zbatohen në SIMFK nuk janë të mjaftueshme për të siguruar që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen në sistem. Thesari ende nuk ka arritur të zbatojë rekomandimin për vlefshmërinë e fushave gjatë regjistrimit të të dhënave hyrëse. Në SIMFK nuk mundësohet zbatimi i Rregullores për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, që një shpenzim për përmirësimin e pasurisë kapitale të regjistrohet në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurisë kapitale. Thesari nuk ka arritur të bëjë një vlerësim të nevojave të përdoruesve dhe të sigurohet që ky sistem të ofroj raporte të plota dhe të mjaftueshme për përdorim efikas të tij.

Në 14 raportet e auditimit të performancës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 14 rekomandime për përmirësimin e aspekteve të ndryshme në administratën publike.

Rekomandim për Kuvendin e Kosovës që:

Përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike komisioneve relevante për fusha përkatëse, të shqyrtojnë raportet e auditimit të performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit dhe të mbajnë llogaridhënës krerët e institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Rekomandim për Qeverinë, dhe Komunitetin që:

T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës dhe teknologjisë së informacionit si dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt për veprimet përmirësuese.

15. Ndërmarrjet Publike

Përveç organizatave buxhetore, Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021 ka audituar edhe Pasqyrat Financiare Vjetore të 12 Ndërmarrjeve Publike (NP). Prej tyre, pesë (5) janë audituar për herë të parë nga ZKA, ndërsa shtatë (7) të tjera janë audituar edhe gjatë viteve paraprake. Kritere të përzgjedhjes për auditim të këtyre ndërmarrjeve ishin: madhësia e buxhetit/të hyrave, numri i punëtorëve, kompleksiteti i veprimtarisë së shërbimeve, gjendja jo e mirë financiare, interesi i publikut, etj. Prej tyre, të nivelit qendror janë pesë NP, të nivelit regional pesë NP dhe dy NP të nivelit lokal.

Auditimi i këtyre ndërmarrjeve publike ka nxjerrë në pah se sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ka nevojë për përmirësime thelbësore. Për të gjitha ndërmarrjet publike janë dhënë opinione të modifikuara. Opinione të modifikuara, të dhëna për pasqyrat financiare, reflektojnë cilësinë e dobët të informatave dhe mangësitë në fushën e raportimit. Ndërkaq, gjetjet në fushën e performancës operative dhe zbatimit të ligjshmërisë, janë tregues se ndryshimet dhe përmirësimet në menaxhim duhet t'u nënshtrohen reformave të thella. Proceset ekzistuese të përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore nuk ishin efektive. Kjo, për shkak se rezultatet e regjistrimit të pasurive ose ishin të mangëta, ose raportet e inventarizimit në kontabilitet ishin dorëzuar me vonësë, si dhe bartja e të dhënave tjera kontabël në Pasqyrat financiare ishte raportuar gabimisht dhe përmbanin mangësi informatash. Për shkak të kësaj, opinione të auditimit kanë rezultuar të modifikuara, dhe pasqyrat financiare si të tilla, ishin me gabime materiale dhe të përhapura në shumë fusha, dhe në asnjërën nga ndërmarrjet e audituara, nuk e paraqesin gjendjen e vërtetë dhe të drejtë të llogarive.

Në anën tjetër, trendi negativ financiar i shënuar viteve të fundit të këto ndërmarrje, shpërfaq nevojën e një analize gjithëpërfshirëse nga ana e menaxhmentit, por edhe të aksionarëve. Qeveria dhe komunat në të cilat operojnë këto ndërmarrje publike duhet të punojnë ngusht me drejtuesit përkatës në analizën e gjendjes dhe propozimin e masave për sanimin e gjendjes ekzistuese, para se vazhdimësia operative dhe ekzistenca e tyre të vëhet në pikëpyetje.

Vlen të theksohet se disa masa përmirësuese gjatë vitit 2021 veçse janë marrë nga ana e Qeverisë, duke emëruar borde drejtuese të ndërmarrjeve. Në disa prej tyre janë caktuar Bordet e reja me mandat të plotë veprimi, por kishte edhe emërime të përkohshme bordesh deri në zgjedhjen e bordeve të reja sipas procedurave ligjore. Gjithashtu, ka pasur edhe ndërrime dhe emërime të reja të menaxhmentit të lartë. Megjithatë, pritet që në të ardhmën e afërt të shihen rezultatet e këtyre ndryshimeve nëse do të sjellin përmirësimet e pritura.

Për të përmirësuar proceset ekzistuese të përgatitjes së pasqyrave financiare dhe praktikave aktuale të menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, ne kemi dhënë një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me qeverisje të NP-ve, si dhe tek aksionarët e tyre. Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, po ashtu monitoron veprimtarinë e tyre operative gjatë vitit, por edhe aspektin e raportimit financiar, dhe në baza të rregullta informon Qeverinë me situatën e tyre të përgjithshme.

Një analizë më e hollësishme mbi treguesit kyç të veprimtarisë së këtyre ndërmarrjeve, është paraqitur në kapitujt në vazhdim të këtij raporti, ndërsa cilësia e raportimit financiar pasqyrohet përmes opinioneve të dhëna si më poshtë.

15.1 Obligimet e ndërmarrjeve publike për raportimin vjetor financiar

Gjatë këtij sezoni auditues kemi evidentuar se 8 nga 12 ndërmarrjet publike të audituara, nuk i kanë përgatitur me kohë Pasqyrat vjetore financiare, respektivisht nuk i kanë pasur pasqyrat e aprovuara nga Bordet e tyre drejtuese brenda afatit ligjor 15 mars. Vonesat përtej afateve ligjore në dorëzimin e Pasqyrave financiare përfundimtare në ZKA ishin nga 6 deri në 43 ditë²³.

Përveç vonesave, në dy raste Pasqyrat financiare nuk janë të aprovuara nga Bordi, për shkak se deri në datën e raportimit, Bordet drejtuese të këtyre dy ndërmarrjeve ende nuk ishin të themeluara (NPH "Ibër - Lepenc" sh.a, dhe KRU "Prishtina"²⁴).

Shpjegimet e menaxhmentit lidhur me vonesat e mësipërme në dorëzimin e pasqyrave ishin se në raste të caktuara bordet ishin të pa kompletuara, takimet e bordeve mbahen rrallë (një herë në muaj) dhe në raste të caktuara neglizhojnë ta përmbushin këtë detyrim ligjor për arsye të ndryshme. Si pasojë e këtyre vonesave, edhe ZKA është dashtë t'i rishikojë planet e saj të punës, dhe asnjë auditim nuk ka mund ta kryej siç ishte planifikuar fillimisht. Këto vonesa ne i kemi raportuar në të gjitha raportet individuale dhe shpresojmë se viteve në vijim raportimi do të bëhet sipas kuadrit të përcaktuar ligjor.

23. Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë 6 ditë, Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a 27 ditë, Posta e Kosovës. sh.a 28 ditë, Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë 28 ditë, Ndërmarrja Publike "Termokos"- Prishtinë 35 ditë, KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë 35 ditë, Telekom i Kosovës, sh.a 37 ditë, KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë 43 ditë.

24. Bordet drejtuese të këtyre dy ndërmarrjeve janë themeluar ne ishim në auditim (qershor 2022).

15.2 Opinione e auditimit për Pasqyrat financiare për dy vitet e fundit

Në tabelën në vijim është dhënë një pasqyre e opinioneve të dhëna për PFV-të e vitit 2021 dhe 2020 të audituara nga ZKA-ja.

Tabela 32 - Opinione e dhëna për pasqyra financiare për Ndërmarrjet Publike

Nr	Subjektet e audituara	Opinioni i auditimit për 2021 dhe 2020	
		2021	2020
1	Posta e Kosovës. sh.a	I Kualifikuar	I Kundërt
2	Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë	I Kualifikuar	I Pamodifikuar
3	KRU "Hidromorava" sh.a - Gjilan	I Kundërt	I Kundërt
4	KRU "Hidroregjioni Jugor", sh.a - Prizren	I Kundërt	I Kualifikuar
5	Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a - Prishtinë	I Kundërt	I Pamodifikuar
6	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a	I Kundërt	I Kualifikuar
7	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	I Kundërt	I Kualifikuar
8	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	I Kundërt	Mohim i opinionit
9	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	I Kundërt	I Kundërt
10	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a	I Kundërt	I Kualifikuar
11	Telekomi i Kosovës, sh.a	I Kundërt	I Kundërt
12	KRM "Pastrimi", sh.a - Prishtinë	I Kundërt	I Kundërt

Nga tabela sipër shihet se në krahasim me vitin 2020, përmirësime në cilësinë e raportimit ka pasur vetëm te Posta e Kosovës. sh.a dhe KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë, ndërsa në të gjitha rastet tjera opinione e auditimit ishin të njëjta ose më të këqia se në vitin paraprak. Kjo është një tregues se në aspektin e cilësisë së raportimit, pasqyrat financiare nuk e paraqesin gjendjen e drejt të llogarive dhe të performancës operative. Çështja tjetër që ka ndikuar në këtë trend negativ të opinioneve është edhe fakti se në disa prej këtyre ndërmarrjeve auditimin e kanë kryer firmat private, të cilat kanë aplikuar metodologji dhe qasje të ndryshme të auditimit nga ajo që aplikon Zyra Kombëtare e Auditimit. Kjo ka ndodhur si psh. NPH "Ibër - Lepenc"; Termokos; dhe NPB.

Përveç auditimit financiar që për objektiv ka përgjigjen në pyetjen nëse Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë, ne kemi audituar

edhe aspektin e pajtueshmërisë nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit. Se sa ndërmarrjet publike kanë qenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret, në secilin raport individual kemi shpreh Konkluzionin e auditimit që ndryshe trajtohet si opinion i pajtueshmërisë.

Pasqyra në vijim paraqet konkluzionin/opinionin e pajtueshmërisë për dy vitet e fundit.

Tabela 33 - Konkluzionet e dhëna të pajtueshmërisë për Ndërmarrjet Publike

Nr	Subjektet e audituara	Konkluzioni i pajtueshmërisë	
		2021	2020
1	KRU "Hidroregjioni Jugor", sh.a - Prizren	I Pamodifikuar	I Kualifikuar
2	KRU "Hidromorava" sh.a - Gjilan	I Pamodifikuar	I Pamodifikuar
3	Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë	I Kualifikuar	Nuk aplikohet
4	Posta e Kosovës. sh.a	I Kualifikuar	I Pamodifikuar
5	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a	I Kualifikuar	Nuk aplikohet
6	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	I Kualifikuar	Nuk aplikohet
7	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	I Kualifikuar	Nuk aplikohet
8	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a	I Kualifikuar	I Kualifikuar
9	Telekomi i Kosovës, sh.a	I Kundërt	I Kundërt
10	KRM "Pastrimi", sh.a - Prishtinë	I Kundërt	I Kundërt
11	Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a - Prishtinë	I Kundërt	Nuk aplikohet
12	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	I Kundërt	I Kundërt

Nga krahasimi i të dhënave në tabelën sipër, shihet se vetëm KRU "Hidroregjioni Jugor" - Prizren ka bërë një progres pozitiv në përmirësimin e parregullsive ligjore, duke marrë Konkluzion të Pamodifikuar. KRU "Hidromorava" - Gjilan ka ruajtur të njëjtën gjendje, duke marrë Konkluzion të Pamodifikuar dy vite radhazi, ndërsa të gjitha tjerat kanë konkluzion të Kualifikuar ose të Kundërt.

Shprehja “nuk aplikohet” do të thotë se gjatë vitit 2020 këto organizata janë audituar nga firmat private dhe ato nuk kanë dhënë opinione të pajtueshmërisë, por vetëm opinion për pasqyra financiare.

Referuar opinioneve të pajtueshmërisë, konkluzioni i auditimit është se shumica e ndërmarrjeve publike kanë pasur parregullsi të shumta ligjore gjatë vitit 2021, në veçanti katër prej tyre të renditura në pjesën e poshtme të tabelës. Gjendja pothuajse e njëjtë ishte edhe gjatë vitit 2020.

Rekomandime për Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të NP-ve:

- Bordet drejtuese dhe menaxhmenti, duhet që me saktësi t’i përmbahen nenit 31.3 të Ligjit nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet publike i cili përcakton se: “30 ditë pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve duhet ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e shih të arsyeshme ta miratojë raportin vjetor”. Kjo nënkupton se raportet vjetore, përfshirë edhe atë financiar, duhet që nga ana e Bordeve të miratohen deri më 15 mars, dhe të njëjten ditë pasqyrat financiare duhet të jenë të gatshme për auditim nga auditori i jashtëm;
- Bordet drejtuese, me rastin e shqyrtimit të Pasqyrave financiare, të rishikojnë në detaje përmbajtjen e informatave në pasqyrat financiare, dhe të sigurohen se ato janë pa gabime, janë të mbështetura me evidencat kontabël dhe se i përmbushin të gjitha kërkesat e kornizës së raportimit financiar; dhe
- Komisionet përkatëse të aksionarëve duhet t’i forcojnë masat e llogaridhënies ndaj Bordeve Drejtuese dhe manaxhmentit se përse Pasqyrat financiare nuk përgatiten dhe aprovohen me kohë, dhe përse raportimi financiar nuk ishte në pajtim me standardet përkatëse. Komisionet e aksionarëve, po ashtu, duhet që pa vonesë t’i plotësojnë vendet pozitat e antarëve të përkohshëm të Bordeve drejtuese dhe menaxherëve të lartë në mënyrë që të evitohen të gjitha boshllëqet në strukturat drejtuese të ndërmarrjeve.

15.3 Rekomandimet e vitit paraprak dhe niveli i zbatimit

Në tabelen më poshtë janë paraqitur numri i rekomandimeve të dhëna dhe niveli I zbatimit të tyre për vitin 2020 për Ndërmarrjet publike.

Tabela 34 - Zbatimi i rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2020

Nr	Subjektet e audituara	Totali i rekomandimeve (a)	Të zbatuara (b)	Pjesërisht të zbatuara (c)	Të pazbatuara (d)	Të mbyllura (e)
1	KRU "Hidroregjioni Jugor", sh.a - Prizren	3	3	-	-	0
2	Ndërmarrja Publike "Termokos", sh.a - Prishtinë	7	3	-	4	0
3	Posta e Kosovës, sh.a	8	4	1	2	1
4	Ndërmarrja Publike Banesore, sh.a - Prishtinë	4	3	-	-	1
5	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a	12	5	-	-	7
6	KRU "Hidromorava" sh.a - Gjilan	17	13	-	4	0
7	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	7	6	-	1	0
8	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	17	12	1	4	0
9	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	28	5	-	16	7
10	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a	9	5	-	2	2
11	Telekomi i Kosovës, sh.a	17	4	3	9	1
12	KRM "Pastrimi", sh. a - Prishtinë	23	7	1	15	0
Gjithsej rekomandime		152	70	6	57	19
Totali i rekomandimeve për zbatim (a-e)		133	53%	4%	43%	

Nga tabela më lart shihet se 19 rekomandime janë të mbyllura (prej tyre 12 rekomandime të dhëna e 2020 për Telekomin e Kosovës sa i përket auditimit të sistemit informative nuk janë testuar gjatë vitit 2021 përshkak se kompanisë I është dhënë kohë më e gjatë për adresimin e tyre dhe testimi I tyre do të bëhet në auditimet në vitet vijuese, pjesa tjetër e rekomandimeve të mbylluar për shkak të fuzionimit të çështjeve/rekomandimeve). Nga rekomandimet e mbetura për zbatim 70 prej tyre ishin të zbatuarar, 6 pjesërisht dhe 57 prej tyre nuk janë zbatuar fare.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, me të gjithë drejtuesit e ndërmarrjeve publike janë zhvilluar diskutime të shumta se si të bëhet më i lehtë zbatimi i këtyre rekomandimeve, dhe nga të gjithë është vërejtur një përkushtim i shtuar për adresimin sa më efektiv të çështjeve të dala nga auditimi. Në veçanti janë diskutuar Planet e veprimit se si të përgatiten në mënyrë sa më cilësore.

Sipas një analize të kryer për vitet 2018 dhe 2019, ka rezultuar se numri i rekomandimeve të zbatuara në vitin 2019 ishte dukshëm më i madh se në vitin 2018. Shkalla e zbatimit ishte rritur nga 42% në vitin 2018 në 54% në vitin 2019. Kjo është një tregues se Ndërmarrjet publike po e kuptojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë e auditimit dhe kanë rritur përkushtimin në trajtimin e rekomandimeve.

Tabela 35 : Gjendja e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2021

Nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Gjithsej rekomandime të dhëna	Rekomandimet e reja	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura
1	KRU "Hidroregjioni Jugor", sh.a - Pz	8	8	-	-
2	Ndërmarrja Publike Banesore, sh.a	13	13	-	-
3	Hekurudhat e Kosovës "Infrakos", sh.a	15	15	-	-
4	KRU "Hidromorava", sh.a - Gjilan	12	8	4	-
5	Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" sh.a	10	8	2	-

6	KRU "Prishtina", sh.a - Prishtinë	19	3	16	-
7	Ngrohtorja e Qytetit "Termokos", sh.a	31	27	4	-
8	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	12	11	1	-
9	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	26	21	4	1
10	KRM "Pastrimi", sh. a - Prishtinë	23	7	15	1
11	Posta e Kosovës, sh.a	9	6	2	1
12	Telekomi i Kosovës, sh.a	29	17	9	3
	Gjithsej rekomandime të dhëna	207	144	57	6

Numri i rekomandimeve të dhëna për vitin 2021 është rritur dukshëm në krahasim me vitin 2020, nga 152 në 207 apo për 36%. Kjo kryesisht ka ndodhur për shkak se disa nga ndërmarrjet vitin e kaluar janë audituar nga firmat private, të cilat nuk kanë bërë edhe auditim të pajtueshmërisë. Shumica e rekomandimeve janë dhënë për Pasqyra financiare dhe më pak për aspektin e pajtueshmërisë, që do të thotë se raportimi ka nevojë për përmirësime thelbësore.

Analiza e gjendjes financiare të ndërmarrjeve publike

Ndonëse gjendja financiare e ndërmarrjeve publike më hollësisht mund të kuptohet nga pasqyrat e bashkëngjitura në raportet individuale, në këtë kapitull në mënyrë përmbledhëse janë paraqitur treguesit kryesor të performancës financiare dhe gjendjes së tyre të fundvitit 2021. Për qëllime analize, janë marrë në shqyrtim të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatgjata e afatshkurtëra dhe historiku i fitimit dhe humbjeve të bartuara nga vitet e kaluara.

Tabela 36 - Treguesit kryesor financiar të ndërmarrjeve publike të audituara për vitin 2021

Nr	Subjektet e audituara	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi/ Humbja	Detyrimet afatshkurt.	Detyrimet afatgjata	Fitimi/ humbja e akumuluar
1	KRU "Hidroregjioni Jugor" - Prizren	5,568,559	5,375,381	193,178	2,728,862	21,322,924	(4,568,108)
2	NP "Termokos", sh.a - Prishtinë	9,588,862	7,716,147	1,872,715	2,408,730	32,144,207	4,949,311
3	Posta e Kosovës, sh.a - Prishtinë	10,516,609	12,446,099	(1,929,490)	2,995,995	0	(22,537,762)
4	Ndër. Publike Banesore - Prishtinë	5,039,518	4,026,446	1,013,073	241,771	910,887	4,797,605
5	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos	3,157,012	3,316,143	(159,131)	21,217,679	15,200,294	(3,408,913)
6	KRU "Hidromorava" sh.a - Gjiilan	2,243,597	2,283,690	(40,093)	323,260	5,005,652	(602,207)
7	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	6,372,090	9,333,803	(2,961,713)	2,407,116	3,612,712	(56,340,835)
8	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	2,175,042	2,109,923	65,119	2,513,310	0	(40,656)
9	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	16,572,658	17,724,684	(1,152,026)	5,923,473	37,823,034	(11,833,288)
10	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos	4,031,508	4,288,796	(257,288)	1,473,095	695,019	(2,232,262)
11	Telekomi i Kosovës, sh.a	58,903,000	69,732,000	(10,829,000)	70,353,000	7,673,000	(76,264,000)
12	KRM "Pastrimi", sh. a - Prishtinë	8,225,174	7,953,020	272,154	1,250,380	0	7,079,524

Rezultati financiar (fitimi/humbja) - Nga tabela më sipër shihet se nga 12 organizata të analizuar, shtatë (7) prej tyre kanë operuar me një total të humbjeve prej 17.3 milionë, ndërsa pesë (5) tjerat kanë treguar një fitim prej 3.3 milionë.

Pjesën më të madhe të humbjeve e kishte Telekomi i Kosovës në shumën prej 10.8 milionë euro apo 62% të totalit të humbjeve, kurse fitimin më të madh e kishte realizuar Termokos në shumën prej 1,9 milionë euro apo rreth 49% nga totali i fitimit.

Humbjet e akumuluar - paraqesin humbjet konsistente të ndërmarrjes të grumbulluara gjatë viteve paraprake. Nga të dhënat në kolonën e fundit të tabelës shihet se humbjet e akumuluar të këtyre 12 NP-ve kanë arritur shumën 177.8 milionë euro, dhe pjesën më të madhe sërish e ka Telekomu me 76.3 milionë apo rreth 43%, NPH “Ibër - Lepenc” me 56.3 milionë apo 32%, Posta e Kosovës me 22.5 milionë apo 12%, kurse gjithë të tjerët me 22.7 milionë apo 13%. Për dallim prej tyre, fitime të bartura kanë pasur NP “Termokos”; Ndërmarrja Publike Banësore; dhe KRM “Pastrimi”.

Humbjet e akumuluar mund të ndikojnë negativisht në zvogëlimin e ekuitetit. Këto gjithashtu ndikojnë në zvogëlimin e dividendave, reduktojnë aftësinë e ndërmarrjes për pagesën e borxheve dhe aftësinë për investime të reja dhe zgjerim të bazës materiale. Kjo është tregues se ndërmarrja është financiarisht jostabile për shkak se ka deficit të fondeve dhe nuk është në gjendje të gjenerojë para për financimin e rregullt të veprimtarisë. Kjo shkakton vështirësi edhe në marrjen e kredive për shkak se kreditorët ose bankat nuk janë të sigurta në kthimin e kredive.

Detyrimet afatshkurtëra - janë obligime financiare që duhet të paguhen brenda një viti dhe klasifikohen si detyrime qarkulluese. Detyrimet afatshkurtëra janë: llogaritë e pagueshme, shpenzimet akruale, tatimet e pagueshme, borxhet afatshkurtëra, kreditë afatshkurtëra, depozitat e klientëve dhe detyrimet tjera me afat pagese brenda një viti.

Detyrimet afatshkurtëra për 12 ndërmarrjet e audituara kapin shumën prej 114 milionë euro, që si të tilla duhet të paguhen brenda vitit 2022. Shumicën e këtyre detyrimeve (84%) e përbëjnë tri ndërmarrje: Telekomu me 70.3 milionë apo 61%; Infrakos me 21.2 milionë ose 18%, dhe KRU Prishtina me 5.9 milionë apo 5%. Ndërsa pjesën e mbetur prej 18.1 milionë apo 16% e përbëjnë detyrimet afatshkurtëra të nëntë (9) NP tjera. Likuidimi i këtyre detyrimeve, veçanërisht nga Telekomu dhe HK Infrakos pothuajse është i pa mundur, për shkak se të hyrat e tyre vjetore janë dukshëm më të vogla se totali i detyrimeve, por në pozitë aspak më të mirë nuk është as KRU Prishtina.

Sipas shifrave të prezantuara në tabelë, përveç Ndërmarrjes Publike Banësore dhe KRU “Hidromorava” sh.a - Gjilan, të cilat duket se kanë një likuiditet më të lartë, të gjitha kompanitë tjera do të kenë sfida jashtëzakonisht serioze në likuidimin e detyrimeve afatshkurtëra.

Detyrimet afatgjata - janë obligime financiare ose detyrime joqarkulluese të cilat listohen në bilancin e gjendjes si obligime që afatin e pagesës e kanë më të gjatë se një vit. Këtu bëjnë pjesë kreditë për mjete themelore, detyrimet ndaj letrave me vlerë, detyrimet ndaj pengjeve apo hipotekave dhe detyrimet tjera që duhet të paguhen në afat më të gjatë se një vit.

Detyrimet afatgjata për 12 NP-të në fundvitin 2021 ishin afër 124 milionë euro, apo rreth 9% më të larta se detyrimet afatshkurtëra. Meqenëse pasqyra e shpalosjeve përmban shumë mangësi të informatave, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë të dhëna analitike se, brenda sa vitesh duhet të kthehen këto detyrime, sa është shumica e tyre që duhet të kthehet gjatë vitit 2022 dhe informata të tjera për kohën e amortizimit të tyre.

Konkluzionet

Në bazë të rezultateve nga auditimet individuale, del se problemet të ndërmarrjet publike janë të shumta dhe gjendja e tyre financiare është jashtëzakonisht e vështirë. Çështjet kryesore për vëmendje dhe që kërkojnë trajtim të veçantë janë:

- **Mos respektimi i afateve ligjore për raportim financiar** - Vonesat në përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të pasqyrave financiare nga ana e menaxhmentit dhe aprovimi i tyre nga Bordet drejtuese, ku shumica prej këtyre ndërmarrjeve kanë pasur vonesa të konsiderueshme në përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Kjo ka ndikuar edhe në rishikimin e planeve për auditim;
- **Cilësia e dobët e Pasqyrave Financiare** - Pasqyrat financiare ishin të pa sakta dhe me një cilësi të dobët të informatave. Kjo reflektohet me opinionet e dhëna të auditimit, ku të gjithat kanë opinionet e kualifikuara apo kundërta, dhe asnjëra nga to nuk ka opinion të pastër. Pak më mirë ekziston gjendja me konkluzionet e pajtueshmërisë, ku dy prej tyre (Hidroregjioni - Prizren dhe Hidromorava - Gjilan) kanë konkluzione të pamodifikuara, kurse të tjerat konkluzione të kualifikuara apo të kundërt. Kjo karakterizohet edhe me numrin e rritur të gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna, sidomos gjatë vitit 2021. Opinionet e modifikuara të auditimit ulin në shkallë kritike besueshmërinë e kreditorëve, bankave dhe investitorëve në raportet financiare të ndërmarrjeve, dhe mundësitë për marrjen e kredive dhe investimeve të reja, janë mjaft të pasigurta;
- **Niveli i pamjaftueshëm i zbatimit të rekomandimeve në vitet paraprake** - Për vitin 2020 ishin zbatuar vetëm 53% të rekomandimeve, 6% ishin adresuar pjesërisht, ndërkaq të pazbatuara ishte 43%. Gjatë vitit 2021 numri i rekomandimeve të dhëna në krahasim me vitin 2020, është rritur nga 152 në 207 apo rreth 36%;
- **Rezultatet e pavolitshme financiare** - Shtatë (7) ndërmarrje publike kanë pasur rezultat negativ financiar, respektivisht humbje në shumën prej 17.3 milionë euro, kurse pesë (5) kanë arritur rezultat pozitiv financiar me një fitim prej 3.3 milionë. Fitimet e raportuara më shumë janë rezultat i përshtatjes

së pasqyrave në fund të vitit, sesa i ndonjë afarizmi të qëndrueshëm financiar. Humbjet e akumuluar gjatë viteve paraqesin shifër alarmante prej rreth 178 milionë euro, dhe kjo më së miri përshkruan trendet e afarizmit në këtë sektor gjatë disa viteve të fundit.

- **Shumat e larta të detyrimeve të pa paguara** - Detyrimet totale të pa paguara të këtyre ndërmarrjeve kapin shumën prej mbi 238 milionë euro, prej të cilave detyrime afatshkurtëra që duhet të paguhen brenda një viti janë rreth 114 milionë euro. Marrë parasysh faktin se të hyrat totale ishin rreth 132 milionë euro, pagesa eventuale e këtyre detyrimeve afatshkurtëra duket mjaft e vështirë, madje edhe e pamundshme. Kur kësaj i shtohen edhe kështet e kredive afatgjata dhe detyrimet tjera që krijohen gjatë vitit 2022, gjendja bëhet edhe më e komplikuar.
- **Struktura e pavolitshme e llogarive të arkëtueshme** - Totali i llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2021 ishte rreth 50 milionë euro, dhe nën kushtin se edhe të inkasoheshin në tërësi, këto do të mbulonin pagesën e detyrimeve afatshkurtëra vetëm deri në 44%. Por, struktura e këtyre llogarive është mjaft e paqëndrueshme, për shkak se shumica prej tyre janë llogari të grumbulluara qysh nga koha e pasluftës e deri më sot, dhe gjasat për arkëtimin e tyre janë minimale, dhe se pjesa dërmuese e tyre janë kërkesa të parashkuara. Marrë parasysh faktin se Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit, shërbimit të pastërtisë, radios dhe televizionit, kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit, shërbimet e ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak-amvisëri janë kërkesa që parashkruhen pas një viti, del se pjesa dërmuese e llogarive të arkëtueshme janë të dyshimta dhe nëse kompanitë nuk marrin veprime të shpejta për t'i inkasuar të paktën faturat e vitit 2021 brenda një viti, ato do të parashkruhen dhe nuk do të inkasohen kurrë.
- **Mos regjistrimi, inventarizimi me kohë dhe rivlerësimi i pasurive** - Shumica e ndërmarrjeve kanë probleme të shumta me pasuritë. Disa nga to nuk i kanë të përfshira në regjistrat kontabël pasuritë që i kanë në zotërim, disa i kryejnë inventarizimet e fundvitit të pasurive, por raportet e inventarizimit nuk i barazojnë me librat kontabël dhe nuk bëhen korrigjimet e fundvitit të cilat duhet të reflektohen edhe në pasqyra financiare.

Por, ajo që është si problem i përbashkët i të gjitha ndërmarrjeve, është problemi i rivlerësimit të pasurive, që sipas kërkesave të standardeve duhet të kryhet të paktën në çdo pesë vjet. Pasuritë e raportuara në Pasqyra Financiare kanë mbi dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet që nuk janë rivlerësuar, dhe vlera e tyre kontabël me vlerën e tregut ka diferenca të mëdha, ashtu që përlllogaritja e zhvlerësimit nuk është as përafërsisht e saktë, e as vlera e tyre neto e mbajtur në librat kontabël. Kjo ka efekte të dyfishta edhe në paraqitjen e gjendjes së pasurive në Bilancin e gjendjes, por edhe në Pasqyrën e të ardhurave sa

i përket shpenzimeve të zhvlerësimit, që për efekt përfundimtar kanë paraqitjen e pa saktë të fitimit apo humbjes së kompanisë. Shpjegimet e menaxhmentit të lartë të këtyre ndërmarrjet ish-in se për shkak të mungesës së fondeve, nuk kanë qenë në gjendje ta bëjnë rivlerësimin e pasurive, pasi ky proces ka kosto goxha të lartë të cilin këto kompani nuk mund ta përballojnë me fondet e veta.

- **Likuiditeti i ultë i pagesave** - Vetëm totali i detyrimeve afatshkurtëra kap shumë prej 114 milionë euro, duke mos i llogaritur edhe 124 milionë të tjera që duhen paguar në periudha më të gjata kohore se një vit. Duke pasur parasysh faktin se gjithsej të hyrat vjetore të të gjitha ndërmarrjeve janë rreth 132 milionë, i bie se më shumë se 86% e të hyrave që mund të realizohen gjatë vitit, duhet të shpenzohen për likuidimin e këtyre detyrimeve. Kjo padyshim është një ngarkesë e madhe për ndërmarrjet pasi që qysh me fillim të vitit afarist, duhet të procedojnë me pagesat e këtyre detyrimeve, ndërkohë që kanë deficite të larta buxhetore dhe fluks të dobët të rrjedhës së parasë.

Rekomandimet për Qeverinë, Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve

- Të ngriten masat e përgjegjësive të menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, me fokus të veçantë rekomandimeve me prioritet të lartë;
- Të analizohet performanca financiare dhe shkaqet që kanë shkaktuar humbjet e deritanishme, dhe varësisht nga faktorët e identifikuar, të propozohen politikat dhe masat përmirësuese;
- Të analizohet struktura e detyrimeve të pa paguara, duke vendosur prioritetet e pagesave varësisht nga vjetërsia e detyrimeve, rëndësia e furnitorëve strategjik për kompaninë si dhe nevoja për të hyrë në detyrime të reja. Qeveria dhe aksionarët tjerë (komunat) ka nevojë të intervenojnë me subvencione shtesë për t'i shpëtuar këto ndërmarrje nga falimentimi, pasi të njëjtat ofrojnë shërbime publike vitale për qytetarët;
- Të analizohet në hollësi struktura e llogarive të arkëtueshme, vjetërsia e llogarive, veprimet e marra për inkasim, aftësia e klientëve për të paguar, si dhe të bëhet pastrimi i llogarive të dyshimta që mbahen në evidenca prej shumë vitesh, dhe nuk kanë gjasa të inkasohen. Gjithsesi përparësi duhet të ketë inkasimi i faturimeve brenda 12 muajve të fundit, sepse po që se procedurat përmbarimore nuk janë filluar më heret, gjatat për inkasimin e borxheve më të vjetra se një vit, janë minimale dhe si të tilla kanë rrezik të jenë parashkruar dhe të mos inkasohen kurrë; dhe
- Të ndërmerren masa që procesi i rivlerësimit të kryhet brenda një afati optimal. Duke qenë se arsyeja kryesore për mos kryerje të vlerësimit ishte mungesa e fondeve, Qeveria dhe komunat duhet ta mbështesin financiarisht këtë proces.

16. Zbatimi i Rekomandimeve

Rëndësia e raporteve të auditimit qëndron në identifikimin e dobësive në sistemet e qeverisjes, veçanërisht të sistemeve financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si një mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave. Analizat në këtë fushë kanë rezultuar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm.

Pas pranimit të RVA-së për vitin 2020, Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Në nivel të auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Krahasuar me vitin 2020, numri rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të organizatave buxhetore është rritur, megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet përafërsisht i njëjtë, ku numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është në nivel prej 50%, pjesa tjetër e rekomandimeve janë në proces të zbatimit ose nuk janë zbatuar ende, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Përveç kësaj, një numër i rekomandimeve janë trajtuar si rekomandime të cilat nuk janë të aplikueshme më, për faktin e ndryshimeve të bazës ligjore, ndryshimeve strukturore të disa ministrive si dhe konsolidimit/fuzionimit të rekomandimeve të ngjashme.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit. Shkaqet dhe arsyet që kanë ndikuar për një progres të dobët, janë të ndryshme, të cilat do të shpjegohen më poshtë.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsitë. ZKA-ja, përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak dhe vitet e mëhershme, duke i pasqyruar qartë fushat në të cilat janë marrë masa dhe veprime përmirësuese, si dhe fushat ku nevojiten veprime shtesë për përmirësime të mëtutjeshme.

Në Raportin Vjetor të Auditimit për RVF-BRK 2021 janë dhënë gjithsej 37 rekomandime, prej tyre 5 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 24 për Qeverinë dhe 8 për Qeverinë/Bordet drejtuese /Komisionet e Aksionarëve.

Shtojca I e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA, ndërsa Tabela 37 dhe 38 paraqesin statistikat e rekomandimeve për organizatat individuale.

16.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA-në për 2020

Në RVA-në për vitin 2020, Auditori i Përgjithshëm i kishte rekomanduar Kuvendin që të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA të vitit 2020, si dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza gjashtë mujore.

Qeveria e Kosovës në shtator 2021 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. I njëjti është dërguar edhe në Kuvendin e Kosovës/KMFP për shqyrtimin e progresit të rekomandimeve

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve tjera, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një nivel të kënaqshëm të zbatimit të rekomandimeve.

Nga gjithsej 54 rekomandime të dhëna në RVA-në 2020, 12 janë zbatuar plotësisht, 10 ishin në proces të zbatimit dhe 32 të tjera nuk ishin adresuar ende. Shtojca I paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2020.

Moszbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten veçanërisht në fushat, si:

- Mangësitë në përgatitjen e PVF-ve;
- Dobësi në procedurat e prokurimit;
- Mangësi në menaxhimin e pasurisë;
- Mangësi në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, obligimeve; detyrimeve kontigjente;
- Dobësi në procedurat e subvencioneve; dhe
- Funksionimi jo i mirë i Komiteteve të auditimit dhe NJAB-ve;

16.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2020

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të përhershëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt dhe rezultatet për vitin paraprak, paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të vitit 2020 dhe 2019, të cilat janë të kategorizuara sipas organizatave të audituara.

Organizatat e audituara janë ndarë në: Institucione të nivelit qendror²⁵, Institucione të pavarura²⁶ dhe Institucione të nivelit lokal (38 Komuna).

Në vijim është paraqitur tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjet e zbatimit të tyre.

Tabela 37 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2020²⁷

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve në 2020	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më ²⁸	Rekomandimet për zbatim	Të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara	
				Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	237	28	209	123	59%	14	7%	72	34%
Institucionet e pavarura	46	2	44	31	71%	1	2%	12	27%
Institucionet e nivelit lokal	371	8	363	152	42%	15	4%	196	54%
Gjithsej rekomandime	654	38	616	306	50%	30	5%	280	45%

25. Kuvendi I Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, 15 Ministri, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, fondi i Mirëbesimit dhe ShSKUK.

26. Në institucionet e pavarura janë përfshirë Universiteti i Prishtinës dhe 28 institucione.

27. Nga numri total i rekomandimeve janë eliminuar rekomandimet që nuk aplikohen më dhe mbi këtë bazë është kalkuluar % e zbatimit të tyre.

28. Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më - rrjedhin si rezultat i fuzionimit të Ministrive, ndryshimeve të akteve ligjore apo fuzionimit të dy rekomandimeve në një rekomandim.

Tabela 38 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2019

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve	Të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara		Nuk është i aplikueshëm më	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	266	138	52%	10	4%	71	27%	47	18%
Institucionet e pavarura	54	30	56%	0	0%	16	30%	8	13%
Institucionet e nivelit lokal	483	197	41%	43	9%	183	38%	60	12%
Gjithsej rekomandime	803	365	45%	53	7%	271	34%	114	14%

Siç shihet edhe nga tabelat më lart, numri total i rekomandimeve të dhëna për vitet 2019/2020, është në rënie, megjithatë niveli i rekomandimeve të pazbatuara apo që nuk ka filluar zbatimin, ende është jo i kënaqshëm.

Nga tabela nr.37 vërehet se 50% e rekomandimeve janë zbatuar, krahasuar me vitin 2019 kemi një rritje prej 5%. Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve është rezultat i masave të ndërmarra në nivelin qendror përfshirë institucionet e pavarura, përderisa niveli i zbatimit të rekomandimeve tek niveli lokal nuk ka progres të theksuar.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore përgatisin plane të veprimit për zbatim të rekomandimeve, megjithatë nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të.

16.3 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e performancës

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është përmirësimi i procesit të zbatimit dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet i adresohen subjekteve të audituara në mënyrë që të përmirësojnë qasjen e tyre në raport me shpenzimin e fondeve publike.

Përmes auditimeve të performancës, ZKA-ja i ka ofruar Kuvendit dhe subjekteve të audituara rekomandime të dobishme që të përmirësojnë dhe rrisin ekonomikitetin,

efikasitetin dhe efektivitetin në sektorë të rëndësishëm si: sistemi gjyqësor, shëndetësia, mjedisi, sistemet e teknologjisë informative, prokurimi publik. Rekomandimet e auditimit të performances kanë përfshirë si nivelin e qeverisjes qendrore ashtu edhe atë lokale.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet individuale të auditimit të performancës bëhet përmes auditimeve të veçanta, të cilat njihen edhe si “faza e përcjelljes”. Pas këtij procesi nxjerrën edhe rezultatet e zbatimit të rekomandimeve.

Në RVA-në për vitin 2020 janë dhënë dy rekomandime, të cilat janë zbatuar pjesërisht. Në shtojcën I të këtij raporti, është paraqitur gjendja e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Arsyet për zbatimin e ultë të rekomandimeve

Mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesorë për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin financiar, duke bërë që rekomandimet të përsëriten.

Për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve, nevojiten masa shtesë nga ana e Qeverisë ndaj OB-ve dhe forcimi i masave të llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës.

Rekomandim për Kuvendin e Kosovës

Të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP-ja. Këto plane duhet të përcaktojnë saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që së paku dy herë në vit KMFP-ja ka shqyrtuar progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave që forcojnë llogaridhënien dhe parandalojnë ngeçjet në zbatimin e rekomandimeve.

Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2020

Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA-në 2020	Progresi në zbatimin e rekomandimeve		
		Përshkruani çfarë masa janë ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve		
		Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	T'i forcojë kontrollet mbikëqyrëse kundrejt Qeverisë, para se të miratojë Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, në mënyrë që të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate sipas kërkesave të raportimit financiar.			Sipas raporteve individuale të auditimit, rastet janë reduktuar, megjithatë, ende ekzistojnë raste të keqklasifikimit të shpenzimeve si pasojë e planifikimit jo adekuat të shpenzimeve.
MFPT / Thesari i Kosovës	Të siguroj se janë përmbushur kërkesat për raportim të saktë dhe të vërtetë edhe në pasqyrat e shpalosjeve;			Në raport me vitin e kaluar ka përmirësim në raportimin e informatave financiare, megjithatë edhe këtë vit ka mos përputhje të vlerave të prezantuara në pasqyrat e shpalosjeve me pasqyrat individuale të audituara të organizatave buxhetore

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

<p>MFPT / Thesari i Kosovës</p>	<p>Të vazhdojë forcimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që të pamundësoj keqklasifikimet buxhetore;</p>			<p>Në raport me vitin e kaluar, vlera e keq klasifikimeve është më e ulët megjithatë keq klasifikimet nga organizatat kanë ndodhur prapë. Vlen të theksohet se në fillim të vitit 2021 është shtuar si nivel kontrolli aprovimi nga ZKF i zotimeve me dhe pa prokurim si dhe pranim të mallit – veprim i cili ka ndikuar në një masë në pamundësimin e keq klasifikimeve buxhetore.</p>
<p>MFPT / Thesari i Kosovës</p>	<p>Thesari të kërkojë nga komunat që ta dërgojnë planin e rrjedhës së parasë edhe për të hyrat vetjake të bartura, ashtu që të ketë një financim të balancuar të buxhetit, gjithnjë duke respektuar të drejtën që komunat e kanë për të destinuar këto mjete në kohën dhe projektet e caktuara.</p>	<p>Në vitin 2021, të gjitha organizatat buxhetore kane dërguar ne Thesar Planin e Rrjedhës së Parasë edhe për te hyrat e bartura, dhe në baze të këtij plani janë lejuar edhe alokimet dhe nënalokimet në SIMFK.</p>		
<p>Kufiri i Lejuar i Deficitit Buxhetor</p>				
<p>Kuvendin e Kosovës</p>	<p>Të siguroj se Qeveria respekton kufirin e deficit buxhetor gjatë përgatitjes së ligjit të buxhetit.</p>	<p>Ky rekomandim është i zbatuar, meqë për vitin 2021 është respektuar kufiri i deficitit buxhetor.</p>		

Siguria e Informacionit në SIMFK				
<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranfereve</p>	<p>Të harmonizoj pozitat e TI-së dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në raport me privilegjet dhe qasjet e tyre në sistemet e TI-së dhe procedurave duke bërë rishikimin e kësaj Rregullore dhe organizimin e departamentit të TI-së në Thesar. Po ashtu të siguroj administrimin e bazave të të dhënave vetëm përmes administratorëve që kanë detyrë dhe përgjegjësi administrimin e bazës së të dhënave përmes obligimit kontraktual;</p>			<p>Thesari ka nxjerrë dy vendime dhe ka krijuar dy grupe punuese të cilat në afate të caktuara kohore do të bëjnë hartimin e dy dokumenteve. Grupi i parë punues ka përfunduar punën e vet në kohën e përcaktuar dhe më 30.09.2021 ka hartuar dokumentin me propozimin e strukturës së re organizative të Thesarit. Grupi tjetër punues është në proces për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, por ende nuk kanë finalizuar dhe përfunduar miratimin e këtij dokumenti.</p> <p>Gjithashtu, janë ndërmarrë veprime edhe për adresimin e pjesës tjetër të rekomandimit. Thesari ka dërguar një kërkesë OE-së me të cilin ka kontratën për mirëmbajtjen e SIMFK-së dhe është kërkuar ndryshimi i kontratës për administrimin e bazës së të dhënave. Përmes këtij ndryshimi të kësaj pike të kontratës do të mundësohej që, administrimi i bazës së të dhënave të SIMFK-së të bëhej përmes obligimit kontraktual. Mirëpo, deri në kohën kur është realizuar ky auditim, OE nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë.</p>

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Që në strukturën organizative të MFPT-së dhe Thesarit të parashikojnë dhe të përcaktojnë zyrtarin për sigurinë e informacionit duke rishikuar dhe miratuar rregulloret e brendshme, politikat e TI-së dhe sigurisë së informacionit, në mënyrë që të përcaktojnë edhe privilegjet dhe qasjet e tyre përkatësisht me përgjegjësitë e pozitës që i takon. Përmes politikës dhe procedurave të TI-së të parashohin realizimin e testit të depërtueshmërisë për mbrojtje nga ndërhyrjet për sistemet e vendosura në rrjetin e MFPT-së në baza të rregullta kohore</p>			<p>Thesari ka krijuar komisionin, i cili ka hartuar strukturën në të cilën ka përcaktuar zyrtarin për sigurinë e informacionit. Gjithashtu, ka krijuar komisionin për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm i cili komision do të hartoj rregulloren deri më 30.06.2022, duke iu referuar raportit të datës 30.09.2021 të grupit punues për hartimin e strukturës.</p> <p>Po ashtu, edhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka krijuar një draft propozim të strukturës së re që krijon një agjenci të TI-së për MFPT-në që të ofroj shërbime të TI-së për MFPT-në së bashku me të gjitha agjencitë e saj. Në këtë strukturë është paraparë departamenti dhe zyrtari për sigurinë e informacionit për MFPT-në dhe agjencitë e saj.</p> <p>Mirëpo, këto në mungesë të organizimit të strukturës së sigurisë së informacionit dhe si rrjedhojë edhe mungesa e buxhetit për sigurinë e informacionit, nuk kanë arritur ende të përcaktojnë një politikë dhe procedurë që parashoh realizimin e testit të depërtueshmërisë për mbrojtje nga ndërhyrjet për sistemet e vendosura në rrjetin e MFPT-së në baza të rregullta kohore.</p>
---	--	--	--	---

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Që krahas konfigurimeve në rrjet, të realizoj edhe dokumentimin e rrjetit për të siguruar vazhdimësinë e sistemeve (Departamenti i TI-së në MFPT);</p>	<p>Departamenti i TI-së në MFPT për zbatimin e rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit ka realizuar dokumentimin e rrjetit duke përfshirë konfigurimet e pajisjeve ndërlidhëse për rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm "Kanë ndërmarr veprime duke realizuar fushata vetëdijësuese për punonjësit e tyre. Kanë krijuar dokumente udhëzuese për përdoruesit dhe shpërndarë ato përmes postës elektronike dhe sistemeve të informacionit. Thesari, Kosovës, gjithashtu ka vendosur në materialin e trajnimeve për SIMFK-në edhe një pjesë të veçantë për ndërgjegjësimin e përdoruesve të SIMFK-së për sigurinë e informacionit.</p>		<p>Që krahas konfigurimeve në rrjet, të realizoj edhe dokumentimin e rrjetit për të siguruar vazhdimësinë e sistemeve (Departamenti i TI-së në MFPT);</p>
<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Të organizoj në vazhdimësi trajnime dhe fushata për punonjësit e tyre për rëndësinë dhe ndërgjegjësimin ndaj sigurisë së informacionit. Poashtu të zbatoj politikën e kompleksitetit të fjalëkalimeve për llogaritë e përdoruesve (të MFTP-së dhe të Thesarit) në Active Directory (Departamenti i TI-së në MFPT);</p>			

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>“Të siguroj që qasjet administrative në sistemet e informacionit të bëhen përmes llogarive që identifikojnë përdoruesin dhe çdo ndryshim që ai bën. Të ruaj fjalëkalimin e administratorit në ambiente të sigurta dhe</p>		<p>Thesari kishte hartuar procedurë për menaxhimin e fjalëkalimeve dhe kishte filluar me zbatimin e saj. Nga verifikimi fizik për mënyrën e ruajtjes së fjalëkalimeve në ambiente të sigurta, vijmë në përfundim se kjo pjesë e rekomandimit është zbatuar plotësisht.</p> <p>Poashtu, për qasjet administrative janë krijuar llogaritë e personalizuara për bazën e të dhënave të SIMFK-së, si dhe Departamenti i TI-së në MFPT për qasje në ndërfaqet e pajisjeve të rrjetit tani përdor llogari të personalizuara. Rrjedhimisht edhe kjo pjesë rekomandimit është zbatuar.</p> <p>Thesari ka siguruar aplikacionin për monitorimin e vazhdueshëm të gjurmëve të auditimit dhe është në fazën testuese. Testimi ka qenë i suksesshëm me serverët që ata përdorin. Mirëpo, testimi ende nuk ka përfunduar për bazën e të dhënave, pasi që nuk kishin arritur ende që të zbatojnë këtë sistem për monitorimin e aktiviteteve të llogarive me qasje administrative në bazën e të dhënave të SIMFK-së. Sidoqoftë, personat e autorizuar që kanë qasje të plota në bazën e të dhënave, kanë IP të rezervuar dhe lënë gjurmë për aktivitetet e tyre. Po ashtu, zyrtarët të cilët ishin përcaktuar të bënin monitorimin e këtyre aktiviteteve, ishin të njëjtit zyrtarë të cilët ishin administrator të sistemeve. Prandaj, për pjesën e rekomandimit për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për monitorimin e vazhdueshëm të gjurmëve të auditimit, vijmë në përfundim se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.</p>	
---	--	--	--	--

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2021

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Të krijoj mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e procedurës për menaxhimin e qasjeve të përdoruesve të</p> <p>SIMFK-së. Të sigurohet që përdoruesit të kenë vetëm një llogari në SIMFK, llogaritë e dyfishta duhet të</p> <p>mbyllen. Poashtu, të sigurohet se sistemi është duke i çaktivizuar përdoruesit të cilët nuk e përdorin SIMFK-në; Të zbatohet në vazhdimësi procedurën për qasjen e përdoruesve në rrjet për punë nga distanca (Thesari);</p>	<p>Thesari ka standardizuar të gjitha llogaritë e përdoruesve në SIMFK dhe si rrjedhojë ka eliminuar përdoruesit me nga dy llogari. Ka çaktivizuar përdoruesit të cilët nuk e përdorin SIMFK-në. Po ashtu, ka ndërmarrë hapat e nevojshëm që procedura për menaxhimin e qasjeve të përdoruesve të SIMFK-së të zbatohet në vazhdimësi përfshirë edhe procedurën për qasjen e përdoruesve në rrjet për punë nga distanca.</p>	<p>Thesari nuk kishte përcaktuar ende zyrtarin adekuat për monitorimin e aktiviteteve të përdoruesve për shkak që ishte duke ndryshuar rregulloren për organizimin e brendshëm, ende nuk ishin përcaktuar detyrat për këtë pjesë.</p>	
<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Në SIMFK të bëjë kontrolle për vlefshmërinë e fushës së numrit personal identifikues, numrit unik identifikues dhe llogarisë bankare, si dhe të bëhet ndërlidhja e sistemit me sistemet e informacionit të ARC-së, ARBK-së dhe BQK-së (Thesari)</p>			<p>Gjate testimit ne kemi vërejtur se në këto fusha ka mundësi të shënohet numri me më shumë apo më pak karaktere/numra se sa ka të përcaktuar, numri personal (10 karaktere), NUI (9 karaktere), llogaria bankare (16 karaktere), si dhe sistemi pranonte llogarinë bankare e cila nuk i takonte bankës përkatëse. Po ashtu, në ndërfaqet e saj fushat e dedikuara për informata të caktuara, përdoren për informata të tjera që nuk korrespondojnë me atë fushë.</p>

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Të rishikoj procedurën për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK për rastin kur furnitorit të regjistruar duhet t'i shtohet llogaria e re bankare, si dhe në aplikacionin e SIMFK-së një furnitor të regjistrohet vetëm njëherë dhe çdo llogari e re bankare e furnitorit të shtohet në kodin ekzistues të tij (Thesari);</p>	<p>Thesari ka rishikuar dhe miratuar procedurën për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK. Nga fillimi i vitit 2022 kjo procedurë është zbatuar në SIMFK, duke regjistruar vetëm një herë furnitorin në sistem. Në rastet kur një furnitor ka më shumë se një llogari bankare, mund të shfrytëzohet fusha në sistem e cila mundëson shtimin e llogarisë bankare për të njëjtin kod të furnitorit. Gjatë regjistrimit të kuponit të shpenzimit në SIMFK shfaqet lista e llogarive bankare të përfituesit nëse ka më shumë se një llogari bankare të regjistruar.</p>		
---	--	---	--	--

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranfereve</p>	<p>Të krijoj mundësinë në SIMFK që shpenzimet e përmirësimit të pasurisë jo financiare kapitale të regjistrohen në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurisë (Thesari)</p>			<p>Në SIMFK nuk mundësohet zbatimi i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, që një shpenzim për përmirësimin e pasurisë kapitale të regjistrohet në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurisë kapitale. Si pasojë, organizatat buxhetore regjistrojnë në SIMFK, shpenzimin që bëhet për përmirësimin e një pasurie kapitale me qëllim të ndryshimit ose modernizimit të saj, të cilat zgjasin ndjeshëm periudhën e përdorimit të artikullit ose e përmirësojnë funksionalitetin e tij, si pasuri të re.</p> <p>Thesari në sistemin testues të SIMFK-së ka zbatuar mundësinë e shtimit të vlerës së pasurisë. aktualisht, janë në fazën testuese të sistemit për realizimin e shpenzimeve përmirësuese që të mundësohet regjistrimi si rritje e vlerës së pasurisë në regjistrat e pasurisë përkatëse. Mirëpo, Thesari ende nuk ka përcaktuar një metodologji nga aspekti kontabël si të bëhet shtimi i vlerës së pasurisë, si dhe nuk janë përcaktuar normat e amortizimit për këto pasuri.</p>
---	---	--	--	--

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Të regjistrojë në SIMFK të gjitha kodet e klasave të pasurisë të publikuara, që t'i mundësojë organizatave buxhetore klasifikimin e saktë të pasurisë gjatë regjistrimit sipas planit kontabël (Thesari)</p>			<p>Thesari ende nuk ka regjistruar të gjitha kodet e klasave të pasurisë në sistem sipas listës së publikuar në ueb faqe. Si rezultat, OB-të gjatë regjistrimit të pasurisë jo financiare në SIMFK, në rastet kur kodi adekuat i klasës së pasurisë nuk është në listë, detyrohen që atë pasuri ta klasifikojnë në kodin me emërtim më të përshtatshëm apo në klasën e pasurisë “Kapitale Tjera”. Thesari ka identifikuar klasat e pasurisë të planit kontabël të cilat mungojnë në SIMFK, mirëpo ende nuk është përcaktuar norma e amortizimit për këto klasa.</p>
<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranferëve</p>	<p>Të zbatoj në SIMFK funksionin e kontrollit për identifikimin dhe refuzimin e transaksioneve me të dhëna identike (Thesari)</p>	<p>Thesari ka zbatuar funksionin i cili refuzon regjistrimin e kuponit të shpenzimit me të dhëna të njëjta më shumë se një herë. Si në rastet e krijimit të kuponit të shpenzimit i cili krijohet manualisht për të regjistruar shpenzimin dhe automatikisht përmes funksionit të importimit të pagesave masive, sistemi bënë verifikimin për të identifikuar dhe refuzuar të dhënat e shpenzimit nga organizata</p>		

<p>Ministrinë e Financave Punës dhe tranfereve</p>	<p>Të rishikoj mundësitë që ofron SIMFK-ja dhe të shfrytëzoj përparësitë e tij në mënyrë që të rris edhe më tej efikasitetin e punës së përdoruesve (Thesari)</p>	<p>Thesari kishte realizuar aktivitete për rregullimin e shumë fushave në sisteme të cilat ndikojnë në rritjen e efikasitetit të punës. Mundësitë që ofron sistemi dhe që janë përshtatur sipas nevojave dhe kanë kufizuar mundësinë e gabimeve, nga çështjet e identifikuar në sisteme dhe që është rekomanduar për to.</p>		
---	---	--	--	--

Të bëjë një vlerësim të nevojave të përdoruesve për raporte dhe të sigurohet që të ofroj raporte të ndryshme sipas nevojave të tyre. Mangësitë e identifikuar në raporte/module të korrigojohet (Thesari).

Thesari kishte filluar me ndryshimin e disa raporteve dhe riemërimin e disa fushave në aplikacion. Megjithatë, gjatë testimit të këtyre raporteve ne kemi vërejtur që ka ende mangësi në disa informata që do të kompletin informacionin e kërkuar. Poashtu, nuk janë bërë vlerësime të nevojave që përdoruesit kanë lidhur me këto raporte apo edhe përmirësim të raporteve ekzistuese. Te raportet për vlerësimin e pasurisë mungon data e fillimit të zhvlerësimit të pasurive. Gjithashtu, raportet nuk përmbajnë numrin e kontratës së një procedure me prokurim, edhe pse në rastet kur në obligime/urdhër blerje regjistrohet numri i kontratës, ky numër nuk paraqitet në raporte.

Po ashtu eksportimi në formatin Excel nuk e bënë ndarjen e kolonave në shtylla, që ndikon në punë shtesë për secilin raport që përdoret për kalkulime të mëtejme.

Nëse në SIMFK zgjidhet gjuha Shqipe/Serbe për përdorim, ka raste që kolonat e raporteve si dhe fushat në modulet e aplikacionit nuk janë të gjitha në gjuhën Shqipe/Serbe, por ka kolona dhe fusha që emërtimi ende vazhdon të jenë në gjuhën Angleze. Aplikacionit i mungon raporti i përdoruesve, nga ku mund të monitorohej me lehtësi statusi i tyre. Poashtu, mungon mundësia që përmes sistemit/aplikacionit të gjenerohet një raport ku mund të shihen të gjithë furnitorët e regjistruar në këtë aplikacion.

Analiza e Buxhetit Shtetëror				
Qeveria	Të siguroj se janë krijuar të gjitha kushtet që stafi i punësuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të vijoj normalisht procesin e punës. Punonjësit të cilët nuk kryejnë asnjë detyrë pune në interes të punëdhënësit, nuk duhet të kompensohen;			Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete në zbatimin e këtij rekomandimi. Gjendja e njejtë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021.
Qeveria	T'i shqyrtoj raportet periodike të MFPT-së për borxhet publike dhe të analizojë ngeçjet e identifikuara. Gjithashtu, në baza periodike të analizoj kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për financim, buxhetim dhe monitorimin e shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes, si dhe të shqyrtoj vonesat eventuale në tërheqjen e këtyre fondeve.			Qeveria ka shqyrtuar raportet e borxhit publik, të aprovuara me vendimin Nr. 09/14, të datës 28.05.2021 dhe me vendimin Nr. 17/47, të datës 10.12.2021, megjithatë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar për faktin se sërish nuk ka pasur një monitorim efektiv të shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

<p>MFPT / Departamenti i Buxhetit & Thesari i Kosoves</p>	<p>MFPT me rastin e përgatitjes së buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe e drejtë;</p>	<p>Kjo çështje është rregulluar për vitin 2021. Në tabelat e Ligjit të Buxhetit nr.07/L-041 mbi ndarjet</p> <p>buxhetore për BRK-në për vitin 2021 nuk kemi identifikuar mospërputhje të</p> <p>tilla ndërmjet tabelave buxhetore në prezantimin e të hyrave të planifikuara për tatimin në pronë dhe të hyrave jo tatimore për taksa dhe ngarkesa tjera në nivelin lokal.</p>		
<p>MFPT / Departamenti i Buxhetit & Thesari i Kosoves</p>	<p>MFPT të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale;</p>			<p>Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete në zbatimin e këtij rekomandimi. Realizimi i projekteve kapitale sërish ka qenë i ulët me një performancë lehëtësisht më të mirë në krahasim me vitin e kaluar për shkak të përmirësimit të gjendjes me pandeminë.</p>

<p>MFPT/ Thesari i Kosovës</p>	<p>MFPT në koordinim me Ministrat të instalojnë mekanizma mbikëqyrës për të siguruar zbatimin e projekteve dhe raportimin në MFPT konform kërkesave ligjore në lidhje me ecurinë e realizimit të projekteve me financim nga huamarrja.</p>		<p>Sërish ka ngecje në zbatimin e projekteve por ka nje përmirësim në raportimin lidhur me ecurinë e realizimit të projekteve nga huamarrja. Gjatë vitit 2021 nga të gjitha projektet e financuara nga huamarrja, nuk kishin arritur të raportonin sipas kërkesave ligjore vetëm dy prej tyre.</p>	
---------------------------------------	--	--	--	--

Analiza e Shënimeve Shpjeguese				
Qeveria	<p>Qeveria duhet që ti shqyrtoj në baza të rregullta raportet vjetpore të MFPT-së për borxhet publike dhe ti përdorë ato në diskutimet gjithëpërfshirës kur vlerëson nevojat për huamarrje, rezultatet dhe pengesat në proces. Po ashtu, duhet të forcoj menaxhimin dhe kontrollet lidhur me shfrytëzimin efikas dhe efektiv të këtyre fondeve.</p>			<p>Qeveria ka shqyrtuar raportet e borxhit publik, te aprovuara me vendimin Nr. 09/14, te datës 28.05.2021 dhe me vendimin Nr. 17/47, te datës 10.12.2021, megjithatë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar për faktin se sërish nuk ka pasur një monitorim efektiv të shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes.</p>
MFPT/ Divizionit për bashkëpunim financiar ndërkombëtar/ Departamenti I Buxhetit/ Thesari I Kosovës & ZKM	<p>MFPT në bashkëpunim me Qeverinë dhe subjektet përfituese të fondeve duhet të sigurohet që para fillimit të negociimit të marrëveshjeve për huamarrje për projekte të caktuara, janë përmbushur të gjitha kushtet që sigurojnë zbatimin e plotë dhe efikas të tyre.</p>			<p>Realizimi efektiv i projekteve nuk është mundësuar si rezultat i mos përmbushjes së të gjitha kushteve që sigurojnë realizimin e projektit, siç janë zgjidhja e problemeve me shpronësimet.</p>
MFPT/ Thesari i Kosovës	<p>Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministrinë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i siguroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.</p>		<p>Thesari ka përgatitur raportet gjashtë mujore me: sfidat për projektet më problematike, përmbledhje të sfidave që shoqërojnë të gjitha projektet dhe rekomandimet për adresimin e tyre. MFPT ka paraqitur raportet në Qeveri për informim dhe shqyrtim. Megjithatë vazhdon të mbetet sfiduese dhe jo i kënaqshëm realizimi i projekteve nga huamarrjet.</p>	

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2021

<p>MFPT / Departamenti i Buxhetit, Thesari i Kosoves</p>	<p>MFPT të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse ato kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyre projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur</p>			<p>Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, prandaj gjendja e njejtë është përsëritur edhe gjatë vitit 2021.</p>
<p>Pasuritë</p>				
<p>Qeveria</p>	<p>Qeveria duhet të luaj një rol aktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive duke ndërtuar mekanizma llogaridhënës në mënyrë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha organizatat buxhetore t'i përmbushin detyrimet ligjore, duke i regjistruar dhe raportuar saktë të gjitha pasuritë jo financiare në posedim; 			<p>Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e këtij rekomandimi. Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa organizata buxhetore nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RVF-BRK është mbivlerësuar për pasurit kapitale, ndërsa për pasuritë jo kapitale nënvlerësuar.</p>

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

<p>Qeveria</p>	<p>Qeveria duhet të luaj një rol aktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive duke ndërtuar mekanizma llogaridhënës në mënyrë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> T'i analizoj shkaqet për mos-funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria, si një problem i trashëguar për vite me radhë dhe të ndërmerri masa për funksionalizimin te tij. 			<p>Ky rekomandim mbetet i pazbatuar për vitin 2021, si rezultat i mungesës së kontratës për mirëmbajtje dhe avancim të e- pasurisë. Vlen të theksohet se në korrik të këtij viti MPB ka nënshkruar kontratën për mirëmbajtjen e këtij aplikacioni.</p>
<p>MFPT / Thesari i Kosovës</p>	<p>MFPT përmes trajnimeve të fund vitit lidhur me hartimin e PFV-ve, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive dhe rezultatet e inventarizimit të reflektojnë në PFV-të e vitit fiskal;</p>			<p>Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e këtij rekomandimi, duke qenë se nga auditimet individuale ka rezultuar se në 21 organizata buxhetore nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrin të përgjithshëm të pasurisë; në 13 ob nuk është kryer inventarizimi vjetor, ose ishte bërë inventarizim i pjesshëm.</p>
<p>MFPT / Thesari i Kosovës</p>	<p>MFPT me rastin e pranimit të PFV-ve nga organizatat buxhetore, të vendos kontrole formale, në veçanti lidhur me raportimin e pasurive jo financiare dhe stoqeve me gjendjen zero dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, ngase në raportet e tri viteve të fundit kishte diferenca të theksuara.</p>			<p>Bazuar në auditimet individuale, në fund vit 2021, nëntë komuna nuk kanë raportuar stoqe.</p>

Llogaritë e Arkëtueshme				
<p>Kuvendi i Kosovës/ Qeveria/ MFPT</p>	<p>Në koordinim me organizatat buxhetore që krijojnë të hyra, duhet të analizojnë në hollësi strukturën e këtyre llogarive, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe të trashëguara për vite me radhë. Rrjedhimisht, të krijojnë mekanizma të duhur për mbledhjen e këtyre borxheve, si dhe të kujdesën për raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme si te niveli qendror po ashtu edhe në nivelin lokal.</p>			<p>Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, prandaj mangësitë lidhur me mbledhjen e borxheve dhe raportimin jo të saktë të llogarive të arkëtueshme janë përsëritur edhe gjatë vitit 2021.</p>
Detyrimet e Papaguara dhe ato Kontigjente				
<p>MFPT</p>	<p>Me rastin e ndarjeve buxhetore duhet të kenë prioritet ndarjen e fondeve për pagesën e detyrimeve të papaguara në mënyrë që të mënjanohen shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative. Përveç kësaj, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet edhe raportimit dhe konsolidimit të tyre në mënyrë që të prezantojnë gjendjen e plotë dhe të saktë të tyre në RFV-të të BRK-së.</p>		<p>Detyrimet janë zvogëluar në mënyrë të konsiderushme krahasur me vitin paraprak.</p>	

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

<p>MFPT</p>	<p>Në koordinimin me organizatat buxhetore dhe akterët tjerë relevant, duhet të siguroj vlerësimin e saktë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta. Aty ku nuk janë bartur shënimet në RFV-të apo aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korrigjohen për vitin e ardhshëm.</p>			<p>Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, prandaj çështjet e njëjta janë përsëritur edhe gjatë vitit 2021.</p>
<p>Pagesat Sipas Nenit 39.2 të LMFP</p>				
<p>MFPT</p>	<p>Me rastin e përgatitjes së Raportit Financiar Vjetor të BRK-së, të sigurohet për saktësinë e vlerës së prezantuar të pagesave sipas nenit 39.2, duke u bazuar në shënimet e fundit të korrigjuara në SIMFK dhe përmes</p> <p>krahasimit/harmonizimit me PFV-të individuale të OB-ve që kanë pasur shpenzime të tilla.</p>	<p>E zbatuar, vlerat e pagesave sipas nenit 39.2, janë prezantuar saktë.</p>		

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2021

<p>Qeveria</p>	<p>Të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë eventuale të OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive valide dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime të panevojshme nga proceset eventuale gjyqësore si pasojë e mos përmbushjes së obligimeve eventuale që burojnë nga këto marrëveshje.</p>			<p>Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, prandaj çështjet e njëjta janë përsëritur edhe gjatë vitit 2021.</p>
<p>MFPT</p>	<p>Me rastin e përgatitjes së RFV-së të BRK-së, të sigurohet për saktësinë e vlerës së prezantuar të këtyre pagesave, duke u bazuar në shënimet e fundit të korrigjuara të SIMFK-së dhe përmes krahasimit/harmonizimit me PFV-të individuale të OB-ve që kanë pasur shpenzime të tilla.</p>	<p>Gjatë analizimit të shënimeve për vitin 2021, nuk kemi vërejtur diferenca.</p>		

Zbatimi i Rekomandimeve

Kuvendi i Kosovës

Të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP-ja. Këto plane duhet të përcaktojnë saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që së paku dy herë në vit KMFP-ja ka shqyrtuar progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Gjatë shqyrtimit të Raportit Vjetor të Auditimit, për vitin 2020, përfaqësuesit e Qeverisë, në takimin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, kanë paraqitur edhe Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me 13 tetor 2021.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në Planin e Punës për vitin 2022, ka paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve.

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2021

<p>Qeveria</p>	<p>Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave që forcojnë llogaridhënien dhe parandalojnë ngecjet në zbatimin e rekomandimeve</p>			<p>MFPT ka bërë kërkesë ndaj OB-ve lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve, megjithatë nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.</p>
<p>Sistemi i Auditimit të Brendshëm</p>				
<p>Qeveria</p>	<p>Menaxhmentet e OB-ve të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në sipas rregullores QRK-nr. 01/2019 duhet sa më parë ta krijojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtrojnë përmes mënyrave tjera të parapara me këtë Rregullore;</p>		<p>Nga auditimet individuale, është vërejtur se rastet janë përsëritur por në një nivel më të ulët, një vit më parë kanë qenë tri ndërsa në këtë vit dy raste.</p>	
<p>Qeveria</p>	<p>Të gjitha OB-të themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Këto komitete duhet të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA-në, të shtojnë efektitetin dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies në OB dhe forcimin e rolit të AB-së.</p>		<p>Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht pasi që vitin e kaluar kanë qenë gjashtë raste, ndërsa në këtë vit janë identifikuar katër raste.</p>	

Prokurimi				
Organizatat buxhetore	Të sigurojnë se secila kontratë ka fonde të mjaftueshme, të miratuara në ligjin e buxhetit, për të mbuluar koston e projektit në mënyrë që të realizohet sipas planifikimit;			Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, meqë në raportet individuale janë identifikuar raste të hyrjes në obligime kontraktuese pa siguruar buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e kontratave.
Organizatat buxhetore	Të përdorin procedura të prokurimit të cilat sigurojnë se nuk e kufizojnë konkurrencën dhe sigurojnë vlerë për parënë e shpenzuar.			Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, meqë në raportet individuale janë identifikuar raste të aplikimit të procedurave jo të duhura të prokurimit (kuotim i çmimit/ procedurë me vlerë minimale/ procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë).
Organizatat buxhetore	Të sigurojnë që aktivitetet e prokurimit për kontrata për punë nuk iniciohen pa projektin kryesor.			Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, meqë në raportet individuale janë identifikuar raste të inicimit të procedurave të prokurimit pa projektin kryesor.

Aplikueshmëria e Ligjeve dhe Sfidat Ligjore				
Qeveria/ MFPT	Të iniciojnë ndryshimin e kuadrit ligjor për sa i përket raportimit financiar dhe auditimit të NP-ve në mënyrë që të siguroj harmonizimin e ligjeve që rregullojnë këtë fushë.			Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi duke qenë se ende ka mosharmonizim ndërmjet ligjeve sa i përket datave të raportimit financiar të NP-ve.
Qeveria/ MFPT	Me rastin e nxjerrjes së vendimeve për shpronësimin e pronave të analizoj dhe të bëjë një vlerësim të efekteve/kostove financiare për projektet përkatëse. Poashtu, të buxhetoj mjetet financiare dhe të ekzekutoj me kohë pagesat në mënyrë që të mos krijohen shpenzime shtesë nga OB-të për shpronësimin e pronave.			Ky rekomandim nuk është i zbatueshëm më, për më tepër referoju Shtojcës xxxx
Qeveria/ MFPT Komunitet Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok	Të sigurojnë zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, si dhe të sigurojnë hartimin dhe aprovimin e rregulloreve të brendshme për taksat dhe tarifatat përkatëse. Inkasimi i këtyre të hyrave do të mundësonte realizimin e më shumë projekteve, rrjedhimisht edhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.			Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, prandaj çështjet e njëjta janë përsëritur edhe gjatë vitit 2021. Komuna e Zubin Potokut nuk ka miratuar rregullore dhe rregullore për mbledhjen e të hyrave dhe taksave dhe tarifatat.

Çështjet e Ndërlidhura me Shpenzimet për Menaxhimin e Pandemisë COVID -19

<p>MFPT</p>	<p>Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, duhet të sigurojnë se organizatat buxhetore me rastin e përgatitjes së PFV-ve do të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore sa i përket shpalosjeve, përfshirë edhe shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19.</p>		<p>Organizatat buxhetore (OB) kishin shpalosur shpenzimet për menaxhimin e pandemisë, me përjashtim të ZKM-së dhe MBPZHR në vlerë të cilat nuk kishin shpalosur shpenzimet e Covid-19 në pasqyrat financiare vjetore.</p>	
--------------------	--	--	---	--

Auditimet e Performancës

<p>Kuvendi i Kosovës</p>	<p>Përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe komisioneve tjera parlamentare për fusha përkatëse, të shqyrtoj raportet e auditimit të performancës dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbajtur llogaridhënës krerët e institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve.</p>		<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes komisioneve relevante ka ndërmarr veprime për trajtimin e Raporteve të auditimit të performancës dhe teknologjisë së informacionit duke kërkuar llogari dhe mbajtur përgjegjës krerët e organizatave të audituara. Rrjedhimisht në periudhën prill-qershor 2021 nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë trajtuar shtatë 7 raporte të auditimit të performancës dhe teknologjisë së informacionit (5 raporte të performancës, 1 raporte të auditimit të TI-së dhe 1 raport për auditim të prokurimit) dhe 4 raporte nuk janë shqyrtuar ende (dy të auditimit të prokurimit, një auditimit të TI-së dhe një raport mbi zbatimin e rekomandimeve). Për secilin raport gjatë trajtimit KMFP ka ftuar krerët e organizatave e në disa raste kanë marrë pjesë edhe Komisionet e Kuvendit të fushave relevante. KMFP ka nxjerrë rekomandimet e veta, po ashtu dy raporte janë rekomanduar që të diskutohen edhe në seance plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.</p>	
---------------------------------	---	--	--	--

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2021

<p>Qeveria, kuvendet komunale dhe organet drejturse/ qeverisëse të subjekteve të audituara</p>	<p>Të sigurojnë së janë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga auditimi i performancës dhe janë krijuar mekanizma për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtyre planeve, duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë dhe duke siguruar raportim të rregullt.</p>		<p>Sipas ZKM dhe MFPT, ky proces do të finalizohet përgjatë periudhës kohore qershor-korrik 2022.</p> <p>Gajtë analizimit të planeve të dërguara në ZKA kemi konstatuar se nga 38 organizata përgjegjëse për hartimin dhe dorëzimin e planit të veprimit, prej tyre 12 organizata i kanë hartuar dhe dorëzuar ndërsa 26 tjera nuk kanë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e performancës dhe teknologjisë së informacionit gjatë periudhës shtator 2020 - korrik 2021.</p>	
<p>Ndërmarrjet Publike</p>				
<p>Bordet Drejtuese dhe Aksionarët e Ndërmarrjeve</p>	<p>Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar tek Modifikimi i Opinionit dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që këto shkaqe të korrigjohen dhe parandalohen. Të sigurojnë se janë vendosur procese dhe kontrole efektive që konfirmojnë se hartimi i PFV-ve i adreson mangësitë e identifikuar në vitin paraprak.</p>			<p>Bazuar në raportet individuale të auditimit të NP-ve , gjendja e opinionëve është përafërsisht e njëjtë krahasuar me vitin paraprak.</p>

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2021

<p>Bordet Drejtuese dhe Aksionarët e Ndërmarrjeve</p>	<p>Aksionarët të mbajnë përgjegjës Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse dhe të kërkojnë llogari që përgatitja e PFV-ve të jetë e drejtë dhe korrekte e që do të rezultonte me Opinione të pamodifikuara për ndërmarrjet respektive.</p>			<p>Bazuar në raportet individuale të auditimit të NP-ve përgatitja e PFV-ve për vitin 2021 është përcjellë me mangësi të cilat kanë ndikuar që gjendja e opinionëve të jetë përafërsisht e njëjtë krahasuar me vitin paraprak.</p>
<p>Aksionarët</p>	<p>Aksionarët duhet të sigurojnë që Bordet e Drejtorëve të ndërmarrjeve publike të audituara përgatisin plane cilësore të veprimit dhe sigurojnë zbatimin e plotë të tyre me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Aksionarët poashtu duhet të sigurojnë që BD-të dorëzojnë së paku dy herë në vit raporte të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditimit.</p>			<p>Nga analizat paraprake, gjendja e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2020 është më dobët sesa ajo e vitit 2019.</p>
<p>Qeveria, Ministria e Ekonomisë dhe komnat</p>	<p>Të sigurojnë që Bordet e Drejtorëve kanë analizuar rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, kanë hartuar dhe siguruar zbatimin e planeve të biznesit me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare dhe afarizmit të këtyre ndërmarrjeve.</p>			<p>Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi, prandaj bazuar në treguesit financiar kemi të njëjtën gjendje sikurse në vitin paraprak.</p>

Shtojca II: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe i përhapur.

Konkluzionet e auditimit

- **Konkluzioni i Pamodifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit;
- **Konkluzioni i Kualifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit, përveç ndonjë çështjeje të caktuar e cila përshkruhet te baza për konkluzion të pajtueshmërisë;
- **Konkluzioni i kundërt** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara të auditimit; dhe
- **Mohimi i konkluzionit** - Paraqet gjendjen kur auditori për shkak të pamundësisë për marrjen e dëshmive të duhura dhe pa pajtueshmërive të përhapura në shumë fusha, nuk është në gjendje të nxjerrë konkluzion lidhur me pajtueshmërinë.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'Theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin “Çështje të tjetra”, apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA RABDELARJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DOKUMENTI I ZYRËS Dokumenti Nr. / Doc. No.			
DATE-REKORDI I ZYRËS Dokumenti Nr. / Doc. No.			
Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Prot. / Br. Prot.
03	47	1634	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Prot. / Br. Prot.
01/400	1244-2/2022		
Data / Datum	Data / Datum	Data / Datum	Data / Datum
19	19, 08, 2022		
PRISHTINE/A			

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -

Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

LETËR E KONFIRMIMIT PËR ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit Vjetor Financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31.12.2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Nuk pajtohem me disa nga gjetjet dhe rekomandimet në përmbajtjen e Raportit. Gjetjet për disa pjesë janë jo-materiale kurse për disa të tjera janë probleme historike e të cilat nuk janë pasqyruar si të tilla. Detajet lidhur me këto mospajtime janë bërë të ditura përmes komenteve me shkrim të dërguara nga Ministria;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.



Helvan Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Data: 19 gusht 2022, Prishtinë

Shtojca IV: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

Shënim	2021	2020	2019
	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
PRANIMET			
Tatimet Direkte			
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	113,946	85,279
Tatimi në të ardhura personale	3	189,521	157,966
Tatimi në pronë	4	36,258	22,707
Tatime tjera direkte	5	2,440	1,294
		342,165	267,247
Tatimet Indiekte			
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	1,038,218	770,145
Detyrimi doganor	7	124,606	101,618
Akciza	8	501,295	398,072
Tatime tjera indirekte	9	565	2,900
		1,664,685	1,272,735
Kthimet tatimore			
Kthimet tatimore	10	-58,912	-32,999
		-58,912	-32,999
Të hyrat jo-tatimore			
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	129,563	103,486
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	57,271	42,716
Taksa koncesionare	13	16,972	2,651
Renta minerare	14	19,235	29,362
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	3,074	2,986
Të hyrat nga dividenda	16	10,000	-
		236,116	181,201
Huamarrja			
Huamarrja e jashtme shtetërore	17	117,334	211,389
Pranimet për shërbimin e nën-huazimeve	18	8,005	7,688
Huamarrja e brendëshme shtetërore	19	144,247	169,955
		269,586	389,031
Grantet dhe ndihmat			
Grantet e përcaktuara të donatorëve	20	16,800	9,048
Grantet për mbështetje buxhetore	21	0	34,030
		16,801	43,078
Pranimet tjera			
Fondi i depozitave	22	4,462	1,018
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	23	11,387	11,387
Të hyrat e dedikuara	24	4,645	2,473
Financimi i njëhershëm i AKP-së	25	39	71,476
		39	71,476
Gjithsej Pranimet		2,490,973	2,206,647
			2,222,922
PAGESAT			
Operacionet			
Paga dhe shtesa	26	668,124	661,343
Mallra dhe shërbime	27	306,255	280,007
Shërbime komunale	28	25,287	22,168
		999,666	963,518
Transferet			
Subvencione dhe transfere	29	842,897	868,480
Shpenzimet kapitale			
Prona, implantet, pajisjet, transferet	30	423,941	384,471
Pagesat tjera			
Pagesat e borxhit publik	31	111,192	115,713
Kthimet nga fondet e depozitave	32	1,044	2,761
		112,233	(128,295)
Gjithsej Pagesat		2,378,740¹	2,334,943
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		112,233	(128,295)
Para të gatshme në fillim të vitit	33	329,955	458,251
Para të gatshme në fund të vitit	33	442,189	458,251

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	2021				2020	2019
	Realizimi	Buxheti përfundimtar	Buxheti fillestar	Ndryshimet buxhetore	Realizimi	Realizimi
	A '000 €	B '000 €	C '000 €	D=B-A '000 €	'000 €	'000 €
SRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimet direkte	342,165	326,400	304,000	(15,765)	267,247	292,259
Tatimet indirekte	1,664,685	1,512,930	1,419,200	(151,755)	1,272,735	1,415,291
Kthimet tatimore	(58,912)	(48,000)	(45,500)	10,912	(32,999)	(45,507)
Të hyrat jo-tatimore	236,116	241,400	199,800	5,284	181,201	214,614
Grantet dhe ndihmat ²	16,801	22,500	22,500	5,699	43,078	19,487
Huamarrja	269,586	607,000	610,200	337,414	389,031	158,264
Pranimet tjera ³	20,533	35,400	45,400	14,867	86,355	168,514
Gjithsej Pranimet	2,490,973	2,697,630	2,555,600	206,657	2,206,647	2,222,922
SRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Paga dhe shtesa	668,124	668,692	639,800	568	661,343	616,921
Mallra dhe shërbime ⁴	306,255	370,760	333,790	64,505	280,007	273,313
Shpenzime komunale	25,287	27,638	30,110	2,351	22,168	24,866
Subvencione dhe transfere	842,897	876,161	753,100	33,264	868,480	627,959
Shpenzime kapitale	423,941	622,086	626,100	198,145	384,471	533,773
Rezerva	-	3,498	32,800	3,498	-	-
Interesi	30,881	34,700	38,500	3,819	27,505	23,450
Të tjera ⁵	81,354	118,500	172,100 ⁶	37,146	90,969	52,264
Gjithsej Pagesat	2,378,740	2,722,035	2,626,300	343,295	2,334,943	2,152,546
Deficiti/Suficiti	112,233	(24,405)	(70,700)	(136,638)	(128,295)	70,376

² Te planifikimi buxhetor (kolona B dhe C) përfshihen grantet e përcaktuara të donatorëve (12 milionë euro) si dhe grantet për mbështetje buxhetore (10.5 milionë euro), si fonde të planifikuara për pranim në vitin 2021.

³ Përfshihen, të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, financimi i njëhershëm nga AKP dhe pranimet nga depozitat.

⁴ Përfshihet shuma e shpenzuar nga MSH prej 342,710.27 Euro nga kredia IDA-64420, Projekti i shëndetësisë kosovare Nr. P147402. Ministria e Shëndetësisë për këtë vlerë në SIMFK ka mbivlerësuar huamarrja (04) dhe nënvlerësuar granti qeveritar (10).


⁵ Përfshihen, pagesa e principalit, nen-huazimi, diskonti i letrave me vlerë, pagesat për antarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave (neto). Nuk përfshihen GPD, meqë ato janë të shpërndara në kategori ekonomike perkatëse.

⁶ Në kuadër të buxhetit fillestar (kolona C) - "Të tjera" janë prezantuar edhe GPD në shumë prej 12 milionë euro, për efekte të neutralitetit të bilancit të pashpërndarë bankar, për shkak të përfshirjes tek pranimet e sqaruar në fusnotën 2.

Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Shënim	2021 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2020 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2019 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
Pasuritë financiare - para e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	35	423,322	316,897	444,301
Kuotat në IFN	36	3,734	1,741	1,741
Fondi në mirëbesim për zhvillim	37	2,636	1,971	4,754
Paratë e gatshme në transit	38	6,946	4,851	4,632
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	39	2,068	1,751	1,135
Paratë e gatshme në dorë (arka) dhe avance te hapura	40	3,484	2,744	1,687
Gjithsej pasuritë financiare dhe para të gatshme		442,189	329,955	458,251
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	41	15,818	9,752	8,865
Të hyrat vetanake të bartura - niveli qendror	42	1,436	1,765	5,741
Të hyrat vetanake të bartura - niveli lokal	43	80,078	55,994	49,477
Fondi në mirëbesim për zhvillim	44	7,354	7,078	6,837
Të hyrat e dedikuara	45	467	52	803
Të tjera	46	19,812	15,894	17,504
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	47	5,131	3,941	7,040
		130,095	94,475	96,267
Bilanci bankar i shfrytëzueshëm (i pashpërndarë)		312,093	235,480	361,983
Gjithsej Bilanci i Fondeve	33	442,189	329,955	458,251



Adresa:

Zyra Kombëtare e Auditimit

Lagjja Arbëria

Rr. Ahmet Krasniqi, 210

10000 Prishtina

Republika e Kosovës